

The European Union's IPA Multi – Beneficiary 2010

# MANUAL MBI EKIPET E PËRBASHKËTA HETIMORE

Supported by



FIGHT AGAINST ORGANISED CRIME AND CORRUPTION,  
STRENGTHENING THE PROSECUTORS' NETWORK



This project is funded by  
the European Union



implemented by



**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



---

FIGHT AGAINST ORGANISED CRIME AND CORRUPTION,  
STRENGTHENING THE PROSECUTORS' NETWORK

MANUAL MBI  
**EKIPET E PËRBASHKËTA  
HETIMORE**

Mars 2014

*Publikoi*

**Deutsche Gesellschaft für  
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**

*Sitz der Gesellschaft*  
Bonn und Eschborn

“IPA 2010 – Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit:  
Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”

Zmaja od Bosne 7-7a  
71000 Sarajevo  
T +387 33 957 500  
F +387 33 957 501

Dr. Christian Athenstaedt  
christian.athenstaedt@giz.de

*Data e publikimit*  
Mars 2014

Dizenjoi  
TDP Sarajevo

Teksti origjinal  
“IPA 2010 – Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit:  
Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”  
Jošt Jeseničnik  
Alenka Sagmeister, Prokuror i atashuar i BE-së

*Përktheu*  
Mira Zgjani

Përjashtim nga përgjegjësia  
Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Komisionit Evropian.  
GIZ nuk është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

Përcaktimi për BE-në  
Bashkimi Evropian përbëhet nga 28 Shtete Anëtare, të cilët kanë vendosur të lidhin gradualisht sëbashku ekspertizën, burimet dhe fatet e tyre. Sëbashku, gjatë kohës së zgjerimit prej 50 vitesh, këta shtete kanë ndërtuar një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm ndërsa kanë ruajtur diversitetin kulturor, tolerancës dhe lirive të individit. Bashkimi Evropian është i angazhuar të ndajë arritjet dhe vlerat e tij me shtetet dhe popujt përtej kufijve të tij.

## Përmbajtja e lëndës

Parathënie.....	5
I. Sfondi.....	7
II. Ekipi i Përbashkët Hetimor (EPH) .....	9
Elementi ndërkombëtar .....	9
Hetimi i përbashkët .....	9
Ekipi .....	10
Drejtuesi i EPH .....	11
Marrëveshja formale .....	12
Elementi kohë .....	13
Vepra penale specifike .....	14
III. Procedura hap pas hapi .....	15
7 Hapa për krijimin e një EPH .....	15
(1) Përcaktimi i veprës penale.....	15
(2) Kuadri ligjor (i brendshëm, i huaj) .....	16
A- Kuadri ligjor ndërkombëtar .....	16
1) Protokollin e dytë shtesë i konventës së këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështje penale .....	17
2) Konventa e bashkëpunimit policor për Europën Juglindore ...	18
3) Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar .....	19
4) Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit .....	20
5) Konventa për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit .....	21
6) Konventa për krimin në fushën e kibernetikës.....	21
B- Kuadri ligjor kombëtar .....	22
Shqipëria.....	23
Bosnjë-Hercegovina .....	23
Kroacia .....	23
Kosova* .....	24
Mali i Zi .....	24
Serbia.....	25

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë .....	25
C- Përmbledhje e bazës ligjore për Eph .....	26
Shqipëria .....	26
Bosnjë-Hercegovina .....	27
Kroacia .....	31
Kosova .....	34
Mali i Zi .....	36
Serbia .....	39
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë .....	40
Bashkëpunimi me EUROJUST .....	42
(1) Kontakti me autoritetet e huaja .....	44
(2) Kërkesa për krijimin e një EPH .....	45
(3) Hartimi i marrëveshjes formale .....	45
(4) Nënshkrimi i marrëveshjes .....	46
(5) Realizimi i marrëveshjes- Plan Veprimi Operacional .....	47
– Plan Veprimi Operacional .....	47
IV. Përfundim .....	51
Shtojca 1 .....	53
Shtojca 2 .....	82
Shtojca 3 .....	93
Hyrje .....	93
Shembulli i një marrëveshjeje për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor .....	94
Marrëveshje tip për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor .....	103

---

\* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GJND-së “Për deklaratën e pavarësisë së Kosovës

## Parathënie

nga Alenka SAGMEISTER RANZINGER

Për herë të parë kam dëgjuar për ekipet hetimore të përbashkëta rreth shtatë vjet më parë. Asokohe isha prokurore rrethi në Grupin e Prokurorëve për Ndjekjen Penale të Krimit të Organizuar pranë Prokurorisë së Lartë të Republikës së Sllovenisë, dhe m'u kërkua të merrja pjesë në një mbledhje me punonjës të një policie të huaj. Në ftesë jepej një përshkrim i shkurtër i situatës faktike të dyshuar të veprës penale në fjalë dhe një sugjerim fillestar për të parë mundësinë e nënshkrimit të një marrëveshjeje për një ekip hetimor të përbashkët (EHP).

Asokohe unë, por me shumë gjasë edhe shumë prokurorë të tjerë, nuk kishim njohuri për qëllimin, procedurat e madje as për mundësinë e ngritjes së një EHP-je. Ndërkohë që kjo mungesë ndërjegjësimi po zvogëlohet me shpejtësi në mbarë rajonin, ky Manual synon të jetë një burim për të trajtuar boshllëqet ekzistuese të njohurive dhe për të nxitur përdorimin e efektshëm të EHP-ve.

Përgatitja e këtij manuali i ka fillesat në projektin “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: fuqizimi i Rrjetit të Prokurorëve”, i cili udhëhiqet nga një konsorcium i përbërë nga *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH* (partneri kryesues; [www.giz.de](http://www.giz.de)) dhe *Qendra Holandeze për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar* ([www.cilc.nl](http://www.cilc.nl)), Të dy partnerët në konsorcium bashkëpunojnë ngushtë me prokuroritë holandeze, gjermane dhe sllovene, *Shoqatën Ndërkombëtare të Prokurorëve (IAP)*, si edhe me *EUROJUST, Rrjetin Gjyqësor Evropian për Çështjet Penale* (të dyja me qendër në Hagë të Vendeve të Ulëta) dhe Grupin Këshillimor të Prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG) me qendër në Bukuresht të Rumanisë.

Ky projekt rajonal mbulon Ballkanin Perëndimor (Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Serbinë si edhe Kosovën\*) me kohëzgjatje 29,5 muajsh. Objektivi i

\* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GJND-së “Për deklaratën e pavarësisë së Kosovës

përgjithshëm i projektit është përpjekja për të përmirësuar dhe promovuar bashkëpunimin gjyqësor ndërkuftar dhe ndërkombëtar në vendet përfituese për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimin ndërkuftar, në veçanti krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ky manual e mbështet këtë objektiv me fuqizimin e dijeve rajonale për EHP-të, duke vepruar si një udhëzues praktik për vënien në zbatim të tyre në luftën kundër krimit ndërkuftar.

Me mbështetjen e partnerëve të konsorciumit dhe rrjetit të prokurorëve, ky manual është shkruar nga një ekspert i cili i është qasur krijimit të tij me entuziazëm dhe energji të reja. Jošt JESENIČNIK ka krijuar një tekst të vlefshëm, aq konciz sa të mos e humbasë vëmendjen e lexuesit, por që sidoqoftë i përfshin të gjitha informacionet që duhet të ketë një prokuror kur nis veprimtaritë e lidhura me ngritjen e një EHP-je. Nuk ka dyshim që ky manual do të jetë një mjet i dobishëm jo vetëm për prokurorët që nuk kanë njohuri të mëparshme për këtë temë, por edhe për ata që duan t'i rifreskojnë njohuritë e tyre.

Në të njëjtën kohë, manuali është një udhëzues i vyer lidhur me legjislacionin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, për ngritjen e një EHP-je, siç ka qenë në fuqi në dhjetor 2013. Sigurisht, me kalimin e kohës, aktet ligjore do të ndryshohen nga ligjvënësit, por tabulati i ligjeve përkatëse i paraqitur në këtë manual në të ardhmen do ta ndihmojë lexuesin të gjejë dispozitat përkatëse në një kohë dhe vend të caktuar (në të ardhmen).

Besoj se ky manual mund të zgjidhë me sukses shumë keqkuptime dhe vonesa fillestare në bashkëpunimin ndërkuftar për çështjet penale. Për këtë arsye, e kam veçanërisht për nder të kontribuoj me këtë parathënie të manualit. Me kënaqësi të madhe po jua prezantoj, për ta lexuar dhe me shpresë për ta bërë pjesë të shumë hetimeve penale të suksesshme.

## I. Sfondi

Mënyrat moderne të komunikimit dhe mundësitë e shpejta të udhëtimit, po e shndërrojnë botën në një fshat global. Shumica e kufijve nëpër botë janë hequr tashmë, prandaj njerëzit dhe mallrat lëvizin pa problem nga një vend në tjetrin. Edhe pse kjo është arritje e qytetërimit, ky proces ka një të metë që nuk mund të shmanget lehtësisht. Në mundësinë e njerëzve për të lëvizur lirshëm nga një vend në tjetrin, përfshihet edhe mundësia që kriminelët të përdorin këtë liri për të kryer vepra penale në shumë vende ose të përpiqen t'i shmangen ndjekjes penale duke u larguar përtej kufijve.

Ndërsa janë hequr barrierat kufitare për njerëzit dhe mallrat, ato ekzistojnë akoma për juridiksionin dhe procedurën penale të shteteve. Për të luftuar kriminelët dhe grupet e reja kriminale “ndërkombëtare”, shtetet duhej që të bënin rregullime në procedurën e tyre penale dhe të pranonin nevojën për më shumë bashkëpunim ndërkombëtar.

Në nevojën për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar në çështje penale, është prezantuar një mekanizëm i ri - Ekipet e Përbashkëta Hetimore (EPH). Ekipi i Përbashkët Hetimor është një mekanizëm që ndihmon dhe lehtëson hetimin specifik të krimit ndërkufitar dhe rrit besimin reciprok. Shtetet që kanë marrë pjesë në një EPH shpesh kanë shfaqur gatishmërinë më të madhe për të përdorur EPH-të dhe forma të tjera të bashkëpunimit ndërkufitar.

Përdorimi i EPH si një mekanizëm bashkëpunimi ndërkombëtar në çështje penale u bë i mundur për vendet përfituese nëpërmjet nënshkrimit dhe ratifikimit të Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë. Pas hyrjes në fuqi të dispozitave të Protokollit të Dytë në vendet përfituese, disa prej tyre (Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia) miratuan këtë institut në legjislacionin e tyre kombëtar.

Manuali mbi Ekipet e Përbashkëta Hetimore për Vendet Përfituese është një mekanizëm për prokurorët e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës,



Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Serbisë dhe Kosovës\* që do t'i orientojë nga momenti i vendimit për krijimin e një EPH gjatë gjithë procesit të nevojshëm për të krijuar një EPH. Ekipet e Përbashkëta Hetimore nuk janë mekanizmi i vetëm apo gjithmonë i duhur në hetimin ndërkufitar. Prokurorët e Vendeve Përfituese duhet të jenë të dijeni të përfitimeve të konsiderueshme dhe duhet të jenë në gjendje që të marrin vendime të informuara për përdorimin e tyre. Qëllimi kryesor i këtij Manuali është që të informojë profesionistët e Vendeve Përfituese për bazën ligjore dhe kërkesat për të krijuar një EPH dhe që të japë këshilla në lidhje me kohën dhe mënyrën e përdorimit të një EPH. Njëkohësisht synohet që Manuali të jetë një udhëzues për të shmangur keqkuptimet në lidhje me Ekipet e Përbashkëta Hetimore, për të inkurajuar profesionistët që të përdorin këtë mekanizëm të ri me qëllim që të rritet vlera e hetimeve dhe për të ndihmuar në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështje penale në përgjithësi.

---

\* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GJND-së "Për deklaratën e pavarësisë së Kosovës"

## II. Ekipi i Përbashkët Hetimor (EPH)

Ekipi i Përbashkët Hetimor (EPH) është një ekip hetimor i krijuar për një periudhë të caktuar, bazuar në një marrëveshje mes dy ose më shumë vendeve ose autoriteteve të tjera kompetente për hetimin e një vepre penale specifike. (Përkufizimi i modifikuar i Europol-it për një EPH).

Nga përkufizimi i EPH mund të nxirren pesë elementë bazë:

- elementi ndërkombëtar,
- marrëveshja formale,
- hetimi i përbashkët,
- elementi kohë, dhe
- vepra penale specifike.

### ***Elementi ndërkombëtar***

Thelbi i Ekipeve të Përbashkëta Hetimore është nevoja për hetim ndërkombëtar të një veprimtarie kriminale ndërkufitare. Ekipet e Përbashkëta Hetimore nuk krijohen nisur nga shkalla e rëndesës së krimit, por nisur nga dimensionimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar i krimit.

Në lidhje me këtë fakt, Ekipet e Përbashkëta Hetimore duhet të krijohen kur hetimi i veprave penale kërkon hetim të vështirë dhe kërkues që lidhet me autoritetet e vendeve të ndryshme dhe kur autoritetet e vendeve të ndryshme hetojnë vepra penale, natyra e të cilave bën të nevojshëm veprimin e koordinuar dhe të bashkërenduar në vende të ndryshme.

### ***Hetimi i përbashkët***

Metodat ekzistuese të hetimit në disa raste janë konsideruar të pamjaftueshme për të luftuar me efektivitet krimin e rëndë ndërkufitar. Për të hetuar dhe ndjekur penalisht format moderne të veprave penale ndërkombëtare është i nevojshëm bashkëpunimi i shpejtë dhe efikas ndërmjet autoriteteve kompetente të vendeve të ndryshme.

U gjykua që krijimi i një ekipi hetuesish dhe autoritetesh gjyqësore nga dy ose më shumë shtete, që do të punonin së bashku me kompetencë dhe siguri juridike të qartë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve, do të përmirësonte luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar. Ky bashkëpunim do të çonte në hetime të koordinuara të kryera në vende të ndryshme dhe kjo do të sillte përfitime për të gjithë vendet pjesëmarrëse.

Gjithashtu, prokurorët në mënyrë të drejtpërdrejtë do të marrin informacionin e mbledhur në vende të tjera dhe do të jenë në gjendje që të paraqesin kërkesa pranë gjykatave vendore si ekspertë të legjislacionit të brendshëm, duke shmangur kështu gabimet ose mungesat në kërkesa.

Avantazhet e krijimit të një EPH janë në veçanti:

- mundësia dhe aftësia për të ndarë informacion drejtpërdrejt ndërmjet anëtarëve të EPH pa qenë nevoja për kërkesa formale,
- kompetenca për të kërkuar masa hetimore ndërmjet anëtarëve të ekipit në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa qenë nevoja për letër porosi (kjo vlen gjithashtu për kërkesat për masa shtrënguese),
- mundësia e anëtarëve të EPH që të jenë të pranishëm në kontrolle banese, intervista, etj në të gjitha juridiksionet e mbuluara, për të ndihmuar në tejkalimin e pengesave gjuhësore gjatë intervista etj.,
- mundësia për të koordinuar përpjekjet në terren dhe për shkëmbimin formal të njohurive të specializuara, dhe
- mundësia për të përcaktuar strategjitë optimale të hetimit dhe ndjekjes.

Një nga avantazhet kryesore të hetimit nga një EPH është gjithashtu mundësia për t'i kërkuar në terren autoritetit të huaj që të marrë parasysh kërkesat ligjore gjatë mbledhjes së provave ose mundësia që hetuesit e një vendi i huaj të jenë të pranishëm në marrjen e një mase hetimore. Në këtë mënyrë, anëtarët e EPH mund të sigurojnë gjithashtu plotësimin e të gjitha kërkesave të procedurës penale të brendshme dhe shmangien e përjashtimit të provave.

## **Ekipi**

Ekipi krijohet në shtetin ku pritet që të kryhet pjesa më e madhe e hetimit. Njëkohësisht, në fazën fillestare të hartimit të marrëveshjes, duhet të merret parasysh vendndodhja gjeografike e hetimit; nëse nga hetimi shfaqet

një tjetër fushë veprimtarie, duhet të lejohet dhe madje të parashikohet fleksibilitet.

Një grup hetuesish dhe stafi tjetër, i dy ose më shumë vendeve, duhet të mblidhen së bashku në afërsi të vendit të hetimit. Kjo nënkupton një grup personash të cilët punojnë përkohësisht jashtë vendit të tyre siç mund të jetë, në shumë raste sidomos kur nuk ka pengesa gjuhësore, një situatë ideale, që vlen për shumicën e Vendeve Përfituese. Megjithatë, nuk ka ndonjë kërkesë ose detyrim që anëtarët e EPH të punojnë jashtë vendit të tyre, edhe nëse EPH e ka bazën e përhershme në një vend tjetër. Në fakt, EPH mund të formohet me anëtarët e dy ose më shumë vendeve edhe nëse asnjë prej tyre nuk punon jashtë vendit të tij - kjo është praktikë e zakonshme për EPH ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së.

Kur krijohet Ekipi, duhet të mbahen parasysh veçanërisht aftësitë gjuhësore të anëtarëve të Ekipit me qëllim që të mundësohet dhe të inkurajohet komunikimi ndërmjet tyre dhe që të shmangen vështirësitë dhe ndërlikimet e panevojshme të cilat lidhen me përkthimin.

## Drejtuesi i EPH

Struktura e qartë e drejtimit është thelbësore për punën e mirë në ekip. Prandaj, çdo EPH duhet të ketë një drejtues Ekipi (ose më shumë drejtues Ekipi, nëse është e nevojshme). Drejtuesi i EPH duhet të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi të mira komunikimi me anëtarët e EPH. Kuadri ligjor ndërkombëtar zakonisht nuk e specifikon se kush duhet të jetë Drejtues, por përvoja ka treguar që është shumë e nevojshme që drejtuesi i EPH të jetë prokuror, për faktin se hetimi duhet të kryhet me vizionin e një procedure penale të mëvonshme. Disa legjislacione kombëtare e kanë miratuar këtë ide.<sup>1</sup>

Një EPH mund të ketë më shumë sesa një drejtues. Ndoshta vendet që marrin pjesë në një EPH do të preferonin të kishte drejtues nga çdo vend pjesëmarrës. Në këtë mënyrë çdo drejtues përkatës i EPH mund të mbikëqyrë ekzekutimin e masave hetimore në vendin e tij si ekspert kombëtar. Ky lloj drejtimi quhet strukturë drejtimi “e rrjedhshme”; në varësi të shtrirjes gjeografike të operacionit. Ky drejtim kërkon komunikim të vazhdueshëm

<sup>1</sup> Për shembull neni 24 paragrafi 6 i Ligjit të Bosnjë-Hercegovinës për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale

ndërmjet drejtuesve të ekipit për të shmangur situata ku anëtarët e EPH do të merrnin udhëzime të ndryshme ose madje kontradiktore nga drejtues të ndryshëm të Ekipit.

Shteteve, në bazë të veçantive rast pas rasti, u takon që të marrin vendimin për drejtuesin e EPH. Disa vende mund të mos kenë dispozita kombëtare për drejtuesit e EPH, por është e mundur që disa vende të tjera që marrin pjesë në një EPH të kenë dispozita kombëtare të cilat duhet të ndiqen.

Pyetja nëse një EPH duhet të ketë një drejtues apo më shumë se një duhet të zgjidhet dhe të vendoset në një takim/komunikim përpara se të përfundohet një marrëveshje për EPH.

### ***Marrëveshja formale<sup>2</sup>***

Marrëveshja për EPH është një marrëveshje formale ndërmjet dy ose më shumë vendeve ose autoriteteve të tjera kompetente, e cila duhet të përgatitet dhe të nënshkruhet nga autoritetet kompetente. Marrëveshja formalizohet dhe duhet të përmbajë të gjithë elementët e nevojshëm për të shmangur mosmarrëveshje apo keqkuptime të mëvonshme.

Një marrëveshje formale duhet të përmbajë gjithmonë:

- A) Së pari, si një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve sovrane, duhet të ketë të gjitha elementet e një marrëveshjeje ndërkombëtare të caktuar:
  - bazën ligjore të marrëveshjes për EPH,
  - palët në marrëveshje (shtetet dhe autoritetet kompetente),
  - pjesëmarrësit në marrëveshje (organet ndërkombëtare),
  - qëllimin e EPH (informacion për veprën penale),
  - periudhën që mbulon marrëveshja,
  - vendndodhjen ku do të veprojë EPH.
  
- B) Së dyti, në bazë të praktikave të mira, dispozitave të disa vendeve<sup>3</sup> dhe rekomandimeve të EUROJUST-it për Shtetet Anëtare të BE-së, marrëveshja duhet të përmbajë gjithashtu:

---

<sup>2</sup> Modeli i një marrëveshjeje për EPH gjendet në Shtojcën 3

<sup>3</sup> Bosnja-Hercegovina (anëtarë të ekipit, drejtues të EPH, qëllimi/plan veprimi, kompetenca, periudha/kohëzgjatja, kushte të veçanta të masave hetimore të marra në BE,

- një Plan Veprimi Operacional,
- mënyrën e komunikimit me ekipin (gjuha, përkthyesit etj)
- drejtuesin ose drejtuesit e EPH,
- anëtarët e EPH dhe rolet dhe kompetencat e tyre,
- dispozitat për anëtarët e deleguar,
- metodat e sigurimit të provave,
- rregullat e përdorimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe provave,
- metodën e përdorimit dhe dhënies së informacionit dhe provave të mbledhura,
- zgjidhjen e konfliktit,
- kushtet e veçanta të marrëveshjes, dhe
- dispozita për vlerësimin e brendshëm.

Marrëveshja formale është gjithnjë rezultat i kërkesës për krijimin e një EPH dhe i negociatave që pasojnë këtë kërkesë. Në disa vende përfituese (Shqipëria, Kosova, Mali i Zi), kjo kërkesë fillestare duhet të jetë në formën e një Letër Porosie, duhet të dërgohet nëpërmjet Ministrisë (Bosnjë-Hercegovinë) dhe në disa vende përfituese mund t'i dërgohet direkt autoritetit kompetent (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kroacia).

Këshillohet që të merret koha e mjaftueshme për hartimin e marrëveshjes dhe që në këtë fazë paraprake të merren parasysh të gjitha çështjet e mundshme. Duhet të përcaktohen të gjitha pengesat dhe sfidat e parashikueshme si edhe mundësitë për t'i zgjidhur ato me qëllim që të shmangen debate dhe argumente që çojnë në humbjen e kohës gjatë hetimit.

### ***Elementi kohë***

Qëllimi i një EPH sipas përkufizimit është krijimi i një ekipi hetimor për një periudhë të caktuar kohore. Nuk është e mundur që një EPH të krijohet si ekip operacional i përhershëm.

---

përfshirja e vendeve të treta, rregulla për shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit dhe provave), Kroacia (dispozita të Ndihmës së Ndërsjellë Juridike për shtetet e BE-së), Mali i Zi (përkufizimi i veprës penale, prania e zyrtarëve të huaj kur hetimi kryhet në Malin e Zi, rregulla për përdorimin e provave), ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (përkufizimi i veprës penale, përgjegjësia penale e anëtarëve të deleguar të EPH, rregulla për shkëmbimin dhe përdorimin e provave)

Elementi kohë është thelbësor për vendet pjesëmarrëse që të caktojnë burimet e tyre për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale ndërkufitare specifike. Gjithashtu, në të gjitha vendet përfituese masat e fshehta janë të kufizuara në kohë dhe për periudha të ndryshme kohore. Këto kufizime duhet të pasqyrohen në marrëveshjen për EPH dhe plani operacional duhet të jetë në përputhje me to. Duke pasur këtë parasysh, anëtarët e EPH do të jenë në gjendje të bëjnë një plan kohor realist për hetimin dhe të krijojnë një plan veprimi që të parashikojë kohën e nevojshme për realizimin e një mase të caktuar hetimore.

### **Vepra penale specifike**

Qëllimi i një Ekipi të Përbashkët Hetimor është hetimi i një çështjeje të caktuar penale. Sipas legjislacionit të zbatueshëm ndërkombëtar dhe legjislacioneve të vendeve përfituese, nuk është e mundur që EPH të krijohet si një *task force* përgjithësisht kompetente për një lloj të caktuar krimi.

Vendet pjesëmarrëse dhe anëtarët e EPH duhet të kenë ide të njëjtë dhe të qartë për qëllimin e bashkëpunimit të tyre. Prandaj, vepra penale që do të hetohet duhet të përcaktohet qartë në përkufizimin ligjor dhe në situatën faktike të dyshuar. Të dyshuarit duhet të jenë të identifikueshëm dhe roli i tyre në veprën penale duhet të jetë i përcaktueshëm.

Ky specifikim do të mundësojë që çdo vend pjesëmarrës i mundshëm të hetojë të dyshuarit dhe/ose veprën penale përpara se të komunikojë me autoritetet e vendeve të tjera që mund të marrin pjesë në EPH. Gjithashtu, mbledhja dhe ndarja e informacionit përpara fillimit të EPH ndihmon anëtarët që të shohin panoramën më të gjerë të veprës penale në këtë fazë të hershme dhe rrjedhimisht që të jenë në gjendje të fillojnë të ndërmarrin menjëherë veprimet përkatëse.

Vendet pjesëmarrëse meqë do të hetohet një vepër penale specifike do të duhet që të zgjedhin prokurorin dhe hetuesit më të kualifikuar për t'u bërë anëtarë të EPH.

### III. PROCEDURA HAP PAS HAPI

Për krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor, duhet të ndiqen hapat e thjeshtë të renditura më poshtë. Këto hapa do t'ju udhëheqin gjatë procesit dhe do t'ju ndihmojnë të kujtoni që të merrni parasysh të gjitha aspektet e rëndësishme të një EPH. Në këtë mënyrë mund të shmangni me sukses mosmarrëveshjet ose keqkuptimet e ardhshme në lidhje me kryerjen e hetimit.

#### 7 HAPA PËR KRIJIMIN E NJË EPH

- 1) përcaktimi i veprës penale (elemente për EPH- elementi ndërkombëtar),
- 2) vështrimi i përgjithshëm i kuadrit ligjor (ndërkombëtar, të brendshëm, të huaj),
- 3) kontakti me autoritetet e huaja (takimi) - marrëveshje për elementet kryesore (çështja, koha, metoda e bashkëpunimit, palët në EPH, financimi),
- 4) kërkesa për krijimin e një EPH,
- 5) hartimi i një marrëveshjeje formale,
- 6) nënshkrimi i marrëveshjes,
- 7) realizimi i marrëveshjes- Plan Veprimi Operacional.

#### ***(1) Përcaktimi i veprës penale***

Hapi i parë në procesin e krijimit të një EPH është studimi me hollësi i informacionit të siguruar tashmë për veprën penale ndërkufitare dhe për të dyshuarit me qëllim identifikimin e nevojës dhe avantazheve të krijimit të një EPH.

Prokurori duhet të jetë veçanërisht vigjilent për elementët ndërkombëtarë të veprës penale për të justifikuar përdorimin e këtij lloji bashkëpunimi ndërkombëtar.

Është e nevojshme që të kontaktohen në mënyrë informale prokurori ose autoriteti kompetent i vendeve të tjera që do të mund të përfshiheshin, në lidhje me informacionin që ata kanë për çështjen. Kontaktet informale



mund të vendosen nëpërmjet njohjeve profesionale që mund të ketë prokurori në vendin e huaj. Nëse nuk është rasti i tillë, komunikimi mund të vendoset me ndihmën e policisë.

Prokurori duhet të peshojë nga njëra anë avantazhet që do të sjellë EPH dhe nga ana tjetër pasojat administrative që do të ketë EPH dhe koston që do të kërkojë. Vetëm me këtë informacion është e mundur që të merret një vendim i informuar për krijimin e një EPH. Megjithatë në fund gjithmonë vendimi merret rast pas rasti.

## ***(2) Kuadri ligjor (i brendshëm, i huaj)***

Pasi të përcaktohet që një vepër penale duhet të hetohet nga një EPH, është e nevojshme që të përcaktohet baza ligjore mbi të cilën do të hartohet marrëveshja për EPH dhe mbi të cilën do të veprojë EPH. Një bazë ligjore e përcaktuar si duhet është thelbësore. Kjo përcakton fatin e marrëveshjes për EPH dhe rrjedhimisht pranueshmërinë e provave të mbledhura nëpërmjet këtij hetimi.

Për të përcaktuar bazën ligjore për një EPH, prokurori duhet të marrë parasysh legjislacionin e brendshëm dhe të huaj dhe dokumentet ligjore ndërkombëtare që janë të detyrueshme për vendet që marrin pjesë në EPH.

Meqë nuk ka kuptim që të shikohen të gjitha kombinimet e mundshme të vendeve, kuadri legjislativ kombëtar do të prezantohet për çdo vend përfitues veçmas, pas prezantimit të kuadrit ligjor ndërkombëtar të zbatueshëm për shumicën e vendeve përfituese.

## **A- KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR**

Sipas së drejtës ndërkombëtare, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare kanë epërsi mbi legjislacionit kombëtar dhe qëndrojnë në të njëjtin nivel si kushtetutat kombëtare. Prandaj, dispozitat e konventave, traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe, kanë epërsi mbi legjislacionin kombëtar.

## 1) PROTOKOLLI I DYTË SHITESË I KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJE PENALE - Nenet 20, 21, 22 - Ekipet të Përbashkëta Hetimore<sup>4</sup>

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi	Hyrja në fuqi
Shqipëria	13/11/2001	20/6/2002	1/2/2004
Bosnjë-Hercegovina	17/5/2006	7/11/2007	1/3/2008
Kroacia	9/6/2004	28/3/2007	1/7/2007
Mali i Zi	7/4/2005	20/10/2008	1/2/2009
Serbia	7/4/2005	26/4/2007	1/8/2007
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	8/11/2001	16/12/2008	1/4/2009

<http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=182&CM=7&DF=&CL=-ENG>

Ky Protokoll ofron bazën ligjore për krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor në çështje me vepra penale të cilat kërkojnë hetim të vështirë dhe kërkues që ka lidhje me vende të tjera, ose në çështje për të cilat disa vende hetojnë vepra penale, rrethanat e të cilave bëjnë të nevojshëm veprime të koordinuara dhe të bashkërenduara në vendet e përfshira. Kërkesa fillestare duhet të përmbajë një propozim për përbërjen e Ekipit. Protokollin parashikon gjithashtu që drejtuesi i EPH të jetë përfaqësues i autoritetit kompetent të vendit ku do të veprojë EPH. Operacionet e EPH duhet të jenë në përputhje me ligjet kombëtare të vendit ku vepron. Protokollin përmban gjithashtu dispozita për anëtarët e deleguar të EPH, ekzekutimin e disa masave hetimore, kërkesat drejtuar vendeve të treta (jo anëtare të EPH), rregullat e shkëmbimit të informacionit, rregullat e përdorimit të informacionit, pjesëmarrjen e vendeve të treta në masat hetimore të EPH, përgjegjësinë penale dhe civile të nëpunësve që marrin pjesë në masat hetimore të EPH në një vend tjetër.

Vëreni që Austria, Gjermania, Italia, Qipro, Turqia dhe disa shtete të tjera në Europë nuk e kanë miratuar Protokollin e Dytë, ndërsa ky Protokoll është miratuar nga shtetet jo europiane, Kili dhe Izraeli.

<sup>4</sup>Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor ndërkombëtar gjenden në Shtojcën 2

## 2) KONVENTA E BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EUROPËN JUGLINDORE - Neni 27 - Ekiye të Përbashkëta Hetimore<sup>5</sup>

Vendet përfituese kanë miratuar këtë Konventë si më poshtë:

Shteti	Data e ratifikimit	Data e depozitimit të ratifikimit (e pritshme)	Hyrja në fuqi e Konventës (e pritshme)
Shqipëria	11/9/2006	31/5/2007	10/10/2007
Bosnjë-Hercegovina	11/4/2007	17/7/2007	15/10/2007
Mali i Zi	26/12/2007	28/1/2008	1/5/2008
Serbia	23/7/2007	10/9/2007	11/12/2007
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	1/6/2007	12/7/2007	10/10/2007

<http://www.pccseesecretariat.si/index.php?page=documentspcc&item=35>

Kjo Konventë ofron bazën ligjore për krijimin e një Ekipe të Përbashkët Hetimor në çështje me vepra penale të cilat kërkojnë hetim të vështirë dhe kërkues që ka lidhje me vende të tjera, ose në çështje për të cilat disa vende hetojnë vepra penale, rrethanat e të cilave bëjnë të nevojshëm veprime të koordinuara dhe të bashkërenduara në vendet e përfshira. Kërkesa për një EPH mund të bëhet nga çdo vend i përfshirë. Ekipe krijohet në një nga vendet ku pritet që të kryhet hetimi. Kërkesa për krijimin e një Ekipe të Përbashkët Hetimor përmban titullin e autoritetit që bën kërkesën, qëllimin e Ekipe të Përbashkët Hetimor, vendin ku do të veprojë Ekipe i Përbashkët Hetimor dhe propozime për përbërjen e Ekipe të Përbashkët Hetimor. Konventa parashikon gjithashtu që drejtuesi i EPH të jetë përfaqësues i autoritetit kompetent të vendit ku do të veprojë EPH. Operacionet e EPH duhet të jenë në përputhje me ligjet kombëtare të vendit ku vepron. Konventa përmban dispozita për anëtarët e deleguar të EPH, ekzekutimin e disa masave hetimore, kërkesat drejtuar vendeve të treta, rregullat e shkëmbimit të informacionit, rregullat e zbatimit të informacionit, pjesëmarrjen e vendeve të treta në masat hetimore të EPH.

Anëtarët e tjerë në këtë Konventë janë: Austria, Bullgaria, Hungaria, Moldavia, Rumania dhe Sllovenia.

<sup>5</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor ndërkombëtar gjenden në Shtojcën 2

**Baza ligjore ndërkombëtare shtesë që mund të përdoret gjithashtu me një interpretim më të gjerë juridik (ndihmë e ndërsjellë në masën më të madhe të mundshme):**

### **3) KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR - Neni 19 - Ekipet të Përbashkëta Hetimore<sup>6</sup>**

Vendet përfituese kanë miratuar këtë Konventë si më poshtë:

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikim, Pranim (A), Miratim (AA), Aderim (a), Trashëgim (d)
Shqipëria	12/12/2000	21/8/2002
Bosnjë-Hercegovina	12/12/2000	24/4/2002
Kroacia	12/12/2000	24/1/2003
Mali i Zi		23/10/2006
Serbia	12/12/2000	6/9/2001
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	12/12/2000	12/1/2005

[http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg\\_no=XVIII-12&chapter=18&lang=en](http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12&chapter=18&lang=en)

Konventa zbatohet për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të:

- pastrimit të produkteve të krimit,
- korrupsionit,
- pengimit të drejtësisë,
- krimit të rëndë - që do të thotë një vepër penale e dënueshme me të paktën katër muaj heqje lirie ose një masë ndëshkimore më të rëndë

kur vepra penale ka natyrë ndërkombëtare dhe përfshin një grup të organizuar kriminal.

Kjo Konventë parashikon që vendet të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe për krijimin e Ekipëve të Përbashkëta Hetimore për hetimin e krimeve ndërkombëtare që trajtohen në këtë Konventë. Në mungesë të këtyre marrëveshjeve ose rregullimeve, hetimi i përbashkët mund të

<sup>6</sup>Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor ndërkombëtar gjenden në Shtojcën 2

ndërmerret me marrëveshje rast pas rasti. Njëkohësisht Konventa përcakton detyrimin për të siguruar sovranitetin e shteteve pjesëmarrëse në EPH.

Kjo Konventë nuk ofron ndonjë veçanti në lidhje me krijimin e një EPH, si për shembull përbërjen e një EPH, marrëveshjen, përgjegjësinë penale dhe civile të anëtarëve të EPH, etj.

Gjithsej 179 shtete janë palë të kësaj Konvente, mes tyre Austria, Qipro, Gjermania, Finlanda dhe Italia.

#### **4) KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KORRUPSIONIT- Neni 49- Hetime të Përbashkëta<sup>7</sup>**

Vendet përfituese kanë miratuar këtë Konventë si më poshtë:

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi, Pranimi (A), Miratimi (AA), Aderim (a), Trashëgim (d)
Shqipëria	18/12/2003	25/5/2006
Bosnjë-Hercegovina	16/9/2005	26/10/2006
Kroacia	10/12/2003	24/4/2005
Mali i Zi		23/10/2006 d
Serbia	11/12/2003	20/12/2005
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	18/8/2005	13/4/2007

<http://www.unodc.org/unodc/en/treaties/CAC/signatories.html>

Kjo Konventë parashikon që vendet të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe për krijimin e Ekipeve të Përbashkëta Hetimore për hetimin e krimeve ndërkombëtare që trajtohen në këtë Konventë. Në mungesë të këtyre marrëveshjeve ose rregullimeve, hetimi i përbashkët mund të ndërmerret me marrëveshje rast pas rasti. Njëkohësisht Konventa përcakton detyrimin për të siguruar sovranitetin e shteteve pjesëmarrëse në EPH.

Kjo Konventë nuk parashikon dispozita për procedurën e krijimit të një EPH, as për çështje operationale të një EPH.

<sup>7</sup>Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor ndërkombëtar gjenden në Shtojcën 2

Gjithsej 168 shtete janë palë e kësaj Konvente, mes të cilave Austria dhe Qipro, por jo Gjermania apo Republika Çeke.

### **5) KONVENTA PËR PASTRIMIN, KËRKIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT DHE PËR FINANCIMIN E TERRORIZMIT- Kreu IV, Seksioni 2 - Ndhma për hetim - Neni 16 - Detyrimi për të ndihmuar<sup>8</sup>**

Kjo Konventë u miratua nga Vendet Përfituese si më poshtë:

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi	Hyrja në fuqi
Shqipëria	22/12/2005	6/2/2007	1/5/2008
Bosnjë-Hercegovina	19/1/2006	11/1/2008	1/5/2005
Kroacia	29/4/2008	10/10/2008	1/2/2009
Mali i Zi	16/5/2005	20/10/2008	1/2/2009
Serbia	16/5/2005	14/4/2009	1/8/2009
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	17/11/2005	27/5/2009	1/9/2009

<http://conventions.coe.int/treaty/Commun/QueVoulezVous.asp?NT=198&CM=0&CL=ENG>

Kjo Konventë ofron bazën ligjore për ndihmën më të madhe të mundshme në identifikimin dhe zbulimin e modaliteteve, produkteve dhe pasurive të tjera subjekt konfiskimi. Ky spektër i gjerë ndihme përfshin gjithashtu krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor.

### **6) KONVENTA PËR KRIMIN NË FUSHËN E KIBERNETIKËS - Titulli 3 - Parime të përgjithshme në lidhje me ndihmën e ndërsjellë - Neni 25 - Parime të përgjithshme në lidhje me ndihmën e ndërsjellë<sup>9</sup>**

Kjo Konventë dhe Relacioni i saj u miratuan nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në Sesionin e 109 (8 nëntor 2001) dhe Konventa u hap për nënshkrim në Budapest, më 23 nëntor 2001, me rastin e Konferencës Ndërkombëtare për krimin kibernetik. Vendet përfituese kanë miratuar këtë Konventë si më poshtë:

<sup>8</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor ndërkombëtar gjenden në Shtojcën 2

<sup>9</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor ndërkombëtar gjenden në Shtojcën 2

Shtetet	Nënshkrimi	Ratifikimi	Hyrja në fuqi
Shqipëria	23/11/2001	20/6/2002	1/7/2004
Bosnjë Hercegovina	9/2/2005	19/5/2006	1/9/2006
Kroacia	23/11/2001	17/10/2002	1/7/2004
Mali i Zi	7/4/2005	3/3/2010	1/7/2010
Serbia	7/4/2005	14/4/2009	1/8/2009
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	23/11/2001	15/9/2004	1/1/2005

<http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=185&CM=&DF=&CL=ENG>

Kjo Konventë ofron shtrirjen më të madhe të mundshme të ndihmës për qëllim të hetimit ose ndjekjes së veprave penale që lidhen me sisteme dhe të dhëna kompjuterike ose për qëllim të mbledhjes në formë elektronike të provave që lidhen me një vepër penale. Konventa përcakton gjithashtu komunikimin e drejtpërdrejtë në çështje emergjente, ngushton arsyet për refuzim dhe zgjeron fushën e krimit të dyfishtë.

Konventa është ratifikuar nga shumica e shteteve anëtare të Këshillit të Europës përveç Greqisë, Lihtenshtejnit, Suedisë dhe Turqisë. Gjithashtu Australia, Japonia dhe SHBA janë palë e kësaj Konvente.

**Sa herë që ndonjë nga Konventat ndërkombëtare të renditura këtu përdoret si bazë ligjore e përbashkët për një EPH konkrete, për çështje që nuk rregullohen nga Konventa përkatëse, vendet e përfshira duhet të konsiderojnë legjislacionet e tyre kombëtare dhe të krijojnë një EPH i cili do të formohet dhe do të vepronte në përputhje me të gjithë legjislacionet kombëtare të përfshira.**

## **B- KUADRI LIGJOR KOMBËTAR**

Në këtë kapitull, kuadri ligjor kombëtar i Vendeve Përfituese paraqitet në tabelë, së bashku me Marrëveshjet Dypalëshe. Ju lutemi të shihni që Marrëveshjet dhe Traktatet Dypalëshe nuk rregullojnë domosdoshmërisht dhe veçanërisht Ekipet e Përbashkëta Hetimore, por mund të konsiderohen në përgjithësi për krijimin e EPH.

**SHQIPËRIA<sup>10</sup>**

- 1) **Kodi i Procedurës Penale -nenet 10 dhe 505**
- 2) **Ligji për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështje Penale - neni 13**
- 3) **marrëveshje dypalëshe:**
  - Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështje penale dhe civile,
  - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale.

**BOSNJË-HERCEGOVINA<sup>11</sup>**

- 1) **Ligji për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale - Nenet 1, 3, 24 dhe 94,**
- 2) **marrëveshje dypalëshe:**
  - Marrëveshja ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Republikës së Kroacisë për ndihmën juridike në çështje penale dhe civile
  - Marrëveshja ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Republikës së Maqedonisë për ndihmën juridike në çështje penale dhe civile, dhe
  - Marrëveshja ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë dhe Malit të Zi për Ndihmën Juridike në Çështje Civile dhe Penale dhe Marrëveshja për Ndryshime të Marrëveshjes - neni 1 dhe 36 a

**KROACIA<sup>12</sup>**

- 1) **Ligji për Zyrën e Avokatit të Shtetit - nenet 71.a deri në 71.i,**
- 2) **Kodi i Procedurës Penale - nenet 201 dhe 202,**
- 3) **Kushtetuta e Kroacisë - neni 141,**

<sup>10</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor kombëtar të Shqipërisë gjenden në Shtojcën 1

<sup>11</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor kombëtar të Bosnjë-Hercegovinës gjenden në Shtojcën 1

<sup>12</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor kombëtar të Kroacisë gjenden në Aneksin 1



4) **Ligji për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështje penale - neni 6,**

5) **Ligji për Zyrën për Shtypjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK) - neni 17,**

6) **marrëveshje dypalëshe:**

- Marrëveshja ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Republikës së Kroacisë për ndihmën juridike në çështje penale dhe civile,
- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës për ndihmën juridike në çështje penale,
- Traktati ndërmjet Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Maqedonisë për ndihmën juridike në çështje penale dhe civile, dhe
- Traktati ndërmjet Republikës së Kroacisë dhe ish-Republikës Jugosllave për ndihmën juridike në çështje penale dhe civile

## **KOSOVA<sup>13</sup>**

1) **Ligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale - nenet 1, 2, 97 dhe 98,**

2) **Kodi i Procedurës Penale - neni 219,**

3) **marrëveshje dypalëshe:**

- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës për ndihmën juridike në çështje penale,
- Marrëveshja për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale.

## **MALI I ZI<sup>14</sup>**

1) **Kushtetuta e Malit të Zi - neni 9,**

2) **Ligji për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale - nenet 2 dhe 42, dhe**

---

<sup>13</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor kombëtar të Kosovës gjenden në Shtojcën 1

<sup>14</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor kombëtar të Malit të Zi gjenden në Shtojcën 1

**3) marrëveshje dypalëshe:**

- Traktati ndërmjet Jugosllavisë dhe Republikës së Kroacisë për ndihmën juridike në çështje penale dhe civile,
- Traktati ndërmjet Serbisë dhe Republikës së Maqedonisë për ndihmën juridike në çështje penale dhe civile, dhe
- Marrëveshja ndërmjet Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështje penale dhe civile

**SERBIA<sup>15</sup>**

**1) Ligji për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale - nenet 1, 4, 83, 84 dhe 96**

**2) Kushtetuta e Republikës së Serbisë - nenet 16 dhe 194,**

**3) marrëveshje dypalëshe:**

- Marrëveshja ndërmjet Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështje penale dhe civile - nenet 33 dhe 36 a,
- Marrëveshja ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi dhe Republikës së Maqedonisë për ndihmën juridike në çështje penale dhe civile- nenet 25 dhe 30, dhe
- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Serbisë dhe Malit të Zi për ndihmën juridike në çështje civile dhe penale - nenet 33 dhe 38

**ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË<sup>16</sup>**

**1) Ligji për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Çështje Penale - nenet 15, 38 dhe 39,**

**2) Kodi i Procedurës Penale - nenet 39 dhe 40,**

**3) Ligji për Prokurorinë - nenet 36 dhe**

**4) marrëveshje dypalëshe:**

<sup>15</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor kombëtar të Serbisë gjenden në Shtojcën 1

<sup>16</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor kombëtar të Maqedonisë gjenden në Shtojcën 1

- Marrëveshje për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike me Serbinë dhe Malin e Zi,
- Marrëveshje për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike me Serbinë,
- Marrëveshje për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike me Malin e Zi,
- Marrëveshje për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike me Kosovën,
- Marrëveshje për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike me Kroacinë,
- Marrëveshje për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike me Bosnjë-Hercegovinën, dhe
- Marrëveshje për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike me Shqipërinë,

## C- PËRMBLEDHJE E BAZËS LIGJORE PËR EPH

### SHQIPËRIA

Legjislacioni i brendshëm i Shqipërisë nuk përmban bazë ligjore të drejtpërdrejtë për krijimin e një EPH. Megjithatë, baza ligjore mund të nxirret nga neni 13 i Ligjit për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështje penale, sipas të cilit bashkëpunimi ndërkombëtar është i mundur në masën që veprimeve të tjera hetimore që nuk janë të ndaluara me ligj.

Neni 10 i Kodit të Procedurës Penale që përcakton se marrëdhëniet me autoritetet e huaja në çështje penale, janë çështje që rregullohen me marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Shqipëria, ofron bazën ligjore për përdorimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të Ekipeve të Përbashkëta Hetimore në Konventa të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Prandaj, si bazë ligjore mund të përdoren dispozitat e:

- nenit 20 të Protokollit të dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale, dhe
- nenit 27 të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (KBP EJI).

Gjithashtu dispozitat e mëposhtme mund të përdoren si bazë ligjore:

- neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar,
- neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,

- neni 16 i Konventës për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, Konfiskimin e Produkteve të Krimin, dhe
- neni 25 i Konventës për Krimin Kibernetik.

Megjithatë, duhet të kemi parasysh që të gjitha instrumentet për bashkëpunimin ndërkombëtar sipas këtyre katër konventave të fundit kufizohen në vepra penale specifike që mbulohen nga këto konventa, ndërsa përdorimi i të gjitha konventave ndërkombëtare kufizohet në bashkëpunimin me shtetet që kanë ratifikuar konventën përkatëse.

Në përfundim, në Shqipëri, baza ligjore për një marrëveshje EPH mund të nxirret nga interpretimi i gjerë i ndihmës juridike ndërkombëtare të Ligjit për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështje Penale dhe nga konventat ndërkombëtare.

Meqë EPH-të nuk janë rregulluar akoma në nivel kombëtar dhe konventat nuk përmbajnë dispozita për autoritetin kompetent në lidhje me EPH, interpretimi duhet të bëhet në përputhje me nenin 505 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 6 të Ligjit për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështje Penale. Nëpërmjet këtij interpretimi, Ministria e Drejtësisë është kompetente që të vendosë në lidhje me pjesëmarrjen në një EPH dhe që të nënshkruajë marrëveshjen për EPH.

Rekomandohet që Republika e Shqipërisë të rregullojë përdorimin e EPH edhe në nivel kombëtar. Mementalisht, ka disa aspekte të këtij bashkëpunimi që mbeten të paqarta. Për shembull, nuk është e qartë cili është autoriteti kompetent për marrjen e kërkesave dhe për krijimin e EPH; nuk ka përkufizim të veprave penale për të cilat mund të krijohet një EPH; nuk ka dispozita për përbërjen e Ekipit (anëtarë dhe drejtues), për elementët që duhet të përfshihen në një marrëveshje për EPH, për kushtet e veçanta të masave hetimore të marra në vend, për rregullat e shkëmbimit të informacionit dhe provave etj. Në këtë mënyrë do të lehtësohej krijimi i një EPH me shtetet që nuk kanë miratuar ndonjë nga Konventat ndërkombëtare të përmendura më sipër.

## **BOSNJË-HERCEGOVINA**

Sipas Ligjit për Ndhimën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Enteve (Federata e Bosnjë-Hercegovinës dhe Republika Srpska) dhe Distriktit Brčko të Bosnjë-

Hercegovinës në lidhje me procedurën për ndihmën juridike ndërkombëtare, harmonizohen me dispozitat e ligjit për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale. Kjo do të thotë që përmbajtja e dispozitave për Ekipet e Përbashkëta Hetimore në Ente (Federata e Bosnjë-Hercegovinës dhe Republika Srpska) dhe në Distriktin Brčko të Bosnjë- Hercegovinës në thelb duhet të jetë njësoj si përmbajtja e dispozitave të Ligjit për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale.

Për çështje penale që janë kompetencë e Gjykatës së Bosnjë- Hercegovinës (neni 7 i Ligjit për Gjykatën e BH) baza ligjore për krijimin e një EPH është neni 24 i Ligjit për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale. Sipas nenit të përmendur, siç lexohet në Ligjin për Zyrën e Prokurorisë të BH, Prokuroria e Bosnjë-Hercegovinës është autoriteti kompetent kombëtar që mund të autorizojë ose të kërkojë krijimin e një EPH.

Në çështje që janë kompetencë e prokurorive të të dyja enteve dhe Distriktit Brčko të Bosnjë-Hercegovinës, baza ligjore për një EPH janë dispozitat e Kodeve të Procedurës Penale që duhet të jenë, nëse/kur të miratohen, në thelb njësoj si dispozita e nenit 24 të Ligjit për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale. Sa kohë që Kodet e Procedurës Penale të të dy Enteve dhe Distriktit Brčko nuk i përmbajnë këto dispozita - dhe aktualisht ato nuk i përmbajnë - Ligji për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale zbatohet direkt për të dy entet dhe Distriktin Brčko. Autoriteti kompetent kombëtar që mund të autorizojë ose të kërkojë krijimin e një EPH në këtë rast do të ishte Prokuroria kompetente e Federatës së BH (një zyrë prokurorie konkrete) dhe Prokuroria kompetente e Republikës Srpska (një Prokurori Distrikti konkrete). Autoriteti kompetent kombëtar që mund të autorizojë ose të kërkojë krijimin e një EPH në Distriktin Brčko është Prokuroria e Distriktit Brčko.

Sipas nenit 24 të Ligjit për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale (dhe dispozitave përkatëse të Kodeve të Procedurës Penale të të dy Enteve dhe Distriktit Brčko), Ekipi i Përbashkët Hetimor mund të krijohet nëse e justifikojnë rrethanat e çështjes së caktuar. Ekipi i Përbashkët Hetimor krijohet me marrëveshje të prokurorisë kompetente dhe autoritetit kompetent gjyqësor të shtetit të huaj. Qëllimi i EPH është kryerja e hetimit për një çështje specifike në territorin e një ose shumë palëve në marrëveshje. Marrëveshja që krijon një Ekip të Përbashkët Hetimor është e kufizuar në kohë.

Marrëveshja për EPH duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- përbërjen e Ekipit (anëtarët dhe drejtuesit),
- detyrat e Ekipit,
- autoritetin/kompetencat e Ekipit, dhe
- periudhën/kohëzgjatjen.

Kërkesa për krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor duhet të dërgohet në formën e Letër Porosive<sup>17</sup> nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së BH drejtuar prokurorisë kompetente në BH. Kërkesa duhet të përmbajë një sugjerim për përbërjen e Ekipit. Këto rregulla zbatohen si për autoritetet e huaja, ashtu edhe për ato të brendshme, kur dërgohet një kërkesë për krijimin e një EPH.

Vendndodhja e Ekipit duhet të jetë në juridiksionin e njëres palë kontraktuese, ku pritët që do të zhvillohet hetimi.

Një Ekip i Përbashkët Hetimor në Bosnjë-Hercegovinë mund të krijohet:

- nëse hetimi i veprës/veprave penale në një shtet kërkon hetim të gjerë dhe në harmoni në lidhje me një shtet tjetër;
- nëse autoritete të ndryshme hetojnë një vepër penale, e cila për nga natyra kërkon qasje të koordinuar në të gjitha vendet e përfshira;
- nëse masat hetimore duhet të ndërmerren njëkohësisht në Bosnjë-Hercegovinë dhe në një shtet të huaj ose në më shumë shtete.

Ekipi i Përbashkët Hetimor mund të veprojë në territorin e BH bazuar në kushtet e mëposhtme:

<sup>17</sup> Letër porosia duhet të ketë të gjitha elementet e një Letër Porosie të parashikuara në nenin 3, paragrafi 4 të Ligjit për Ndhimën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale:

- (4) përveçse kur përcaktohet ndryshe në një traktat ndërkombëtar ose në këtë ligj, letër porosia duhet të përmbajë sa më poshtë:
- a) emrin e autoritetit kërkues, numrin referencë të çështjes, emrin e saktë të shtetit të kërkuar, dhe nëse është e mundur, emrin e autoritetit të kërkuar;
  - a) shkaqet ligjore për të dhënë ndihmë të ndërsjellë juridike;
  - c) përshkrimin specifik të një akti të ndihmës juridike të kërkuar dhe arsyen e kërkesës;
  - d) përkufizimin ligjor të veprës penale dhe një përshkrim të shkurtër të fakteve;
  - e) detaje të saktë personale dhe kombësinë e personit të përfshirë dhe statusin e tij në procedim;
  - f) titullin e dokumenteve dhe emrin dhe adresën e marrësit, nëse letër porosia i referohet dorëzimit të urdhrave gjyqësorë dhe dokumenteve të tjera, dhe
  - g) informacion tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për të dhënë rrugë kërkesës.

- drejtuesi i Ekipit do të jetë prokurori kompetent në BH;
- Ekipi do të kryejë hetimin në përputhje me legjislacionin penal të BH;
- Anëtarët e Ekipit do të punojnë nën mbikëqyrjen e drejtuesit të Ekipit;
- prokuroria kompetente do të marrë të gjitha masat e nevojshme organizative për të plotësuar nevojat e Ekipit.

Anëtarët e huaj të një EPH kanë të drejtën që të jenë të pranishëm kur merren masa hetimore, por drejtuesi i Ekipit të BH mund të vendosë ndryshe nëse ka shkaqe të arsyeshme në përputhje me legjislacionin e BH.

Drejtuesi i Ekipit të BH mund t'i japë anëtarëve të huaj të ekipit autoritetin që të marrin masa hetimore të cilat legjislacioni i BH u ngarkon atyre, me kushtin që autoritetet e huaja kompetente gjyqësore të shtetit që ka deleguar anëtarët e tij, të japin pëlqimin.

Nëse lind nevoja për masa hetimore në territorin e Bosnjë-Hercegovinës, anëtarët e EPH të BH mund t'i kërkojnë autoritetit kombëtar kompetent të BH që të marrë masat hetimore. Masat hetimore më pas merren në përputhje me legjislacionin e BH.

Nëse gjatë hetimit nga EPH në territorin e BH nevojitet ndihmë juridike ndërkombëtare nga një vend i tretë (jo anëtar në EPH), autoriteti kompetent gjyqësor i BH e kërkon këtë ndihmë juridike ndërkombëtare.

Informacioni i mbledhur nga anëtari kombëtar dhe i huaj i EPH të Bosnjë-Hercegovinës gjatë hetimit, kur ky informacion nuk mund të sigurohet në mënyrë tjetër, mund të përdoret nga autoritetet kompetente për qëllimet e mëposhtme dhe sipas kushteve të rrepta:

- për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale për të cilat është krijuar EPH;
- për zbulimin, hetimin ose ndjekjen e veprave të tjera penale, me kushtin që vendi në territorin e të cilit është marrë informacioni nga anëtarët e EPH të japë pëlqimin;
- për të parandaluar keqësimin e afërt dhe të rëndë të sigurisë publike, pa cenuar dispozitën e sipër-përmendur, në rast se më pas fillon hetimi penal;

- për qëllime të tjera nëse është rënë dakord ndërmjet palëve në marrëveshjen për EPH.

Sipas nenit 94 të Ligjit për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale, Ministri i Drejtësisë i Bosnjë-Hercegovinës mund të japë udhëzime shtesë për krijimin e Ekipeve të Përbashkëta Hetimore. Megjithatë, deri tani nuk është nxjerrë asnjë relacion, vendim ministri apo qarkore administrative në lidhje me EPH.

Siç është prezantuar tashmë në kapitullin për Kuadrin Ligjor Ndërkombëtar në Bosnjë-Hercegovinës, baza e mëposhtme ligjore ndërkombëtare për krijimin e një EPH mund të përdoret dhe do të ketë epërsi mbi legjislacionin kombëtar për çështjet që rregullon:

- neni 20 i Protokollit të dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale, dhe
- neni 27 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (KBP EIJL).

Gjithashtu, dispozitat e mëposhtme mund të përdoren si bazë ligjore ndërkombëtare:

- neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar,
- neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,
- neni 16 i Konventës për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, Konfiskimin e Produkteve të Krimit, dhe
- neni 25 i Konventës për Krimin Kibernetik.

Përsëri, duhet të kemi parasysh që të gjitha instrumentet për bashkëpunimin ndërkombëtar sipas këtyre katër konventave të fundit kufizohen në vepra penale specifike që mbulohen nga këto konventa, ndërsa përdorimi i të gjitha konventave ndërkombëtare kufizohet në bashkëpunimin me shtetet që kanë miratuar konventën përkatëse.

## **KROACIA**

Baza ligjore e Kroacisë për një EPH me Shtetet Anëtare të BE-së janë nenet 71.a deri në 71.i të Ligjit për Avokatinë e Shtetit. Për një EPH me shtete jo anëtare të BE-së, baza ligjore janë nenet 201 dhe 202 të Kodit të Procedurës Penale, neni 141 i Kushtetutës Kroate dhe përdorimi i njëjtë i neneve 71.a deri në 71.i të Ligjit për Avokatinë e Shtetit.



Kroacia u bë shtet anëtar i BE-së më 1 korrik 2013, kështu që pranoi të gjithë “Acquis communautaire”. Kroacia nuk e ka ratifikuar akoma Konventën për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështje Penale ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian - 2000 dhe Vendimin Kuadër të Këshillit të 13 qershorit 2002 për Ekipet e Përbashkëta Hetimore. Megjithatë, dispozitat përkatëse të Konventës në fjalë dhe Vendimi Kuadër në fjalë janë transpozuar në legjislacionin kombëtar me ndryshimet në Ligjin për Avokatinë e Shtetit,

Neni 71.a i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që në bazë të një marrëveshjeje të shkruar me autoritetet kompetente të vendeve të huaja, Ekipi i Përbashkët Hetimor mund të krijohet për kryerjen e hetimit të përbashkët të koordinuar të një vepre penale të rëndë, sidomos vepre penale në lidhje me lëndët narkotike, trafikimin e qenieve njerëzore dhe terrorizmin, të kryer në Kroaci dhe në një shtet të huaj.

Neni 71.b i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që kërkesa për krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor duhet të përmbajë të gjithë informacionin e një Letër Porosie në përputhje me aktin për ndihmën juridike ndërkombëtare<sup>18</sup> dhe një sugjerim për përbërjen e Ekipit të Përbashkët Hetimor. Kërkesa për një EPH mund t’i dërgohet direkt autoritetit që duhet të marrë pjesë në EPH ose Ministrisë së Drejtësisë. Në përputhje me ligjin USKOK, departamenti USKOK për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta është përgjegjës për caktimin e anëtarëve të USKOK në hetime të përbashkëta në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 71.c i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që EPH vepron në territorin e Kroacisë ose në një vend të huaj në mënyrë të tillë që gjatë punës

<sup>18</sup> Akti për ndihmën juridike ndërkombëtare - neni 8:

- (3) Përveçse kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje ose traktat ndërkombëtar, kërkesa për ndihmë ndërkombëtare duhet të përmbajë:
1. Vendin e lëshimit dhe emrin e autoritetit të huaj kompetent që dërgon kërkesën.
  2. Bazën ligjore për ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare.
  3. Përshkrimin e saktë të ndihmës juridike ndërkombëtare të kërkuar dhe arsyen e kërkesës për ndihmë juridike ndërkombëtare.
  4. Emrin juridik, një përshkrim të shkurtër faktit dhe ligjor të veprës penale (përveçse kur kërkesa lidhet me dorëzimin e vendimeve gjyqësore, parashtrimeve, dokumenteve etj.).
  5. Të dhëna të sakta për shtetësinë e personit në lidhje me të cilin kërkohet ndihma juridike ndërkombëtare dhe pozicioni i tij në procedurë.
  6. Në rast të dorëzimit të akteve gjyqësore, lloji i aktit që përcillet.

në Kroaci, drejtuesi i EPH të jetë përfaqësues i prokurorisë kompetente ose Zyrës për Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (USKOK); drejtuesi të punojë në përputhje me legjislacionin kroat, ndërsa anëtarët e EPH të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me udhëzimet e drejtuesit të EPH dhe kompetencat e tyre. Republika e Kroacisë ofron të gjithë ndihmën e nevojshme për veprimtarinë e një EPH në territorin e Kroacisë.

Neni 71.d i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që anëtarët e deleguar të EPH kanë të drejtë të jenë të pranishëm kur merren masa hetimore, por Drejtuesi i Ekipit mund të vendosë ndryshe. Anëtarët e deleguar të një EPH mund të kryejnë gjithashtu disa veprime hetimore nëse autoriteti kompetent kroat i ngarkon me këtë detyrë. Anëtarët kroatë të EPH mund t'i kërkojnë autoriteteve kroate që të kryejnë veprime hetimore dhe më pas masat hetimore merren në përputhje me legjislacionin kroat.

Neni 71.e i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që anëtarët e huaj të EPH mund të marrin informacion në lidhje me hetimin e caktuar nga anëtarët kroatë të EPH.

Prokurorët kroatë mund të përdorin informacionin e marrë nga EPH për qëllimet e mëposhtme dhe sipas kushteve të rrepta:

- për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale për të cilat është krijuar EPH;
- për zbulimin, hetimin ose ndjekjen e veprave të tjera penale, me kushtin që vendi nga i cili anëtarët e EPH kanë marrë informacionin të japë pëlqimin;
- për të parandaluar keqësimin e afërt dhe të rëndë të sigurisë publike, pa cenuar dispozitën e sipër-përmendur, në rast se më pas fillon hetimi penal;
- për qëllime të tjera nëse është rënë dakord ndërmjet palëve në marrëveshjen për EPH.

Neni 71.f i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që institucionet e BE-së mund të marrin pjesë gjithashtu në një EPH dhe që të njëjtat rregulla zbatohen për këta anëtarë si për anëtarët e tjerë të EPH, nëse nuk vendoset ndryshe.

Neni 71.g i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që nëse gjatë hetimit të një EPH në territorin e Kroacisë ekziston nevoja për ndihmë juridike

ndërkombëtare nga një vend i tretë, autoriteti gjyqësor kompetent i Kroacisë e kërkon këtë ndihmë juridike ndërkombëtare.

Neni 71.h i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që provat e marra në një vend të huaj në kuadër të një EPH janë të ligjshme sipas rregullit të reciprocitetit, nëse ato nuk janë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të brendshëm.

Neni 71.i i Ligjit për Avokatinë e Shtetit parashikon që Republika e Kroacisë ka përgjegjësi civile për dëmin e shkaktuar nga anëtarët kroatë të EPH gjatë operacioneve të EPH.

Siç është paraqitur tashmë në kapitullin për Kuadrin Ligjor Ndërkombëtar në Kroaci, baza e mëposhtme ligjore ndërkombëtare për krijimin e një EPH mund të përdoret dhe ka epërsi mbi legjislacionin kombëtar për çështje që rregullon:

- neni 20 i Protokollit të dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale,  
Gjithashtu dispozitat e mëposhtme mund të përdoren si bazë ligjore ndërkombëtare:
- neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar,
- neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,
- neni 16 i Konventës për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, Konfiskimin e Produkteve të Krimit, dhe
- neni 25 i Konventës për Krimin Kibernetik.

Përsëri, duhet të kemi parasysh që të gjitha instrumentet për bashkëpunimin ndërkombëtar sipas këtyre katër konventave të fundit kufizohen në vepra penale specifike që mbulohen nga këto konventa, ndërsa përdorimi i të gjitha konventave ndërkombëtare kufizohet në bashkëpunimin me shtetet që kanë miratuar konventën përkatëse.

## **KOSOVA**

Baza ligjore e Kosovës për një EPH janë nenet 98 dhe 97 e Ligjit për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar në Çështje Penale (LILCCM) duke pasur parasysh edhe nenet 1 dhe 2 të njëjtit ligj.

Nenet 1 dhe 2 të Ligjit për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar në Çështje Penale përcaktojnë ndihmën juridike ndërkombëtare në çështje penale si çdo lloj ndihme që kërkohet nga shtetet e huaja ose nga Kosova në mbështetje të procedurave hetimore dhe gjyqësore në çështje penale. Njëkohësisht ofron bazën për ndihmën juridike ndërkombëtare në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe një shteti të huaj me anë të përdorimit të parimit të reciprocitetit.

Në harmoni me nenin 97 të LILCCM, Ekipet e Përbashkëta Hetimore duhet të jenë në përputhje me Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale të vitit 1959.

Kryeprokurori është përgjegjës për të vendosur në lidhje me kërkesat për krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor. Në përputhje me nenin 219 të Kodit të Procedurës Penale, Ministri i Drejtësisë miraton në fund të gjitha kërkesat ndërkombëtare që i bëhen qeverive të huaja.

Neni 98 i LILCCM parashikon që autoritetet kompetente të Kosovës, me marrëveshje reciproke me një ose më shumë shtete, mund të krijojnë një Ekip të Përbashkët Hetimor për një qëllim specifik (hetime të vështira dhe kërkuese që lidhen me shtete të tjera, shtete të ndryshme hetojnë çështje penale dhe rrethanat kërkojnë veprim të koordinuar dhe të bashkërenduar mes shteteve të përfshira) dhe për një periudhë të kufizuar kohore për kryerjen e hetimit penal në një ose më shumë shtete që krijojnë ekipin. Periudha mund të zgjatet me marrëveshje ndërmjet palëve.

Ekipet e Përbashkëta Hetimore mund të krijohen me kërkesë të secilit shtet të përfshirë.

Anëtarët e një Ekipi të Përbashkët Hetimor që janë deleguar në Ekip nga shtetet e tyre mund të autorizohen që të kryejnë hetime në territorin e Kosovës, nën drejtimin e anëtarit kosovar të Ekipit, në përputhje me marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe shtetit/shteteve delegates/e.

Anëtarët e një Ekipi të Përbashkët Hetimor kanë të drejtë që të marrin pjesë në masat hetimore të marra në Kosovë. Megjithatë, drejtuesi i një Ekipi, për arsye të veçanta, në përputhje me legjislacionin kombëtar, mund të vendosë ndryshe.

Anëtarët kombëtarë të një Ekipi të Përbashkët Hetimor, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe brenda kufijve të kompetencës së tyre, mund

t'i japin Ekipit informacionin e disponueshëm në Kosovë për qëllim të hetimit penal të kryer nga Ekipi.

Nëse në kuadër të hetimit nga EPH duhet të merren masa hetimore në Kosovë, anëtarët kombëtarë të EPH mund t'i kërkojnë autoritetit kompetent kombëtar ekzekutimin e këtyre masave. Në Kosovë këto masa do të konsiderohen sipas kushteve në të cilat do të zbatoheshin nëse masat do të ishin kërkuar në kuadër të hetimeve kombëtare.

Në rastin kur informacioni është siguruar në mënyrë të ligjshme nga një anëtar kombëtar i Ekipit të Përbashkët Hetimor dhe ky informacion nuk është në dispozicion të autoriteteve kombëtare, ai përsëri mund të përdoret për qëllimet e mëposhtme dhe sipas kushteve të rrepta:

- për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale për të cilat është krijuar EPH;
- për zbulimin, hetimin ose ndjekjen e veprave të tjera penale, me kushtin që vendi nga i cili anëtarët e EPH kanë marrë informacionin të japë pëlqimin;
- për të parandaluar rrezikun e afërt dhe të rëndë të sigurisë publike;
- për qëllime të tjera nëse është rënë dakord ndërmjet palëve në marrëveshjen për EPH.

Persona, të ndryshëm nga përfaqësuesit e autoriteteve kompetente të shteteve anëtare në EPH, mund të lejohen që të marrin pjesë në veprimtaritë e Ekipit. Këta pjesëmarrës në EPH nuk kanë të njëjtat të drejta si anëtarët e EPH përveçse kur është përcaktuar shprehimisht ndryshe.

Në përputhje me nenin 102 të Ligjit për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar në Çështje Penale, shpenzimet e kryera gjatë ofrimit të bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar brenda territorit të Kosovës mbulohen nga buxheti i Kosovës.

Për krijimin e një EPH me Kosovën nuk ka bazë ligjore ndërkombëtare zyrtare.

## **MALI I ZI**

Baza ligjore e Malit të Zi për një EPH është neni 42 i Ligjit për Ndhimën e Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale (LMLACM). Sipas nenit 43 të këtij

ligji, ministri përgjegjës për gjyqësorin dërgon dhe merr letër porositë me të cilat kërkohet krijimi i një EPH.

Përfundimisht, në çështje të parashikuara në një marrëveshje ndërkombëtare ose në rast reciprociteti, paragrafi 3 i nenit 4 të LMLACM lejon autoritetin gjyqësor kombëtar që të dërgojë dhe të marrë, direkt ose indirekt, letër porosi nga dhe drejtuar autoritetit kompetent gjyqësor të huaj. Në këto raste, kopja e letër porosisë duhet t'i jepet ministrit përgjegjës për gjyqësorin.

Neni 2 i LMLACM përcakton që ndihma juridike ndërkombëtare të ofrohet në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare ose në bazë të reciprocitetit.

Paragrafi 2 i nenit 43 të ligjit në fjalë përcakton që lejimi dhe mënyra e zbatimit të veprimit të kërkuar në letër porosi (që nuk e përjashton shprehimisht krijimin e një EPH) vendoset nga gjykata në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe marrëveshjen ndërkombëtare. Kjo dispozitë sugjeron që vendimi nëse dhe si duhet të krijohet një EPH në një rast konkret duhet të merret nga gjykata. Kjo procedurë është në kundërshtim me kompetencën e prokurorit për të vendosur (gjithashtu) për (modalitetin e) hetimin që do të kryejë.

Sipas shpjegimit shtesë të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Malit të Zi, që është dhënë për qëllim të këtij Manuali, në praktikë autoriteti kompetent kombëtar që autorizon ose kërkon krijimin e një EPH është prokuroria kompetente. Megjithatë, ligji lexohet si në paragrafin më sipër.

Neni 44 i LCLACM parashikon mundësinë që autoriteti gjyqësor i brendshëm të miratojë praninë e një zyrtari të huaj i cili ka interes të ligjshëm në ekzekutimin e veprimit të kërkuar. Autoriteti i huaj informohet për vendin dhe kohën e ekzekutimit të veprimit të kërkuar.

Neni 45 i LCLACM përcakton që provat e mbledhura në një shtet të huaj pranohen nga gjykatat e Malit të Zi me kusht që të mos jenë siguruar me veprime që janë në kundërshtim me sistemin gjyqësor të brendshëm (të Malit të Zi) dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare të pranuar përgjithësisht.

Neni 46 i LCLACM përjashton ndihmën e ndërsjellë juridike në çështje të veprave penale ushtarake.

Neni 47 i LMLACM jep shkaqet për refuzimin e ndihmës të ndërsjellë juridike (dhe Ekipeve të Përbashkëta Hetimore) për vepra penale politike dhe nëse ekzekutimi i letër porosive të shteteve kërkuese ka të ngjarë të cenojë pavarësinë, rendin kushtetuese, sigurinë ose interesa të tjera thelbësore të Malit të Zi.

Mbi të gjitha, baza ligjore për Ekipeve të Përbashkëta Hetimore rrjedh nga neni 9 i Kushtetutës së Malit të Zi. Ky nen përcakton që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare të pranuar përgjithësisht përbëjnë pjesë të pandarë të rendit juridik të brendshëm, kanë epërsi mbi legjislationin kombëtar dhe janë direkt të zbatueshme kur rregullojnë marrëdhënie ndryshe nga legjislationi i brendshëm. Kjo përbën bazën ligjore për përdorimin e drejtpërdrejtë të dispozitave për Ekipeve të Përbashkëta Hetimore në konventat e ratifikuara nga Republika e Malit të Zi.

Rrjedhimisht dhe siç është paraqitur tashmë në kapitullin për Kuadrin Ligjor Ndërkombëtar, baza e mëposhtme ligjore ndërkombëtare mund të përdoret në Malin e Zi për krijimin e një EPH dhe ka epërsi mbi legjislationin kombëtar për çështje që rregullon:

- neni 20 i Protokollit të dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale, dhe
- neni 27 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (KBP EIJL).

Gjithashtu, dispozitat e mëposhtme mund të përdoren si bazë ligjore ndërkombëtare:

- neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar,
- neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,
- neni 16 i Konventës për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, Konfiskimin e Produkteve të Krimit, dhe
- neni 25 i Konventës për Krimin Kibernetik.

Përsëri, duhet të kemi parasysh që të gjitha instrumentet për bashkëpunimin ndërkombëtar sipas këtyre katër konventave të fundit kufizohen në vepra penale specifike që mbulohen nga këto konventa, ndërsa përdorimi i të

gjitha konventave ndërkombëtare kufizohet në bashkëpunimin me shtetet që kanë miratuar konventën përkatëse.

Rekomandohet që Republika e Malit të Zi të rregullojë më tej përdorimin e EPH edhe në nivel kombëtar pasi ka aspekte të këtij bashkëpunimi që për momentin mbeten të paqarta, siç janë autoriteti kompetent për krijimin e një EPH, përkufizimi i veprave penale për të cilat mund të krijohet një EPH, përbërja e ekipit (anëtarët dhe drejtuesit), elementet që duhet të përfshihen në një marrëveshje për EPH, kushtet e veçanta të masave hetimore të ndërmarra në vend, rregullat e shkëmbimit të informacionit dhe provave etj. Në këtë mënyrë do të lehtësohej krijimi i një EPH me shtetet që nuk kanë miratuar ndonjë nga Konventat ndërkombëtare të përmendura më sipër.

## SERBIA

Në Serbi, në mungesë të një traktati ndërkombëtar të ratifikuar apo të rregullimit të disa çështjeve në një traktat ndërkombëtar të ratifikuar<sup>19</sup>, baza ligjore për një EPH është neni 96, i lexuar së bashku me nenin 83 të Ligjit për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështje Penale.

Për qëllim të këtij Manuali nuk na u dhanë shpjegime zyrtare, vendime ministri apo qarkore administrative në lidhje me EPH.

Ligji për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështje Penale nuk parashikon kërkesat specifike zyrtare për krijimin e një EPH, por jep një justifikim të përgjithshëm që rrjedh nga rrethanat e çështjes specifike. Nuk ka kërkesa specifike formale që i referohen marrëveshjes dhe/ose kërkesës për krijimin e një EPH. Kërkohet vetëm që autoriteti kompetent i Republikës së Serbisë, i cili është Ministri i Drejtësisë dhe Administratës Publike, të bëjë një marrëveshje me autoritetin kompetent të një shteti të huaj<sup>20</sup>.

Sipas dispozitave të nenit 16 dhe 194 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë dhe nenit 1 të Ligjit për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështje Penale, dispozitat e mëposhtme të konventave ndërkombëtare mund të përdoren si bazë ligjore për krijimin e një EPH dhe kanë epërsi mbi ligjin kombëtar për ndhmën e ndërsjellë në çështje penale për çështje që rregullon:

<sup>19</sup> Neni 1 i Ligjit për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështje Penale

<sup>20</sup> Ekiye të përbashkëta hetimore, neni 96 i Ligjit për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështje Penale



- neni 20 i Protokollit të dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështje Penale, dhe
- neni 27 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (KBP EJL).

Gjithashtu, dispozitat e mëposhtme mund të konsiderohen bazë e mundshme ligjore për krijimin e një EPH:

- neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar,
- neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,
- neni 16 i Konventës për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, Konfiskimin e Produkteve të Krimit, dhe
- neni 25 i Konventës për Krimin Kibernetik.

Përsëri, duhet të kemi parasysh që të gjitha instrumentet për bashkëpunimin ndërkombëtar sipas këtyre katër konventave të fundit kufizohen në vepra penale specifike që mbulohen nga këto konventa, ndërsa përdorimi i të gjitha konventave ndërkombëtare kufizohet në bashkëpunimin me shtetet që kanë miratuar konventën përkatëse.

Rekomandohet që Republika e Serbisë të rregullojë më tej përdorimin e EPH edhe në nivel kombëtar pasi ka aspekte të këtij bashkëpunimi që për momentin mbeten të paqarta, siç janë autoriteti kompetent për krijimin e një EPH, përkufizimi i veprave penale për të cilat mund të krijohet një EPH, përbërja e ekipit (anëtarët dhe drejtuesit), elementet që duhet të përfshihen në një marrëveshje për EPH, kushtet e veçanta të masave hetimore të ndërmarra në vend, rregullat e shkëmbimit të informacionit dhe provave etj. Në këtë mënyrë do të lehtësohej krijimi i një EPH me shtetet që nuk kanë miratuar ndonjë nga Konventat ndërkombëtare të përmendura më sipër.

## **ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË**

Baza ligjore e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për një EPH është neni 38 i lexuar së bashku me nenin 15 të Ligjit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Çështje Penale. Neni 15, paragrafi 8 i Kreut II të këtij ligji rregullon termin ndihmë juridike ndërkombëtare që, mes të tjerash, përfshin krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore. Sipas nenit 38 të ligjit në fjalë, organet kombëtare kompetente për zbulimin dhe ndjekjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar, së bashku me organet e huaja

kompetente, mund të jenë pjesë e një ekipi të përbashkët hetimor. EPH duhet të krijohet për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë të caktuar kohore; me pëlqimin e shteteve anëtare të EPH periudha kohore fillestare e një EPH mund të zgjatet.

Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë ka nxjerrë një Udhëzues për Hetimet Penale<sup>21</sup>. Ky udhëzues përmban një seksion të veçantë me titull “Hetimi i përbashkët ndërkombëtar i krimit” që pasqyron dispozitat për procedurën e këtij lloji hetimi.

Sipas nenit 39 dhe 40 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të ligjit të zbatueshëm për Prokurorinë, Prokurori<sup>22</sup> është autoriteti kompetent kombëtar që mund të autorizojë ose të kërkojë krijimin e një EPH. Neni 36 rregullon që Prokurori i Republikës së Maqedonisë në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare vendos bashkëpunim të drejtpërdrejtë me prokuroritë e shteteve të tjera sidomos për parandalimin dhe ndjekjen e krimit të organizuar dhe formave të tjera të krimit nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave, bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, trajnimit, specializimit të stafit dhe metodave të tjera të bashkëpunimit.

Përgjegjësia penale e anëtarëve të EPH të deleguar në Ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë parashikohet në nenin 39 të Ligjit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Çështje Penale dhe është njësoj si përgjegjësia penale e anëtarëve kombëtarë të një EPH për vepra penale të kryera ndaj ose prej anëtarëve.

Siç është prezantuar tashmë në kreun për Kuadrin Ligjor Ndërkombëtar, baza e mëposhtme ligjore ndërkombëtare mund të përdoret në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë për krijimin e një EPH dhe ka epërsi mbi legjislacionin kombëtar për çështjet që rregullon:

- neni 20 i Protokollit të dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështje Penale, dhe
- neni 27 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (KBP EIJL).

<sup>21</sup> Informacion i marrë nga një pyetësor për EPH në kuadër të projektit për EPH në lidhje me Trafikimin e Qenieve Njerëzore.

<sup>22</sup> Bazuar në nenin 36 të Ligjit për Prokurorinë

Gjithashtu dispozitat e mëposhtme mund të përdoren si bazë ligjore ndërkombëtare:

- neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar,
- neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,
- neni 16 i Konventës për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, Konfiskimin e Produkteve të Krimit, dhe
- neni 25 i Konventës për Krimin Kibernetik.

Zbatueshmëria e katër konventave të fundit kufizohet në vepra penale specifike që mbulohen nga këto konventa, ndërsa zbatueshmëria e të gjitha konventave ndërkombëtare kufizohet në bashkëpunimin me shtetet që kanë ratifikuar konventën përkatëse

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka përvojë me veprimtarinë e një EPH me Shtetet Anëtare të BE-së.

Rekomandohet që Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë të rregullojë më tej përdorimin e EPH edhe në nivel kombëtar pasi ka aspekte të këtij bashkëpunimi që për momentin mbeten të paqarta, siç janë përbërja e ekipit (anëtarët dhe drejtuesit), elementet që duhet të përfshihen në një marrëveshje për EPH, rregullat e shkëmbimit të informacionit dhe provave etj. Në këtë mënyrë do të lehtësohej krijimi i një EPH me shtetet që nuk kanë miratuar ndonjë nga Konventat ndërkombëtare të përmendura më sipër. Në këtë drejtim, përvoja ekzistuese me një EPH duhet të jetë një avantazh i çmuar.

## **BASHKËPUNIMI ME EUROJUST<sup>23</sup>**

Në përputhje me nenin 1(12) të Vendimit Kuadër të Bashkimit Europian për EPH, si edhe dispozitat përkatëse të Konventës së Bashkimit Europian për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike, EUROJUST dhe EUROPOL mund të marrin pjesë në EPH, veçmas ose së bashku. Më tej, neni 6 i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet EUROPOL dhe EUROJUST bën të mundur që të dyja palët së bashku, me kërkesë të një ose më shumë shteteve anëtare të BE-së, të marrin pjesë në krijimin e një EPH dhe të mbështesin autoritetet

---

<sup>23</sup> Dispozita të detajuara të kuadrit ligjor të EUROJUST gjenden në Shtojcën 1

kombëtare gjyqësore dhe policore në diskutimet paraprake në lidhje me krijimin e EPH.

Për këtë qëllim, EUROPOL mbështet diskutimet ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve të treta (jo anëtare të BE-së) duke organizuar dhe financuar, mbi bazën e një kërkesë të arsyetuar, misionin e ekspertëve në këto takime operacionale.

Sipas Vendimit të EUROJUST, anëtarët kombëtarë në EUROJUST kanë të drejtë të marrin pjesë në EPH në lidhje me shtetet e tyre. Megjithatë, një Shtet Anëtar mund t'ia nënshtrojë pjesëmarrjen e anëtarit kombëtar të tij një marrëveshjeje të autoritetit kompetent kombëtar. Anëtarët kombëtarë, zëvendësit e tyre ose asistentët e tyre ftohen që të marrin pjesë në një EPH që përfshin shtetin e tyre dhe për të cilin ofrohet financim nga Komuniteti sipas instrumenteve të zbatueshme financiare. Çdo Shtet Anëtar i BE-së përcakton nëse Anëtari Kombëtar merr pjesë në EPH si autoritet kompetent kombëtar ose në emër të EUROJUST.

EUROJUST gjithashtu ka kompetencë që t'i kërkojë autoriteteve kompetente në Shtetet Anëtare të BE-së që të krijojnë një EPH. Kjo mund të bëhet ose nëpërmjet Anëtarit Kombëtar të Shtetit Anëtar të BE-së të përfshirë sipas nenit 6 të Vendimit për EUROJUST, ose nga Kolegji i EUROJUST sipas nenit 7 të Vendimit për EUROJUST.

Në lidhje me përfshirjen e vendeve të treta, EUROJUST mund të bashkëpunojë me to dhe t'i mbështesë në bazë të marrëveshjes *ad hoc* ndërmjet EUROJUST dhe vendit të tretë të përfshirë sipas Vendimit të Këshillit për EUROJUST-in.<sup>24</sup> Sipas kësaj marrëveshjeje, EUROJUST mund të shkëmbejë të dhëna, të japë ndihmë, të dërgojë magjistratë ndërlihdës dhe të koordinojë dhe ekzekutojë kërkesa për bashkëpunim gjyqësor, që nënkupton gjithashtu krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor.

Disa nga Vendet Përfituese kanë lidhur tashmë marrëveshje me EUROJUST sipas të cilës të dyja palët angazhohen për bashkëpunim edhe më të madh për të luftuar krimin e rëndë dhe ndërkombëtar. Me këtë marrëveshje, Vendet Përfituese fitojnë njohuri, përvojë dhe mbështetje nga EUROJUST.

<sup>24</sup> Nenet 26a, 27, 27a dhe 27b e Vendimit të Këshillit për Eurojust (2009)

Deri tani një marrëveshje e tillë është lidhur me Kroacinë<sup>25</sup> dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë<sup>26</sup>.

Mbështetja e EUROPOL-it për EPH parashikohet në nenin 5 dhe 6 të Vendimit të Këshillit për EUROPOL-in. Meqë EUROPOL është organizatë e zbatimit të ligjit, natyrshëm që fokusi më i madh është në mbështetjen policore, si:

- dhënia e një panorame ndërkombëtare, që lidh çështjet dhe hetimet përkatëse,
- identifikimi i mbështetjes së duhur, qoftë kjo analitike, në terren, me ekspertizë teknike dhe shkencore, ose logjistike nëpërmjet qendrës operative për EPH,
- ndihma në shkëmbimin e informacionit nëpërmjet rrugëve të sigurta të komunikimit të krijuara me Shtetet Anëtare dhe të gjithë partnerët e bashkëpunimit operacional, dhe
- kontributi për hartimin e marrëveshjes EPH, marrëveshjeve dhe ndihma për vlerësimin dhe mësimet e nxjerra pas përfundimit të një EPH.

### **(1) Kontakti me autoritetet e huaja**

Pas përfundimit të dy hapave të parë dhe pas vendimit për të ecur përpara në procesin e krijimit të një Ekipi të Përbashkët Hetimor, është më mirë (nëse është e mundur) që të kontaktohen formalisht autoritetet e shteteve të tjera anëtare të EPH të mundshëm. Për këtë qëllim, mund të përdoren kontaktet e vendosura gjatë bashkëpunimit të mëparshëm ose në seminare të ndryshme ndërkombëtare, rajonale dhe dypalëshe ose shumëpalëshe. Kontaktet e autoriteteve përkatëse të Shteteve Anëtare të BE-së dhe disa vendeve të treta palë (jo shtete anëtare të BE-së) mund të vendosen nëpërmjet EUROJUST-it dhe EUROPOL-it. Në kontaktin e parë është e rëndësishme të shpjegohen faktet e zbuluara deri në atë moment dhe arsyet për bashkëpunimin ndërkombëtar. **Prokurorët e huaj duhet që të kenë përpara tyre një qëllim të qartë dhe pyetje të mirë-formuluara!** Arsyet tona për të kontaktuar një prokuror të huaj duhet të jenë konkrete dhe

<sup>25</sup>Tashmë Shtet Anëtar i BE-së kështu që kjo marrëveshje (Marrëveshja ndërmjet Eurojust dhe Republikës së Kroacisë (2007)) nuk ka më vlerë.

<sup>26</sup>Marrëveshja për bashkëpunimin ndërmjet Eurojust dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (2008)

praktike. Zakonisht një nga pyetjet e para për autoritetin e huaj do të ishte nëse ka filluar një hetim penal në shtetin e huaj dhe nëse po, cili është përgjegjës për atë.

Autoriteti i kontaktuar duhet të japë përgjigje me informacion dhe të shpjegojë mundësitë e një EPH në vendin e tyre.

Komunikimet që në fillim do të bëjnë të mundur që prokurorët të marrin vendim për fillimin e procesit të krijimit të një EPH dhe dërgimin e kërkesës për krijimin e një EPH.

Besimi reciprok është baza më e mirë dhe e vetme e duhur për bashkëpunimin e mirë ndërkombëtar!

## ***(2) Kërkesa për krijimin e një EPH***

Pas marrjes së konfirmimit informal që shteti tjetër është i interesuar për krijimin e një EPH, prokurori duhet t'i drejtohet autoriteteve të huaja në mënyrë më formale me kërkesë për krijimin e një EPH. Kërkesa duhet të përfshijë të gjithë informacionin e rëndësishëm që është dhënë tashmë në mënyrë informale dhe kërkesën për të filluar formalisht procesin e krijimit të EPH.

Pasi kërkesa për krijimin e EPH të merret parasysh nga të gjitha autoritetet përkatëse në të gjitha shtetet e përfshira, rekomandohet që hetuesit, prokurorët dhe/ose gjyqtarët e shteteve anëtare të EPH të mundshëm të takohen dhe të diskutojnë çështjen në rastin më të parë përpara se të hartohet një propozim dhe marrëveshje formale. Ndërsa disa vende kanë zbatuar rregulla administrative të brendshme të cilat për shembull përcaktojnë njoftimin e ministrive kompetente në fazën përgatitore, përfshirja e hershme e të gjithë personave kompetentë është me rëndësi të madhe me qëllim që të mos rrezikohet ose që të mos vonohet i gjithë procesi. Në këtë takim duhet të bihet dakord veçanërisht për elementët kryesorë si: përcaktimi i çështjes, përcaktimi i afatit kohor, metoda e bashkëpunimit, palët në EPH, financimi dhe të gjithë elementët e tjerë të përcaktuar në seksionin e marrëveshjes formale për EPH (ku për shembull, çështja e përkthimit ka treguar se është një sfidë tepër e vështirë).

Në negociimin e marrëveshjes, duhet të mbahet parasysh objektivi kryesor i EPH së bashku me dallimet në procedurat ligjore, rregullat e provave dhe autoriteti kompetent për të urdhëruar masa të caktuara shtrënguese.

### **(3) Hartimi i marrëveshjes formale<sup>27</sup>**

Në takimin e sipër-përmendur, pjesëmarrësit duhet të vendosin për autoritetin ose vendin që do të përgatisë projektin e Marrëveshjes për EPH. Projekti i marrëveshjes për EPH duhet të bazohet në informacionin e shkëmbyer dhe duhet të marrë parasysh legjislacionin kombëtar.

Marrëveshja për EPH nuk mund të ketë epërsi mbi legjislacionin dhe detyrimet e brendshme.

Projekt marrëveshja duhet të përmbajë të gjithë elementët e nevojshëm të renditur në seksionin e Marrëveshjes Formale të këtij Manuali.

Projekti më pas duhet të shpërndahet mes shteteve anëtare dhe autoriteteve të EPH të mundshëm, të cilët duhet të japin komentet dhe sugjerimet e tyre përfundimtare. Autoriteti që ka përgatitur projektin duhet të mbledhë sugjerimet dhe të ndryshojë projektin e variantit derisa të gjitha palët të bien dakord me tekstin.

Megjithatë, të gjithë ata që janë të përfshirë duhet të përpiqen që teksti i marrëveshjes të paraqesë ekuilibrin më të mirë ndërmjet saktësisë dhe efikasitetit. Diskutime të gjata për çdo detaj zor se mund të rezultojnë në një hetim të përbashkët penal të suksesshëm.

### **(4) Nënshkrimi i marrëveshjes**

Kur të gjitha palët e EPH të jenë të kënaqura me tekstin e marrëveshjes për EPH, mund të zhvillohet procedura formale e krijimit të një EPH.

Marrëveshja për EPH është një kontratë ndërkombëtare dhe duhet të konsiderohet si e tillë. Prandaj, kjo fazë duhet të ndjekë ngushtësisht rregullat

---

<sup>27</sup> Një shembull i marrëveshjes për EPH dhe një Marrëveshje Tip për EPH gjendet në Shtojcën 3

formale, sidomos rregullat për autoritetin kompetent për nënshkrimin e marrëveshjes.<sup>28</sup>

Nënshkrimi zyrtar i marrëveshjes për EPH mund të bëhet në tre mënyra të ndryshme:

- marrëveshja për EPH nënshkruhet së pari nga një shtet dhe më pas i dërgohet një shteti tjetër që do të marrë pjesë në EPH. Shteti marrës nënshkruan marrëveshjen dhe ia dërgon më pas shtetit pjesëmarrës. Ky proces vazhdon deri kur shtetet pjesëmarrëse nënshkruajnë marrëveshjen.
- Ose: përfaqësuesit e të gjitha autoriteteve kompetente nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse mblidhen në një takim formal dhe nënshkruajnë marrëveshjen në të njëjtën kohë.
- Ose: një përzierje e të dyja mënyrave të përshkruara më sipër.

Vendimi për mënyrën e nënshkrimit varet nga vullneti i shteteve pjesëmarrësve, por në çdo rast palët pjesëmarrësve duhet të sigurohen që procesi i nënshkrimit të marrëveshjes për EPH të mos zgjasë shumë.

Një tjetër shtet (shtesë) mund të bashkohet në marrëveshjen për EPH pasi EPH është krijuar tashmë. Me pëlqimin e të gjithë anëtarëve në EPH, shteti pjesëmarrës sërishmi, nënshkruan marrëveshjen për EPH ose një aneks të marrëveshjes së EPH. Procedura dhe forma vendoset nga vendet tashmë pjesëmarrëse në EPH.

### ***(5) Realizimi i marrëveshjes- Plan Veprimi Operacional***

Kur marrëveshja për EPH të nënshkruhet nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, EPH mund të fillojë punën.

Një nga përparësitë duhet të jetë takimi fillestar i të gjithë anëtarëve të EPH dhe pjesëmarrësve të tjerë. Rekomandohet që në këtë takim të miratohet një plan veprimi.

<sup>28</sup>D.m.th.: Shqipëri (Ministria e Drejtësisë), Bosnjë-Hercegovinë (prokuroria kompetente), Kroacia (prokuroria kompetente), Kosova (Ministria e Drejtësisë), Mali i Zi (prokuroria kompetente), Serbia (prokuroria kompetente), Maqedonia (prokuroria kompetente)



## **– Plan Veprimi Operacional**

Plani i Veprimit Operacional është një dokument në të cilin parashikohet si do të kryhet puna në një EPH, afati kohor për çdo veprim individual dhe anëtarët e EPH që do të kryejnë veprimin. Ekipi i Përbashkët Hetimor do të përdorë këtë Plan Operacional kështu që të gjithë anëtarët e tij do të dinë kur, ku dhe cilat masa hetimore do të merren. Prandaj, anëtarët e EPH mund të rregullojnë punën dhe planet e tyre dhe të përgatiten për veprimtarinë e ardhshme. Me planin operacional puna e EPH ndahet qartazi dhe anëtarët e EPH e dinë me saktësi se kush është përgjegjës për cilën pjesë të hetimit të përbashkët.

Procesi i hartimit të Planit Operacional ndihmon Ekipin e Përbashkët Hetimor që të planifikojë si duhet kohën që nevojitet për hetimin. Rrjedhimisht, kjo bën të mundur që Ekipi të veprojë brenda periudhës kohore të përcaktuar për hetimin dhe të kontribuojë në planifikimin kohor të veprimeve specifike dhe punën e anëtarëve të veçantë të EPH dhe Ekipit në tërësi.

Gjithashtu, duke ndjekur Planin Operacional, anëtarët e EPH do të jenë më tepër të fokusuar në qëllimin përfundimtar dhe kështu do të shmangin humbjen e kohës për çështje të rëndësisë dytësore. Plani Operacional merret me një spektër të gjerë të temave të rëndësishme operationale dhe përcakton më tej aspektet e EPH të cilat në përfundim kontribuojnë në një bashkëpunim të mirë-organizuar dhe të përcaktuar qartë ku të gjithë anëtarët e tij e dinë çfarë të presin nga njëri-tjetri.

Edhe pse një Plan Veprimi Operacional i shkruar nuk është i nevojshëm<sup>29</sup> për punën e një EPH, ai rekomandohet për arsyet e përcaktuara në tekstin më sipër. Gjithashtu, nëse të gjithë anëtarët e EPH kanë të njëjtin dokument me të njëjtin informacion, do të ketë më pak keqkuptime ose harresa të vendimeve operationale për të cilat është rënë dakord tashmë.

Mungesa e Plan Veprimit Operacional të shkruar nuk do të thotë që një EPH do të veprojë ose mund të veprojë pa një formë plani operacional: Çdo ekip, që dëshiron të kryejë punë në ekip për një rezultat të suksesshëm duhet të bjerë dakord për një lloj plani dhe një afat kohor të veprimeve specifike të cilat do të ndërmerren nga një grup në tërësi dhe/ose nga

---

<sup>29</sup> I vetmi EPH i Maqedonisë deri tani që nuk ka pasur një Plan Veprimi Operacional të shkruar.

anëtarë të caktuar. Ekipi i Përbashkët Hetimor nuk bën përjashtim. Prandaj, sugjerimet e mëposhtme mund të përdoren si kujtesë për një Plan Operacional formal ose informal të përgatitur nga Ekipet e Përbashkëta Hetimore.

Një Plan Veprimi Operacional duhet të përmbajë:

- përshkrimin e qëllimit të EPH;
- identifikimin e vendndodhjes ku mund të veprojë EPH, përshkrimin se si do të menaxhohet EPH dhe hetimin e kryer, marrjen parasysh të legjislacionit kombëtar, udhëzimeve dhe procedurës;
- përshkrimin e rolit të anëtarëve dhe/ose pjesëmarrësve të EPH duke identifikuar dhe përshkruar rolet dhe detyrat e ndryshme operacionale të çdo anëtari dhe/ose pjesëtari në EPH;
- listën e masave të veçanta ose specifike që duhet të zbatohen, duke identifikuar dhe përshkruar veprimtarinë hetimore që kërkon masa ose procedurë të veçantë psh. fëmijë të dyshuar, viktimë, mjedis pune i rrezikshëm, etj.;
- specifikimin e kompetencave hetimore dhe operacionale, duke identifikuar teknikat e veçanta hetimore/operacionet që do të përdoren gjatë hetimit pra mbikëqyrje, informatorë, agjentë të infiltruar, përgjime komunikacioni etj dhe legjislacion/procedurë në lidhje me to;
- përshkrimin e mënyrës së komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit, duke përcaktuar mënyrën e shkëmbimit të informacionit, procedurën që do të përdoret për komunikimin, gjuhën e komunikimit, mjetet për shkëmbim të sigurt informacioni dhe ruajtje të informacionit sensitiv;
- vendimin për mbledhjen e informacionit të fshehtë, vlerësimin dhe caktimin e detyrave;
- vendimin për mënyrën e kryerjes së hetimit financiar dhe nëse do të kryhet një i tillë (pas produkteve të krimit);
- specifikimin e provave të mbledhura (identifikimi i legjislacionit, udhëzimeve, procedurës etj që duhet të merret parasysh përfshirë agjencinë/individin përgjegjës, kërkesën për të përkthyer provat);
- specifikimin e asaj që është rënë dakord për ndjekjen penale (kush do të ndjekë kë, çfarë dhe kur);

- komentet për dëshminë e anëtarëve të EPH përpara gjykatave (identifikimi i mundësisë që një anëtar i EPH të thirret në gjykatë dhe procedurat kombëtare përkatëse do të zbatoheshin në këto raste);
- mënyrat dhe rrethanat e nxjerrjes së informacionit për hetimin, identifikimin e rregullave dhe procedurave për të gjitha juridiksionet ku ka mundësi që të veprojnë EPH;
- kuadrin për takime operationale dhe strategjike (duke identifikuar dhe përshkruar takimet që do të zhvillohen, shpeshinë e tyre dhe pjesëmarrësit) dhe
- dispozitat për administrimin dhe logjistikën (çështje në lidhje me administratën, përkthimin, pajisjet si akomodimi në zyrë, automjete, pajisje IT ose pajisje të tjera teknike, burime, staf, media, çështje konfidencialiteti etj).

Në bazë të këtij Plan Veprimi, puna hetimore mund të fillojë përfundimisht dhe mund të ndërmerren veprime. Drejtuesi ose drejtuesit e EPH duhet të mbikëqyrin punën dhe të sigurojnë që Plani i Veprimit dhe puna të marrë parasysh çdo ndryshim të rëndësishëm të fakteve.

Gjithashtu, drejtuesi ose drejtuesit e EPH duhet të bëjnë vlerësime të brendshme, të rregullta dhe konstante.

Veprimtaritë e EPH duhet të planifikohen dhe të ekzekutohen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në mënyrën e duhur në çdo rast konkret.

## IV. PËRFUNDIM

Ekipi i Përbashkët Hetimor është një mekanizëm i ri për bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimin e krimeve ndërkufitare. Avantazhet kryesore të hetimeve të kryera në një EPH janë:

1. drejtimi i sinkronizuar në territoret e të gjitha shteteve anëtare të EPH që rezulton në planifikimin më të mirë të kohës, mënyrës dhe radhës së veprimeve hetimore të kryera;
2. kompetenca aktuale (formale apo jo) e të gjithë anëtarëve të EPH që përfshihen direkt ose indirekt në veprimet hetimore të një shteti tjetër anëtar të EPH; kjo rezulton së pari në angazhim më të madh personal të çdo anëtari në EPH dhe rrjedhimisht në të kuptuarin prej tij/saj të përgjegjshmërisë për suksesin përfundimtar të hetimit dhe së dyti mundëson shkëmbim të shpejtë ose madje në moment të informacionit të rëndësishëm, i cili përsëri çon në sinkronizim më të mirë të veprimeve të kryera;
3. puna në ekip që nxit frymën e ekipit mes anëtarëve të EPH; i detyron që të mbështeten tek njëri-tjetri dhe prandaj që të jenë më të hapur dhe më të sinqertë në synimet e tyre; besimi reciprok më pas është pasojë e pashmangshme.

Në përfundim, të gjitha avantazhet e renditura çojnë në një rezultat optimal të hetimit penal konkret. Ky është njëkohësisht qëllimi dhe avantazhi kryesor i çdo EPH.

Lufta e suksesshme kundër krimit të organizuar ndërkufitar duhet të jetë një angazhim i përvokueshëm i çdo shteti që rregullohet nga sundimi i ligjit. Ekipet e Përbashkëta Hetimore janë një mekanizëm modern për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështje penale që në shumë raste kanë provuar se janë të efektshme. Le t'i përdorim!



# **SHTOJCA 1**

## **KUADRI LIGJOR KOMBËTAR**

### **SHQIPËRIA**

#### **Kodi i procedurës penale (Varianti i konsoliduar që nga tetori 2010)**

##### **Neni 10**

##### **Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare**

1. Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij Kodi.

#### **TITULLI X**

#### **MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA**

##### **KREU II**

##### **LETËR POROSITË NDËRKOMBËTARE**

##### **SEKSIONI I**

##### **LETËR POROSITË NGA JASHTË SHTETIT**

##### **Neni 505**

##### **Kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë**

1. Ministria e Drejtësisë vendos që t'i jepet rrugë letër porosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesat të rëndësishme të shtetit.

2. Ministria nuk i jep rrugë letër porosisë kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Ministria nuk i jep rrugë letër porosisë edhe kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndi-

kojnë negativisht në zhvillimin e procesit, si dhe kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letër porosinë.

3. Në rastet kur letër porosia ka si objekt thirrjen e një dëshmitari, të një eksperti a të një të pandehuri para autoritetit gjyqësor të huaj, Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letër porosisë kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur për paprekshmërinë e personit të thirrur

4. Ministria ka të drejtë të mos i japë rrugë letër porosisë kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur të reciprocitetit

**Ligji për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në  
Çështje Penale - neni 13  
(Fletore Zyrtare nr.181/2009)**

**LETËR POROSITË**

**Neni 13**

**Llojet e letër porosive dhe fusha e zbatimit**

1. Llojet e letër porosive janë:

a) njoftimi i aktit të thirrjes ndaj personit nën hetim, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit, të dënuarit apo palëve të tjera në procedimin penal;

b) njoftimi i urdhrave, i vendimeve të autoriteteve gjyqësore dhe i dokumenteve të tjera të nevojshme që lidhen me procedimin penal në shtetin kërkues;

c) masat e sigurimit pasuror për efekte të një procedimi penal;

ç) pyetja e personit nën hetim, të pandehurit, të dënuarit, dëshmitarit dhe ekspertit, qoftë edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me anë të lidhjeve telefonike dhe audiovizive;

d) transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar, me qëllim pyetjen e tyre;

dh) veprime të tjera hetimore, të cilat nuk janë të ndaluara nga ligji

**BOSNJË-HERCEGOVINA**

**Ligji për Ndhimën e Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale**  
**(Fletore Zyrtare nr.53/09,58/2013**  
**(Federata e Bosnjë-Hercegovinës)**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**(Fusha e veprimit)**

(1) Ligji rregullon mënyrën dhe procedurën e ndihmës së ndërsjellë juridike në çështje penale (tani e më poshtë ndihmë e ndërsjellë juridike), përveçse kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje ndërkombëtare ose nëse nuk ekziston një traktat ndërkombëtar.

(2) Ndhima e ndërsjellë juridike, për qëllim të këtij ligji, ofrohet në të gjitha procedurat në lidhje me veprat penale, ndjekja e të cilave, në kohën e kërkesës për ndihmë, përfshihet në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të Shtetit kërkuar.

(3) Ndhima e ndërsjellë juridike, në përputhje me këtë ligj, mund të jepet edhe në procese për kundërvajtje që zhvillohen përpara gjykatave ose autoriteteve administrative, në lidhje me akte që janë të dënueshme me burg ose gjobë sipas legjisllacionit të Bosnjë-Hercegovinës dhe kur në këto procese, vendimi i autoritetit administrativ mund të çojë në procese gjyqësore përpara një gjykate e cila ka kompetencë lëndore në çështje penale.

(4) Ndhima e ndërsjellë juridike jepet gjithashtu në lidhje me gjykata ndërkombëtare ose organizata të tjera ndërkombëtare, në të cilat Bosnjë-Hercegovina është anëtare, nëse kjo përcaktohet në një traktat ndërkombëtar.

**Neni 24<sup>30</sup>**  
**(Ekipet të përbashkëta hetimore)**

(1) Nëse e justifikojnë rrethanat e çështjes specifike, ekipet të përbashkëta hetimore mund të krijohen me marrëveshje ndërmjet Prokurorisë përkatëse në Bosnjë-Hercegovinë dhe autoriteteve përkatëse në një Shtet të huaj për qëllim të kryerjes së hetimit në territorin e një ose më shumë shteteve palë të cilat kanë krijuar ekipin e përbashkët për një kohë të kufizuar.

(2) Marrëveshja specifikon: përbërjen e ekipit, detyrat, autoritetet dhe periudhën për të cilën krijohet ekipi. Me miratimin e marrëveshjes nga palët nënshkruese,

<sup>30</sup> Përkthim jo zyrtar në anglisht



ekipi mund të vijojë punën edhe pas mbarimit të afatit të specifikuar në marrëveshje.

(3) Kërkesa për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor duhet të përmbajë të dhënat e përmendura në nenin 3 të këtij ligji dhe ajo mund të depozitohet nga çdo palë e interesuar. Kërkesa depozitohet pranë prokurorisë kompetente në Bosnjë-Hercegovinë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Bosnjë-Hercegovinës, përfshirë propozimin për përbërjen e ekipit. Në të njëjtën mënyrë, prokurori i prokurorisë kompetente në Bosnjë-Hercegovinë depoziton këtë kërkesë, në rast nevoje, pranë autoritetit të huaj gjyqësor kompetent.

(4) Ekipi krijohet në territorin e njëres palë nënshkruese të marrëveshjes, në territorin e të cilës pritet ekzekutimi i masës hetimore. Kërkesa përmban propozimin për përbërjen e ekipit.

(5) Ekipi i përbashkët hetimor mund të krijohet kur:

- a) hetimi i veprave penale, i kryer në një nga shtetet, kërkon hetim kompleks dhe gjithëpërfshirës, në lidhje me Shtetet e tjera;
- b) disa palë hetojnë vepra penale, natyra e të cilave kërkon veprime të koordinuara dhe të harmonizuara nga Shtetet e përfshira;
- c) veprimet hetimore duhet të kryhen në Bosnjë-Hercegovinë dhe në një shtet ose disa shtete të tjera njëkohësisht;

(6) Ekipi i përbashkët hetimor vepron në territorin e Bosnjë-Hercegovinës sipas kushteve të përgjithshme të mëposhtme:

- a) drejtuesi i ekipit është prokurori i prokurorisë kompetente në Bosnjë-Hercegovinë;
- b) ekipi kryen veprime hetimore në përputhje me legjislacionin penal në Bosnjë-Hercegovinë, ndërsa anëtarët e ekipit të përbashkët hetimor, të huaj dhe vendas, kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin e drejtuesit të ekipit;
- c) prokuroria kompetente në Bosnjë-Hercegovinë merr të gjitha masat e nevojshme organizative që kërkojnë për veprimtarinë e ekipit;

(7) Anëtarët e huaj të ekipit të përbashkët hetimor kanë të drejtë të jenë të pranishëm në kryerjen e hetimit në territorin e Bosnjë-Hercegovinës. Drejtuesi i ekipit mund të vendosë ndryshe në kushte specifike dhe në përputhje me legjislacionin në Bosnjë-Hercegovinë.

(8) Drejtuesi i ekipit mund t'i besojë anëtarëve të huaj të ekipit të përbashkët hetimor kompetenca për të marrë masa hetimore, në përputhje me legjislacionin në

Bosnjë-Hercegovinë dhe me lejen e autoriteteve kompetente të huaja gjyqësore të Shtetit që ka dërguar anëtarët e tij.

(9) Nëse ekipi i përbashkët hetimor duhet të kryejë veprime hetimore në territorin e Bosnjë-Hercegovinës, anëtarët vendas të ekipit mund t'i kërkojnë autoriteteve kompetente në Bosnjë-Hercegovinë që të marrin përsipër këto veprime. Këto veprime do të kryhen në përputhje me legjislacionin e Bosnjë-Hercegovinës.

(10) Nëse ekipi i përbashkët hetimor kërkon ndihmë juridike nga një vend i tretë gjatë hetimit të kryer në territorin e Bosnjë-Hercegovinës, autoriteti kompetent gjyqësor dërgon një letërporosi.

(11) Informacioni i marrë nga anëtarët e ekipit, vendas ose të huaj, gjatë punës në ekipin e përbashkët hetimor mund të përdoret nga autoritet kompetente të huaja gjyqësore, nëse nuk është në dispozicion të tyre me mënyra të tjera, për qëllimet e mëposhtme:

- a) për qëllimin për të cilin është krijuar ekipi;
- b) për zbulimin, hetimin ose ndjekjen e veprave të tjera penale, me miratimin e Shtetit, anëtarët e huaj të të cilit kanë akses në këtë informacion;
- c) për të parandaluar cenimin direkt ose të rëndë të sigurisë publike, dhe pa cenuar nënparagrafin b) nëse fillon hetimi penal në një kohë të mëvonshme;
- d) për qëllime të tjera nëse është rënë dakord ndërmjet palëve që kanë formuar ekipin.

## DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 93

#### (Pushimi vlefshmërisë së dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Bosnjë Hercegovinës)

(1) Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dispozitat e Kreut XXX dhe Kreut XXXI të Kodit të Procedurës Penale të Bosnjë-Hercegovinës bëhen të pavlefshme.

(2) Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Enteve dhe Distriktit Brčko të Bosnjë-Hercegovinës në lidhje me procedurën e ndihmës juridike ndërkombëtare harmonizohen me dispozitat e këtij ligji brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

### **Neni 9431**

#### **(Udhëzime të nxjerra nga Ministri i Drejtësisë i Bosnjë-Hercegovinës)**

Ministri i Drejtësisë i Bosnjë-Hercegovinës nxjerr udhëzime të cilat rregullojnë procedurat e autoriteteve kompetente të Bosnjë-Hercegovinës në kontakt me Eurojust, sa i përket nenit 3 të këtij Ligji.

Ministri i Drejtësisë i Bosnjë-Hercegovinës mund të nxjerrë në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, Udhëzime për krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore.

### **Ligji për Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës** **(Fletore Zyrtare nr.49/09, 74/09, 97/09)**

#### **Neni 7**

#### **Juridiksioni penal**

(1) Gjykata ka juridiksion mbi veprat penale të përcaktuara në Kodin Penal të Bosnjë-Hercegovinës dhe ligje të tjera të Bosnjë-Hercegovinës.

(2) Gjykata ka juridiksion mbi vepra penale të parashikuara në Ligjet e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, Republikës Srpska dhe Distriktit Brčko të Bosnjë-Hercegovinës kur këto vepra penale:

- a) rrezikojnë sovranitetin, tërësinë territoriale, pavarësinë politike, sigurinë kombëtare ose personalitetin ndërkombëtar të Bosnjë-Hercegovinës;
- b) mund të kenë pasoja të rënda ose të dëmshme për ekonominë e Bosnjë-Hercegovinës, ose mund të ketë pasoja të tjera të dëmshme për Bosnjë-Hercegovinën ose mund të shkaktojnë dëm të rëndë ekonomik ose pasoja të tjera të dëmshme përtej territorit të një Enti ose Distriktit Brčko të Bosnjë-Hercegovinës.

(3) Gjykata ka më tej juridiksion si më poshtë:

- a) për të mbajtur një qëndrim përfundimtar dhe ligjërish të detyrueshëm për zbatimin e Ligjeve të Bosnjë-Hercegovinës dhe traktateve ndërkombëtare me kërkesë të një gjykate të Enteve ose gjykatës së Distriktit Brčko të Bosnjë-Hercegovinës e cila është ngarkuar me zbatimin e Ligjit të Bosnjë-Hercegovinës;
- b) për të nxjerrë udhëzime praktike për zbatimin e të drejtës penale lëndore të Bosnjë-Hercegovinës brenda kompetencës së Gjykatës për gjenocidin,

---

<sup>31</sup> Përkthim jo zyrtar në anglisht

krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe shkeljet e ligjeve dhe praktike të luftës dhe përgjegjësisë penale individuale në lidhje me këto krime, kryesisht ose me kërkesë të një gjykate të Enteve ose të Distriktit Brčko të Bosnjë-Hercegovinës.

- c) për të vendosur në lidhje me çështje për zbatimin e së drejtës penale ndërkombëtare dhe ndërmjet enteve, përfshirë marrëdhëniet me Interpolin dhe institucione të tjera policore ndërkombëtare, si vendime për transferimin e personave të dënuar dhe për ekstradimin dhe dorëzimin e personave të kërkuar nga një autoritet në territorin e Bosnjë-Hercegovinës, nga shtetet ose gjykatat apo tribunalet ndërkombëtare;
- d) për të vendosur në lidhje me konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave të Enteve, ndërmjet gjykatave të Distriktit Brčko të Bosnjë-Hercegovinës dhe ndërmjet Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës dhe çdo gjykatë tjetër;
- e) për të vendosur për rihapjen e procesit penal për vepra penale të parashikuara në Ligjet e Bosnjë-Hercegovinës.

## **Ligji për prokurorinë e BH (Fletore Zyrtare nr.49/09, 97/09)**

### **Neni 12 Juridiksioni penal**

- 1.) Prokuroria është autoriteti kompetent për të hetuar veprat penale për të cilat është kompetente Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës dhe për të ndjekur autorët përpara Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Bosnjë-Hercegovinës dhe ligje e tjera të zbatueshme.
- 2.) Prokuroria është autoriteti kompetent për të marrë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështje penale të përcaktuara me ligj, marrëveshje dhe konventa dypalëshe dhe shumëpalëshe, përfshirë kërkesat për ekstradim ose dorëzim të personave që kërkohen nga gjykatat ose autoritetet brenda territorit të Bosnjë-Hercegovinës dhe nga shtete të tjera ose gjykata apo tribunalet ndërkombëtare. Nëse vendimi i gjykatës është i nevojshëm për të bërë një kërkesë, prokuroria është kompetente për të bërë kërkesën për këtë vendim.
- 3.) Departamentet e Veçanta mes të tjerash marrin masat e përcaktuara në ligj me qëllim hetimin dhe ndjekjen e autorëve të Krimeve të Luftës, Krimin të Organizuar, Krimin Ekonomik dhe veprave penale të korrupsionit siç parashikohet në ligj, kur në ligjet në fjalë parashikohet që këtë juridiksion e ka Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës;

## **KROACIA**

### **Kodi i procedurës penale (Fletore zyrtare nr. 152/08, 76/09, 80/11, 121/11, 91/12, 143/12, 56/13)**

#### **Neni 201**

Sipas kushteve të parashikuara në marrëveshjen ndërkombëtare dhe në një ligj të veçantë, hetimi i përbashkët mund të ndërmerret për veprat penale të parashikuara në këtë marrëveshje dhe në një ligj të veçantë.

#### **Neni 202**

(35) Hetimi i përbashkët synohet të jetë një mënyrë veprimi e policisë, prokurorisë dhe gjykatës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

### **Kushtetuta e Kroacisë (Fletore zyrtare nr. 56/90, 135/97, 8/98, 113/00, 124/00, 28/01, 41/01, 55/01, 76/10, 85/10)**

#### **Neni 134**

Marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura dhe të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën dhe të publikuara, të cilat janë në fuqi, janë pjesë e rendit juridik të brendshëm të Republikës së Kroacisë dhe qëndrojnë mbi ligjin sa i përket pasojave juridike. Dispozitat e tyre mund të ndryshohen ose të shfuqizohen vetëm sipas kushteve dhe mënyrave të specifikuara në to ose në përputhje me rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

### **Ligji për Avokatinë e Shtetit<sup>32</sup> (Fletore zyrtare nr.79/09, 153/09, 116/10, 145/10, 57/11, 130/11, 72/13) (Ligji për Avokatinë e Shtetit)**

#### **e. Hetimet e Përbashkëta**

##### **Neni 71.a**

(1) Zyra e Avokatisë së Shtetit e Republikës së Kroacisë, bazuar në një marrëveshje me autoritetet kompetente të një ose më shumë Shteteve Anëtare, mund të krijojë një ekip të përbashkët hetimor me qëllim kryerjen e hetimit të përbashkët të veprave penale të kryera në territorin e Republikës së Kroacisë dhe një ose më shumë Shte-

---

<sup>32</sup> Përkthim jo zyrtar në anglisht

teve Anëtare. Përbërja e ekipit të përbashkët hetimor përcaktohet në marrëveshje.

(2) Ekipi i përbashkët hetimor mund të krijohet:

1. për hetime serioze dhe komplekse të veprave penale të kryera në territorin e Republikës së Kroacisë, që kanë të bëjnë me autorë të cilët janë të lidhur me individë nga shtetet anëtare;

2 kur zyra kompetente e avokatisë së shtetit në Republikën e Kroacisë dhe autoritetet kompetente të një ose më shumë Shteteve Anëtare kryejnë hetimin e veprave penale rrethanat e të cilave kërkojnë angazhim të përbashkët të harmonizuar dhe të koordinuar të autoriteteve të Shteteve të përfshira.

(3) nëse plotësohen kërkesat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, që çojnë në depozitim në shtetin tjetër të kërkesës për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor, sidomos në çështje të trafikimit të lëndëve narkotike dhe njerëzve dhe akteve të terrorizimit;

#### **Neni 71.b**

Kërkesa për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor, që i jepet shtetit anëtar ose shteteve anëtare, përveç të dhënave të përmendura në nenin 8(3) të Ligjit për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështje Penale, duhet të përmbajë propozimin e përbërjes së ekipit të përbashkët hetimor.

#### **Neni 71.c**

Ekipi i përbashkët hetimor vepron në Republikën e Kroacisë, pra në territorin e Shteteve Anëtare, anëtarët e të cilave janë pjesë e atij organi hetimor, në përputhje me kërkesat e përgjithshme të mëposhtme:

1. Nëse hetimi i përbashkët kryhet në Republikën e Kroacisë, drejtuesi i Ekipit të Përbashkët Hetimor është përfaqësues i zyrës kompetente të avokatisë së rrethit ose Zyrës për shtypjen e korrupsionit dhe krimin të organizuar (tani e më poshtë Zyra),

2. Avokati i shtetit ose drejtuesi i Zyrës, apo zëvendësi i drejtuesit të Zyrës ose avokatit të distriktit, i cili është drejtues në ekipin e përbashkët hetimor, vepron në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kroacisë,

3. Anëtarët e ekipit të përbashkët hetimor kryejnë detyrat e tyre bazuar në udhëzimet e drejtuesit të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, brenda kompetencave të përcaktuara nga autoritetet e tyre në marrëveshjen e krijimit,

4. Republika e Kroacisë siguron kushtet e nevojshme për punën e ekipit të përbashkët hetimor në territorin e saj.

### Neni 71.d

(1) Anëtarët e ekipit të përbashkët hetimor nga shtetet e tjera ku kryhen hetime të përbashkëta (“anëtarët dytësorë”) kanë të drejtë të marrin pjesë në veprime individuale në kuadër të hetimit të përbashkët të kryer në Republikën e Kroacisë. Drejtuesi i Ekipit të Përbashkët Hetimor, në përputhje me legjislacionin e vlefshëm të Republikës së Kroacisë, nuk lejon pjesëmarrjen e tyre; megjithatë ai ose ajo është i detyruar t’i informojë për arsyet.

(2) Drejtuesi i ekipit, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kroacisë, i beson anëtarëve dytësorë të ekipit të përbashkët hetimor, ekzekutimin e veprimeve individuale, me miratim paraprak të autoriteteve kompetente të Republikës së Kroacisë dhe shtetit anëtar, nga i cili vjen anëtari dytësor.

(3) Nëse një ekip i përbashkët hetimor përcakton që një veprim i caktuar të kryhet në Republikën e Kroacisë, anëtarët e Republikës së Kroacisë i kërkojnë autoriteteve kompetente të ndërmarrin ato veprime. Autoriteti kompetent kryen veprimet e kërkuara në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kroacisë.

### Neni 71.e

(1) Një anëtar i ekipit të përbashkët hetimor nga Republika e Kroacisë, për nevojat e hetimit të përbashkët, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kroacisë dhe brenda kompetencave të tij, mund të vendosë në dispozicion të anëtarëve të tjerë të ekipit të përbashkët hetimor të gjitha të dhënat për të cilat ka dijeni.

(2) Një anëtar i ekipit të përbashkët hetimor mund të përdorë të dhënat, të cilat autoritetet kompetente të shtetit të tij nuk do të mund të siguronin, por që janë siguruar gjatë pjesëmarrjes në hetimin e përbashkët në territorin e shtetit tjetër, për qëllimet e mëposhtme:

1. për qëllimin për të cilin është krijuar ekipi,
2. me miratimin paraprak të një Shteti Anëtar ku janë gjetur të dhënat, mund të përdoren për të zbuluar, hetuar dhe ndjekur vepra të tjera penale. Një shtet anëtar mund të mos e japë këtë miratim vetëm në çështje ku përdorimi i të dhënave mund të rrezikojë hetimin penal në atë shtet anëtar ose nëse shteti anëtar mund të mos ofrojë ndihmën,
3. për të parandaluar kërcënimin e afërt dhe serioz ndaj sigurisë publike, rast në të cilin të dhënat e referuara mund të mos përdoren, përtej kërkesave të përmendura në paragrafin 2, për të filluar më pas hetimin penal,
4. për qëllime të tjera nëse bien dakord Shtetet Anëtare që krijojnë ekipin e përbashkët hetimor.

**Neni 71.f**

(1) Me miratimin paraprak të anëtarëve të ekipit të përbashkët hetimor nga shtetet e tjera anëtare dhe nëse e lejojnë ligjet e këtyre vendeve, të tjerë individë si oficerët e organeve të krijuara në përputhje me Traktatin për Bashkimin Europian, mund të marrin pjesë në punën e ekipit të përbashkët hetimor në territorin e Republikës së Kroacisë.

(2) Të drejtat që gëzojnë anëtarët ose anëtarët dytësore nuk zbatohen për këta individë, përveçse nëse parashikohet ndryshe me marrëveshje.

**Neni 71.g**

Nëse ekipi i përbashkët hetimor ka nevojë për ndihmë juridike nga një Shtet, i cili nuk ka marrë pjesë në krijimin e ekipit të përbashkët hetimor, autoritetet kompetente të përmendura në nenin 71.c të këtij ligji mund të kërkojnë ndihmë juridike ndërkombëtare nga autoritetet kompetente të atij shteti, në përputhje me traktatet ndërkombëtare të zbatueshme.

**Neni 71.h**

Provat e siguruara nga një autoritet gjyqësor i huaj brenda ekipit të përbashkët hetimor konsiderohen të ligjshme sipas kushteve të reciprocitetit, nëse nuk bien në kundërshtim me parimet e rendit ligjor kombëtar.

**Neni 71.i**

Republika e Kroacisë është përgjegjëse për dëmin ndaj një individi, të krijuar nga avokati i shtetit dhe zëvendës avokati i shtetit gjatë ekzekutimit të detyrave në veprimtarinë e tyre, si anëtarë të ekipit të përbashkët hetimor.

**Ligji për USKOK33**

**(Fletore zyrtare nr.76/09, 116/10, 145/10, 57/11, 136/12)  
(Ligji për Zyrën për Shtypjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar)**

**Neni 17**

(1) Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar dhe hetim të përbashkët:

1. në përputhje me traktatet ndërkombëtare, bashkëpunon me autoritetet kompetente të shteteve të tjera dhe organizatat ndërkombëtare;

<sup>33</sup> Përkthim jo zyrtar në anglisht



2. emëron anëtarët në organet e përbashkëta hetimore të krijuara, bazuar në traktate ose dispozita të zbatueshme në çështje individuale, për qëllimin e hetimit, ndjekjes penale ose përfaqësimit ligjor të akuzave përpara gjykatave penale të përmendura në nenin 21 të ligjit, në Republikën e Kroacisë ose në një apo më shumë Shtete Anëtare.

(2). Në hetimet e përbashkëta të kryera në Republikën e Kroacisë, Departamenti për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta mbikëqyr zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe respekton sovranitetin e Republikës së Kroacisë. Ai informon pa vonesë Drejtorin për të gjitha mangësitë e vërejtura ose mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen nga konsultimi me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër apo përfaqësuesit e tij, dhe kur është e nevojshme, Drejtori kërkon mendimin e ministrisë përgjegjëse për çështje të gjyqësorit dhe ministrisë përgjegjëse për marrëveshjet ndërkombëtare.

(3) Për nevojat e hetimeve të përbashkëta, Departamenti për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe hetimin e përbashkët:

1. merr kërkesa nga shtetet e tjera përpara se të marrë veprime të veçanta në lidhje me provat për veprat penale në përputhje me nenin 332 të Kodit të Procedurës Penale dhe përpara se të marrë hapa përpara gjykatave kompetente.

2. mbikëqyr, në rastin e veprimeve veçanërisht urgjente, autoritetet kompetente të shteteve të tjera, në përputhje me marrëveshjen e veçantë, të cilat janë të autorizuara që t'i ndër marrin në mënyrë të pavarur këto veprime, në territorin e Republikës së Kroacisë, ndërsa Departamenti, kujdeset që autoriteti kompetent i atij shteti të mos shkelë të drejtën për liri personale dhe dinjitet të individit. Pas marrjes së këtyre veprimeve, paraqet një raport përfundimtar pranë drejtorit, i cili mund të kërkojë që zyrtarët e autorizuar të palës së autorizuar të jenë të pranishëm kur paraqitet raporti,

3. merr kërkesa nga autoritetet kompetente të shtetit tjetër për ndihmë juridike në procedime penale të përmendura në nenin 21 të këtij ligji. Departamenti informon Zyrën e Avokatisë së Shtetit të Republikës së Kroacisë për të gjitha kërkesat e marra dhe veprimet e ndërmarra.

## **Ligji për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështje penale (Fletore Zyrtare nr.178/04)**

### **NDIHMJA JURIDIKE NDËRKOMBËTARE NË PROCESHE PENALE NË REPUBLIKËN E KROACISË OSE NË NJË SHTET TË HUAJ**

#### **Autoritetet kompetente për të ofruar ndihmë juridike ndërkombëtare dhe rrugët e komunikimit**

##### **Neni 6**

(1) Autoritetet gjyqësore vendase përcjellin tek autoritetet e huaja kompetente nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare dhe informacion, sipas nenit 18, paragrafi 1 të këtij ligji.

(2) Ministria e drejtësisë është kompetente për të marrë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare nga autoritetet e huaja kompetente, të cilat më pas ua përcjell autoriteteve gjyqësore kompetente, përveçse kur është e qartë që kërkesa duhet të refuzohet.

(3) Ministria e drejtësisë mund t'ia kthejë kërkesën autoritetit të huaj kompetent që të korrigjohet ose të plotësohet dhe cakton një afat të arsyeshëm për dorëzimin e kërkesës së korrigjuar ose të plotësuar. Pas mbarimit të afatit, kërkesa ekzekutohet sipas shtetit ku është depozituar.

(4) Në shmangie të paragrafit 1 të këtij neni, autoritetet gjyqësore vendase mund të përcjellin kërkesën për ndihmë juridike ndërkombëtare direkt tek autoriteti gjyqësor i huaj, nëse kjo parashikohet shprehimisht në këtë ligj, dhe sipas kushtit të reciprocitetit, ose nëse kjo rrugë komunikimi është e parashikuar në një traktat ndërkombëtar (komunikim i drejtpërdrejtë).

(5) Në raste të komunikimit të drejtpërdrejtë sipas paragrafit 4 dhe paragrafi 7 të këtij neni, autoriteti gjyqësor vendas dorëzon tek Ministria e Drejtësisë një kopje të kërkesës për ndihmë juridike ndërkombëtare.

(6) Në raste urgjente dhe reciprociteti, Ministria e Drejtësisë mund të dërgojë dhe të marrë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare nëpërmjet Interpolit.

(7) Në raste të komunikimit të drejtpërdrejtë sipas paragrafit 4 të këtij neni, autoritetet gjyqësore vendase mund të dërgojnë dhe të marrin kërkesa për ndihmën juridike ndërkombëtare nëpërmjet Interpolit, sipas detyrimit të paragrafit 5 të këtij neni.

(8) Ministria e drejtësisë përcjell dhe merr kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare për në dhe nga një shtet i huaj me të cilin Republika e Kroacisë nuk

ka lidhur një traktat ndërkombëtar dhe në raste kur një traktat ndërkombëtar parashikon shprehimisht rrugë diplomatike komunikimit nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

## **KOSOVA**

### **Ligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale (Fletore Zyrtare nr.33/2013)**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

1. Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.
2. Në mungesë të një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit të huaj, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar mund të ofrohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit.
3. Procedurat gjyqësore të ofrimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar rregullohen me dispozitat e procedurës penale, përveç nëse ndryshe është paraparë me këtë ligj.

##### **Neni 2 Përkufizime**

1. Shprehjet e përdorura, për qëllime të këtij ligji kanë këtë kuptim:
  - 1.1. Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale - çdo formë e ndihmës e kërkuar apo e ofruar nga një shtet tjetër, organizatë apo institucion, me qëllim të mbështetjes së procedurave penale;

#### **NËN-KREU IV FORMA TË TJERA BASHKËPUNIMI**

##### **Neni 97 Dispozita të përgjithshme**

1. Ndihmë nën këtë Kapitull ofrohet në përputhje me Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale të vitit 1959 përveç nëse rregullohet ndryshe me ligj vendor.

2. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit është kompetente për të vendosur për kërkesat nën këtë Kapitull.

### **Neni 98** **Ekipe të përbashkëta hetimore**

1. Autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës me marrëveshje të ndërsjellë me një apo më shumë shtete mund të formojnë njësi të përbashkëta të hetimit për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë kohe të kufizuar me qëllim të kryerjes së hetimeve në një apo më shumë shtete që kanë formuar njësinë. Periudha kohore mund të zgjatet me marrëveshje mes palëve.

2. Njësia e përbashkët e hetimit mund të formohet posaçërisht nëse:

2.1. hetimi në një shtet për një veprë penale përfshin hetime të vështira dhe kërkuese të cilat kanë lidhje me shtetet e tjera;

2.2. disa shtete janë duke zhvilluar hetime për vepra penale dhe rrethanat kërkojnë veprim të koordinuar dhe të bashkuar të shteteve të përfshira.

3. Njësitë e përbashkëta të hetimeve mund të formohen me kërkesë të cilido nga shtetet e përfshira.

4. Anëtarët e njësisë së përbashkët të hetimit, që janë të deleguar nga shteti i tyre mund të lejohen të kryejnë hetime në territorin e Republikës së Kosovës nën udhëheqjen e anëtarit të njësisë së Republikës së Kosovës, në përputhje me marrëveshjen mes Republikës së Kosovës dhe shtetit delegues.

5. Anëtarët e njësisë së përbashkët të hetimit duhet të lejohen të jenë prezent gjatë ndërmarrjes së çdo veprimi hetimor në Republikën e Kosovës. Megjithatë udhëheqësi i njësisë mund të vendos ndryshe për arsye të veçanta dhe në përputhje me ligjin vendor.

6. Anëtarët vendor të njësisë së përbashkët të hetimit, në përputhje me ligjin vendor dhe brenda kompetencave të tyre, mund t'i ofrojnë njësisë informatat e siguruar në Republikën e Kosovës, për qëllime të hetimeve penale që kryhen nga njësia.

7. Kur njësia e përbashkët e hetimit ka nevojë për veprime hetimore që duhet të ndërmerren në Republikën e Kosovës, anëtarët vendor të deleguar në atë njësi mund të kërkojnë nga organet gjyqësore vendore marrjen e atyre veprimeve. Ato veprime duhet të trajtohen në Republikën e Kosovës nën kushtet e njëjta që do të zbatoheshin nëse ato veprime do të kërkoreshin gjatë hetimeve vendore.

8. Informatat e siguruara ligjërisht nga anëtarët vendor të njësisë së përbashkët të hetimit, të cilat nuk do të ishin të arritshme ndryshe për autoritetet vendore, mund të përdoren për qëllimet e mëposhtme:

8.1. për qëllim për të cilin njësia është formuar;

8.2. për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale tjera, pas marrjes paraprakisht të pëlqimit nga shteti ku janë siguruar ato informata;

8.3. për parandalimin e kërcënimit serioz dhe të menjëhershëm të sigurisë publike;

8.4. për qëllime të tjera, siç mund të pajtohen shtetet që kanë formuar njësinë.

9. Persona tjerë nga përfaqësuesit e organeve kompetente të shteteve që formojnë njësinë e përbashkët të hetimit, mund të lejohen të marrin pjesë në veprimet e njësisë. Të drejtat e dhëna anëtarëve të njësisë sipas këtij Neni, nuk do të jepen këtyre personave, përveç nëse shtetet pajtohen ndryshe shprehimisht.

### **Neni 102 Shpenzime**

1. Shpenzimet lidhur me ekstradimin nga Republika e Kosovës në shtetin tjetër, të shkaktuara jashtë territorit të Republikës së Kosovës, do të barten nga shteti kërkues.

2. Shpenzimet lidhur me ekstradimin nga shtetet tjera për në Republikën e Kosovës, do të mbulohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

3. Në bazë të këtij ligji, shpenzimet tjera të kryera gjatë ofrimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, të kryera brenda territorit të Republikës së Kosovës do të barten nga buxheti i Republikës së Kosovës.

### **Kodi i procedurës penale (Fletore Zyrtare nr.37/12)**

#### **Neni 219 Kërkesat ndërkombëtare**

1. Prokurori i shtetit ose gjyqtari kompetent, sa më parë që është e mundur, fillon kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare, kërkesat për ekstradime, kërkesat për transferimin e të burgosurve ose kërkesat për ekzekutimin e aktgjytimeve.

2. Të gjitha kërkesat ndërkombëtare bëhen në pajtim me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, Ligji nr. 04/L-31 ose me ligjet pasuese.
3. Prokurori i shtetit ose gjyqtari kompetent paraqet të gjitha kërkesat ndërkombëtare në konsultim dhe pajtim me Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Ministrisë së Drejtësisë, ose organin pasues.
4. Ministri i Drejtësisë ka të drejtën e miratimit përfundimtar të të gjitha kërkesave ndërkombëtare që i paraqiten qeverive të huaja.
5. Prokurori i shtetit ose gjyqtari kompetent nuk flasin për media lidhur me kërkesat ndërkombëtare që janë në procedurë e sipër por i drejtojnë mediat te Ministria e Drejtësisë.
6. Provat e siguruara përmes rrugëve joformale nga qeveritë e huaja, organet për zbatimin e ligjit, prokuroritë apo gjykatat janë të pranueshme nëse atyre provave u bashkëngjitet deklarata nga qeveritë e huaja, organet për zbatimin e ligjit, prokuroria apo gjykatat që tregojnë se provat janë të bazuara dhe janë marrë në pajtim me ligjin e atij shtetit të huaj. Provat e tilla nuk mund të jenë bazë e vetme apo vendimtare për gjetjen e fajësisë. Të dhënat e tilla në shqyrtim gjyqësor shoqërohen me mbështetje të pohimit nga neni 263 i këtij Kodi.
7. Nëse Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar pranon apo miraton kërkesën e qeverisë së huaj për ndihmë juridike, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i dërgon kërkesën prokurorit kompetent të shtetit, i cili fillon procedurën penale me qëllimin e kufizuar në sigurimin e informacioneve të kërkuara apo kryerjen e veprimit të kërkuar. Nëse kërkesa apo veprimi i kërkuar nuk lejohet me ligj ose nuk është e mundur të sigurohet apo të kryhet, prokurori i shtetit njofton Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar dhe pushon procedurën penale.

## **MALI I ZI**

### **Kushtetuta e Malit të Zi (Fletore Zyrtare nr.1/07, 38/13)**

#### **Rendi juridik Neni 9**

Kontratat ndërkombëtare të verifikuara dhe të publikuara dhe normat e pranuar përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë përbërëse e rregullimit të brendshëm juridik, kanë përparësi mbi legjislacionin vendas dhe zbatohen drejtpërdrejt, kur raportet i rregullojnë ndryshe nga legjislacioni i brendshëm.

## **Ligji për Ndhimën e Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale (Fletore Zyrtare nr.4/08)**

### **Neni 2**

(1) Ndhimja juridike ndërkombëtare ofrohet në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare.

(2) Nëse nuk ekziston një marrëveshje ndërkombëtare, ose nëse çështje të caktuara nuk rregullohen sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ndihma juridike ndërkombëtare ofrohet në përputhje me këtë ligj, me kusht që të ketë reciprocitet ose që të pritet që shteti i huaj të ekzekutojë letër porosinë për ndihmën juridike ndërkombëtare të autoritetit gjyqësor vendas.

### **Neni 4**

(1) Autoriteti gjyqësor vendas përcjell letër porositë për ndihmë të ndërsjellë juridike tek autoritetet gjyqësore të huaja dhe merr letër porositë për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për gjyqësorin (tani e më poshtë “Ministria”).

(2) Në rast të mungesës së një marrëveshjeje ndërkombëtare ose reciprocitetit, Ministria dërgon dhe merr letër porosi për ndihmë të ndërsjellë juridike nëpërmjet rrugëve diplomatike.

(3) Në rastet kur kjo parashikohet në një marrëveshje ndërkombëtare, ose në rast reciprociteti, Ministria përcjell dhe merr letër porositë për ndihmë juridike ndërkombëtare nëpërmjet autoritetit kompetent të shtetit të huaj si një autoritet qendror për komunikimin.

(4) Në raste përjashtimore, kur parashikohet në një marrëveshje ndërkombëtare ose në rast reciprociteti, autoriteti gjyqësor kombëtar mund t'i dërgojë direkt ose indirekt autoritetit të huaj gjyqësor dhe të marrë letër porosi për ndihmën e ndërsjellë juridike nga shteti i huaj, pa detyrimin që të dorëzojë kopje të letër porosisë tek Ministria.

(5) Në raste urgjente, kur ka reciprocitet, letër porosia për ndihmë të ndërsjellë juridike mund të dërgohet dhe të merret nëpërmjet Zyrës Qendrore Kombëtare të Interpol-it.

(6) Gjykatat dhe prokuroritë janë përgjegjëse për ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike në përputhje me ligjin.

## V. FORMA TË TJERA TË NDIHMËS JURIDIKE NDËRKOMBËTARE

### Neni 42

Forma të tjera të ndihmës së ndërsjellë juridike janë: paraqitja e dokumenteve, materialeve të shkruara dhe çështje të tjera që lidhen me procedimin penal në shtetin kërkues; shkëmbimi reciprok i informacionit si edhe marrja e veprimeve procedurale individuale; dëgjimi i të akuzuarit, dëshmitarit dhe ekspertit, përfshirë dëgjimi nëpërmjet një video konference dhe telefoni, hetimi i vendit të ngjarjes, kontrolli i ambienteve dhe personave, sekuestrimi i përkohshëm i sendeve, masat e fshehta të mbikëqyrjes, ekipet e përbashkëta hetimore, paraqitja e informacionit të transaksioneve bankare, analizat e ADN-së, dorëzimi i përkohshëm i personit që i është hequr liria me qëllim dhënien e dëshmisë, dhënia e informacionit nga regjistrat penale, informacioni për gjykimet dhe veprime të tjera procedurale.

### Neni 43

(1) Ministria dërgon dhe merr letër porosi për format e ndihmës së ndërsjellë juridike të përmendura në nenin 42 të këtij ligji në përputhje me nenin 4 të këtij ligji.

(2) Lejueshmëria dhe metoda e ekzekutimit të veprimit i cili është objekt i letër porosisë të autoritetit gjyqësor të huaj vendoset nga gjykata në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe marrëveshjen ndërkombëtare.

### Neni 44

(1) Në letër kërkesën e autoritetit gjyqësor të huaj, autoriteti gjyqësor vendas mund të miratojë praninë e një zyrtari të huaj dhe të një personi që ka interes ligjor në ekzekutimin e veprimit të kërkuar nga letër porosia.

(2) Në rast se miratohet prania në letër kërkesën e përmendur në paragrafin 1 më sipër, autoriteti gjyqësor vendas i dërgon autoritetit gjyqësor të huaj njoftimin për vendin dhe kohën e ekzekutimit të veprimit të kërkuar nga letër porosia.

### Neni 45

Veprimi procedural i ndërmarrë nga autoriteti gjyqësor i huaj në përputhje me legjislacionin e tij konsiderohet i njëjtë me veprimin procedural përkatës të marrë nga një autoritet gjyqësor vendas në kuadër të procedimit penal, nëse kjo nuk është në kundërshtim me parimet e sistemit gjyqësor të brendshëm dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare të pranuarra përgjithësisht.



#### **Neni 46**

Ndihma e ndërsjellë juridike nuk ofrohet nëse letër porosia ka të bëjë me vepra penale ushtarake.

#### **Neni 47**

Ndihma e ndërsjellë juridike e përmendur në nenin 42 të këtij ligji mund të refuzohet:

- (1) nëse letër porosia e shtetit kërkues ka të bëjë me vepra penale politike;
- (2) nëse ekzekutimi i letër porosisë së shtetit kërkues ka mundësi që të prekë sovranitetin, rendin kushtetues, sigurinë ose interesa të tjera thelbësore të Malit të Zi.

### **SERBIA**

#### **Ligji për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështje Penale (Fletore Zyrtare nr.20/09)**

##### **Autoritetet kompetente**

##### **Neni 4**

Autoritetet kompetente për të ushtruar ndihmë të ndërsjellë përfshijnë gjykatat dhe prokuroritë kombëtare (tani e më poshtë: autoritetet gjyqësore) të specifikuar me ligj.

Veprime të caktuara në proceset për ndihmë të ndërsjellë kryhen nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme.

Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë që i përcillen një autoriteti i cili nuk është kompetent i përcillen pa vonesë autoritetit kompetent që të veprojë dhe për këtë njohet autoriteti që ka paraqitur kërkesën.

##### **Subjekti i formave të tjera të ndihmës së ndërsjellë**

##### **Neni 83**

Forma të tjera të ndihmës së ndërsjellë janë:

- 1) kryerja e veprimtarive procedurale si lëshimi i fletëthirrjeve dhe dorëzimi i fletëthirrjeve, marrja në pyetje e të akuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, hetimi i vendit të ngjarjes, kontrolli i ambienteve dhe personave, sekuestrimi i përkohshëm i sendeve;

2) zbatim i masave si mbikëqyrja dhe përgjimi i telefonit dhe bisedave ose komunikimeve të tjera si edhe fotografimi ose video-regjistrimi i personave, dorëzimi i kontrolluar, ofrimi i shërbimeve të simuluar, përfundimi i veprimeve ligjore të simuluar, përfshirja e agjentëve të infiltruar, përpunimi automatik i të dhënave;

3) shkëmbimi i informacionit dhe dorëzimi i fletëthirrjeve dhe çështjet në lidhje me procedime penale që janë në proces në palën kërkuese, dorëzimi i të dhënave pa letër porosi, përdorimi i thirrjeve me video dhe audio konferencë, krijimi i ekipeve të përbashkëta hetimore;

4) dorëzimi i përkohshëm i një personi në burg për qëllim të marrjes në pyetje nga organi kompetent i shtetit palë kërkues.

### **Ekipe të përbashkëta hetimore**

#### **Neni 96**

Nëse justifikohet nga rrethanat e çështjes, ekipet e përbashkëta hetimore mund të krijohen me marrëveshje ndërmjet ministrit përgjegjës për gjyqësorin dhe një shteti të huaj.

### **Kushtetuta e Republikës së Serbisë**

#### **(Fletore Zyrtare nr.98/06)**

### **Marrëdhëniet ndërkombëtare**

#### **Neni 16**

Politika e jashtme e Republikës së Serbisë bazohet në parimet dhe normat e pranuar përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare.

Normat e pranuar përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare dhe traktatet e ratifikuara ndërkombëtare janë pjesë e pandarë e sistemit juridik në Republikën e Serbisë dhe zbatohen drejtpërsëdrejti.

Traktatet e ratifikuara ndërkombëtare duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën.

## ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

### **Kodi i procedurës penale (Fletore Zyrtare nr.150/10)**

#### **PROKURORI DHE OFICERI I POLICISË GJYQËSORE**

##### **1. Prokurori**

##### **Neni 39**

##### **Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit**

(1) E drejta dhe detyrimi i përgjithshëm i prokurorit është ndjekja e autorëve të veprave penale, të cilat duhet të ndiqen kryesisht.

(2) Në çështje të krimeve që ndiqen kryesisht, prokurori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- të drejtojë veprimet e subjekteve që janë kompetente për zbulimin dhe raportimin e krimeve dhe autorëve të tyre;
- të propozojë ose nxjerrë urdhra për përdorimin e masave hetimore të veçanta, sipas kushteve dhe mënyrës të përcaktuar në këtë ligj;
- të zbatojë vendime dhe të kryejë procedurën hetimore;
- të përcaktojë vendndodhjen, të propozojë dhe të sigurojë prova, sipas kushteve dhe mënyrës të përcaktuar në këtë ligj;
- të propozojë masa të përkohshme për ruajtjen e pronës ose objekteve që janë produkte të krimit për shkak të ekzekutimit të masës së konfiskimit;
- të vendosë për shtyrjen e ndjekjes penale sipas kushteve dhe mënyrës të përcaktuar në këtë ligj;
- të propozojë ndjekjen e një urdhri penal sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj;
- të negociojë dhe të arrijë në një marrëveshje me të pandehurin për pranimin e fajit, sipas kushteve dhe mënyrës të përcaktuar në këtë ligj;
- të depozitojë dhe të përfaqësojë aktakuzën përpara gjykatës kompetente;
- të apelojë kundër vendimeve gjyqësore që nuk janë të vlefshme dhe përfundimtare dhe të zbatojë zgjidhjet ligjore të jashtëzakonshme kundër vendimeve të vlefshme dhe përfundimtare;

- të vendosë për ankimimet nga palët e dëmtuara në rrethanat e parashikuara në këtë ligj; dhe
- të ndërmarrë veprimtari të tjera të parashikuara me ligj.

(3) Prokurori fillon procedurat e veçanta dhe merr pjesë në to kur kjo përcaktohet në një ligj të veçantë.

#### **Neni 40**

#### **Kompetenca e prokurorit**

(1) Kompetenca lëndore e prokurorit përcaktohet nga dispozitat e vlefshme për juridiksionin e gjykatës për qarkun në të cilin është caktuar prokurori dhe nga ligji për prokurorinë.

(2) Kompetenca territoriale e prokurorit përcaktohet nga dispozitat e vlefshme për juridiksionin e gjykatës për qarkun në të cilin është caktuar prokurori.

(3) Çdo konflikt juridiksioni mes prokurorëve vendoset nga prokurori epror më i lartë.

(4) Në rast se ekziston rreziku për shtyrje, çdo veprim i kërkuar mund të merret nga një prokurori që nuk është autorizuar, por ai duhet të informojë prokurorin menjëherë në lidhje me këtë.

### **Ligji për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Çështje Penale (Fletore Zyrtare nr.124/10)**

#### **KREU II**

#### **NDIHMA JURIDIKE NDËRKOMBËTARE**

#### **Koncepti**

#### **Neni 15**

Ndihma juridike ndërkombëtare përfshin:

- ekzekutimin e veprimeve procedurale, si dorëzimin e dokumenteve, provat me shkrim dhe aktet që lidhen me procedimet penale në shtetin dërgues;
- dhënien e informacionit spontan;
- shkëmbimin e informacionit dhe njoftimeve të caktuara;
- transferimin e përkohshëm të personave që u është hequr liria;

- vëzhgime ndërkufitare;
- dorëzimin e kontrolluar;
- përdorimin e personave me identitet të fshehur;
- ekipet e përbashkëta hetimore;
- monitorimin e komunikimeve;
- marrjen në pyetje nëpërmjet video konferencës;
- marrjen në pyetje nëpërmjet telefonit;
- kontrollin e ambienteve dhe personave;
- sigurinë e përkohshme të sendeve, pronës ose mjeteve që lidhen me veprën penale;
- bllokimin, konfiskimin dhe përdorimin e përkohshëm të pasurive, llogarive bankare dhe transaksioneve financiare ose të ardhurave nga një veprë penale;
- konfiskimin e pasurisë dhe përfitimeve pasurore;
- heqjen e objekteve;
- mbrojtjen e të dhënave personale;
- përgjegjësinë civile dhe penale të zyrtarëve, dhe
- dorëzimin e ekstrakteve nga regjistrat penalë.

### **Ekipe të përbashkëta hetimore**

#### **Neni 38**

(1) Autoritetet vendase kompetente për zbulimin dhe ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit mund të jenë pjesë e ekipeve të përbashkëta hetimore me autoritetet e huaja kompetente, të krijuara për një qëllim të caktuar dhe me kohëzgjatje të kufizuar dhe mundësi për shtyrje nëse të dyja shtetet që kanë krijuar ekipin bien dakord për shtyrjen.

(2) Shtetet që kanë krijuar ekipin sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktojnë përbërjen e ekipit me miratim reciprok dhe ekipi krijohet në territorin e njërit prej shteteve.

(3) Ekipi i përbashkët hetimor mund të krijohet kur sipas procedurës hetimore duhet të merren masa hetimore komplekse për mobilizimin e burimeve të rën-

dësishme, si edhe kur për shkak të kompleksitetit të çështjes veprim i koordinuar i palëve të interesuara është i nevojshëm.

(4) Ekipi i përbashkët hetimor kryen operacionet e tij në përputhje me legjislacionin e shtetit në territorin e të cilit kryhen operacionet. Personi përgjegjës i ekipit është përfaqësuesi i autoritetit kompetent i cili merr pjesë në hetimin penal të shtetit në territorin e të cilit ekipi kryen operacionet e tij.

Kushtet e kërkuara organizative për zbatimin e operacioneve të ekipit sigurohen nga shteti në territorin e të cilit ekipi kryen operacionet e tij.

(5) Nëse ekipi i përbashkët hetimor ka nevojë për ndihmë nga një shtet që nuk merr pjesë në krijimin e ekipit, atij shteti mund t'i dërgohet kërkesa për ndihmë juridike.

### **Përgjegjësia penale e personave të autorizuar**

#### **Neni 39**

Gjatë zbatimit të veprimtarive të specifikuar në nenet 35, 36, 37 dhe 38 të këtij ligji, zyrtarët e autorizuar të shtetit të huaj në territorin e të cilit nuk janë ndërmarrë veprime janë njësoj si zyrtarët e autorizuar të Republikës së Maqedonisë ku veprimet janë ndërmarrë në lidhje me vepra penale në të cilat ka pasur viktime ose të cilat janë kryer prej tyre, përveçse kur Republika e Maqedonisë dhe shteti i huaj bien dakord ndryshe.

## **LIGJI PËR PROKURORINË (Fletore Zyrtare nr. 150/07)**

#### **Neni 36**

Prokuroria e Republikës së Maqedonisë, në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare, bashkëpunon direkt me prokurorinë e shteteve të tjera, sidomos në fushën e parandalimit dhe ndjekjes penale të krimit të organizuar dhe veprave penale të tjera më të rënda, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, edukimit, trajnimit të specializuar të stafit dhe formave të tjera të bashkëpunimit.

# BASHKËPUNIMI ME EUROJUST

## Vendim i Këshillit për Eurojust-in (2009)

### Neni 26a

#### Marrëdhëniet me vendet e treta dhe organizatat

1. Eurojust, aq sa kërkohet për kryerjen e detyrave të tij, mund të krijojë dhe të ruajë marrëdhënie bashkëpunimi me subjektet e mëposhtme:

(a) vende të treta;

(b) organizata si:

(i) organizata ndërkombëtare dhe organet e varësisë së tyre që rregullohen nga e drejta publike;

(ii) organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike të cilat bazohen në një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve; dhe

(iii) Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale (Interpol).

2. Eurojust mund të lidhë marrëveshje me subjektet e përmendura në paragrafin 1. Këto marrëveshje, në veçanti mund të kenë të bëjnë me shkëmbimin e informacionit, që përfshin të dhënat personale dhe delegimin e oficerëve ndërlidhës ose magistratëve ndërlidhës në Eurojust. Këto marrëveshje mund të lidhen vetëm pas konsultimit nga Eurojust me Organin e Përbashkët Mbikëqyrës në lidhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave dhe pas miratimit nga Këshilli, me shumicë të cilësuar. Eurojust informon Këshillin për çdo plan që ka për të hyrë në këto negociata dhe Këshilli mund të nxjerrë konkluzione që i konsideron të duhura.

3. Marrëveshjet e përmendura në paragrafin 2 që përmban dispozita për shkëmbimin e të dhënave personale mund të lidhen vetëm nëse subjekti i interesuar i nënshtrohet Konventës së Këshillit të Europës të 28 janarit 1981 ose pas një vlerësimi që konfirmon ekzistencën e një niveli të duhur të mbrojtjes së të dhënave të siguruara nga ai subjekt.

4. Marrëveshjet e përmendura në paragrafin 2 përmbajnë dispozita për monitorimin e zbatimit të tyre, përfshirë zbatimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

5. Përpara hyrjes në fuqi të marrëveshjeve të përmendura në paragrafin 2, Eurojust mund të marrë direkt informacion, përfshirë të dhëna personale në masën e nevojshme për kryerjen legjitime të detyrave të tij.

6. Përpara hyrjes në fuqi të marrëveshjeve të përmendura në paragrafin 2, Eurojust sipas kushteve të përcaktuara në nenin 27(1) mund të transmetojë direkt informacion, përveçse të dhëna personale, tek këto subjekte, në masën që është e nevojshme për kryerjen legjitime të detyrave të marrësit.

7. Eurojust, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 27(1) mund të transmetojë të dhëna personale tek subjektet e përmendura në paragrafin 1, kur:

(a) kjo është e nevojshme në raste individuale për qëllim të parandalimit ose luftës kundër veprave penale për të cilat është kompetent Eurojust, dhe

(b) Eurojust ka lidhur një marrëveshje të përmendur në paragrafin 2 me subjektin e përfshirë që ka hyrë në fuqi dhe që lejon transmetimin e këtyre të dhënave.

8. Çdo dështim pasues, ose mundësi për dështim nga ana e subjekteve të përmendura në paragrafin 1 për të plotësuar kushtet e përmendura në paragrafin 3 i komunikohet menjëherë Organit të Përbashkët Mbikëqyrës dhe Shtetit Anëtar të interesuar nga Eurojust. Organi i Përbashkët Mbikëqyrës mund të ndalojë shkëmbimin e mëtejshëm të të dhënave personale me subjektet përkatëse derisa të bindet që janë ofruar zgjidhjet e duhura.

9. Megjithatë, edhe nëse nuk plotësohen kushtet e përmendura në paragrafin 7, një anëtar kombëtar, në cilësinë e tij si organ kompetent kombëtar dhe në, përputhje me dispozitat e legjislacionit të tij kombëtar, me përjashtim dhe me qëllimin e vetëm që të marrë masa emergjente për të përballuar rrezikun e afërt

që kërcënon një person ose sigurinë publike, mund të realizojë shkëmbimin e informacionit që përmban të dhëna personale. Anëtari kombëtar është përgjegjës për ligjshmërinë e autorizimit të komunikimit. Anëtari kombëtar mban procesverbal të komunikimit të të dhënave dhe të shkaqeve të këtij komunikimi. Komunikimi i të dhënave autorizohet vetëm nëse marrësi merr përsipër që të dhënat do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë komunikuar.

## **Neni 27**

### **Transmetimi i të dhënave**

1. Përpara se Eurojust të shkëmbejë informacion me subjektet e përmendura në nenin 26 a, anëtari kombëtar i Shtetit Anëtar që ka paraqitur informacionin jep pëlqimin e tij për transferimin e këtij informacioni. Në raste të caktuara, anëtari kombëtar konsulton autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare.

2. Eurojust është përgjegjës për ligjshmërinë e transmetimit të të dhënave. Eurojust mban një procesverbal të gjitha rasteve të transmetimit të të dhënave sipas nenit 26 dhe 26 a dhe të arsyeve të këtij transmetimi. Të dhënat transmetohen



vetëm nëse marrësi zotohet që të dhënat do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë transmetuar.

### **Neni 27a** **Magjistratët ndërlidhës të dërguar në vende të treta**

1. Për qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit gjyqësor me vendet e treta në çështje ku Eurojust ofron ndihmë në përputhje me këtë Vendim, Kolegji mund të dërgojë gjithashtu magjistratë ndërlidhës në një vend të tretë, sipas një marrëveshjeje të përmendur në nenin 26a me atë vend të tretë. Përpara se të fillojnë negociatat me një vend të tretë, Këshilli, me shumicë të cilësuar, jep miratimin e tij. Eurojust informon Këshillin për planet që ka për fillimin e këtyre negociatave dhe Këshilli mund të nxjerrë konkluzione që i konsideron të duhura.

2. Magjistrati ndërlidhës i përmendur në paragrafin 1 kërkohet që të ketë përvojë pune me Eurojust dhe njohuri të duhura të bashkëpunimit gjyqësor dhe mënyrës sesi funksionon Eurojust. Dërgimi i një magjistrati ndërlidhës në emër të Eurojust do t'i nënshtrohet miratimit paraprak të magjistratit dhe Shtetit Anëtar të tij.

3. Nëse magjistrati ndërlidhës i dërguar nga Eurojust përzgjidhet mes anëtarëve kombëtare, zëvendësve ose asistentëve;

(i) ai do të zëvendësohet në funksionin e tij si anëtar kombëtar, zëvendës ose asistent, nga Shteti Anëtar;

(ii) ai nuk do të ketë më të drejtë të ushtrojë kompetencat që i jepen atij në përputhje me nenin 9a deri në 9e.

4. Pa cenuar nenin 110 të Rregullores së Stafit të Zyrtarëve të Komuniteteve Europiane të përcaktuar nga Rregullorja 9EEC, Euratom, ECSC) nr. 259/681, Kolegji harton rregulla për dërgimin e magjistratëve ndërlidhës dhe miraton marrëveshjet e nevojshme zbatuese në lidhje me konsultimin me Komisionin.

5. Veprimtaritë e magjistratëve ndërlidhës të dërguar nga Eurojust i nënshtrohen mbikëqyrjes nga Organi i Përbashkët Mbikëqyrës. Magjistratët ndërlidhës i raportojnë Kolegjit, i cili informon Parlamentin Europian dhe Këshillin në raportin vjetor dhe në mënyrën e duhur, në lidhje me veprimtaritë e tyre. Magjistratët ndërlidhës informojnë anëtarët kombëtarë dhe autoritetet kompetente kombëtare për të gjitha çështjet në lidhje me Shtetin Anëtar të tyre.

6. Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare dhe magjistratët ndërlidhës të përmendur në paragrafin 1 mund të kontaktojnë njëri-tjetrin në mënyrë të drejt-përdrejtë. Në këto raste, magjistrati ndërlidhës, informon anëtarin kombëtar të përfshirë në lidhje me këto kontakte.

7. Magjistratët ndërlidhës të përmendur në paragrafin 1 lidhen me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve.

### **Neni 27b**

#### **Kërkesa për bashkëpunim gjyqësor të ardhura nga dhe të dërguara për vendet e treta**

1. Eurojust, në marrëveshje me Shtetet Anëtare të përfshira, mund të koordinojë ekzekutimin e kërkesave për bashkëpunim gjyqësor që nxirren nga një vend i tretë nëse këto kërkesa janë pjesë e të njëjtit hetim dhe kërkojnë ekzekutimin të paktën në dy Shtete Anëtare. Kërkesat e përmendura në këtë paragraf mund t'i transmetohen Eurojust nga një autoritet kombëtar kompetent.
2. Në rast emergjent dhe në përputhje me nenin 5a, OCC mund të marrë dhe të shqyrtojë kërkesa të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe të lëshuara nga një vend i tretë që ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me Eurojust.
3. Pa cenuar nenin 3(2), kur bëhen kërkesat për bashkëpunim gjyqësor, që lidhen me të njëjtin hetim dhe kërkojnë ekzekutim në një vend të tretë, Eurojust, në marrëveshje me shtete anëtare të përfshira mund të lehtësojë bashkëpunimin gjyqësor me atë vend të tretë.
4. Kërkesat e përmendura në paragrafin 1, 2 dhe 3 mund të transmetohen nëpërmjet Eurojust nëse kjo është në përputhje me dokumentet e zbatueshme për marrëdhënien ndërmjet atij vendi të tretë dhe Bashkimit Europian ose Shteteve Anëtare të përfshira.

## SHTOJCA 2

### KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR

#### PROTOKOLLI I DYTË SHTESË PËR KONVENTËN EUROPIANE PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË NË ÇËSHTJE PENALE

##### Neni 20 - Skuadrat e hetimeve të përbashkëta

1) Me anë të një marrëveshjeje të përbashkët, organet kompetente të dy ose më shumë Palëve mund të ngrenë një skuadër të përbashkët investigimi për një qëllim specifik dhe për një periudhë të kufizuar, që edhe mund të zgjatet me anë të rakordimit të përbashkët, për të kryer investigime penale në një ose më shumë nga Palët që ngrenë skuadrën. Përbërja e skuadrës do të vendoset në marrëveshje.

Një investigim i përbashkët mund të ngrihet, veçanërisht, kur:

- a. investigimet e një Pale mbi krimet e rënda kërkojnë që investigimet e vështira të kenë lidhje me Palë të tjera;
- b. një numër Palësh janë duke kryer investigime mbi krimet e rënda, në të cilat rrethanat e çështjes sjellin nevojën e veprimit të koordinuar dhe të përqendruar nga Palët e përfshira.

Një kërkesë për ngritjen e një skuadre të përbashkët investigimi mund të bëhet nga çdo Palë përkatëse. Skuadra do të ngrihet në një nga Palët e parashikuara për të kryer investigim.

2) Përveç informacionit të referuar në dispozitat relevante të nenit 14<sup>34</sup> të Konventës, kërkesat për ngritjen e një skuadre të përbashkët investigimi do të përfshijnë propozime për përbërjen e skuadrës.

3) Një skuadër e përbashkët investigimi do të operojë në territorin e Palëve që formojnë skuadrën nën kushtet e përgjithshme si më poshtë:

---

<sup>34</sup> Konventa Europiane për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështje Penale (1959) - Neni 14

1. Kërkesat e ndihmës gjyqësore duhet të përmbajnë treguesit e mëposhtëm:

- a. autoritetin nga i cili ka ardhur kërkesa,
- b. objektin dhe motivin e kërkesës,
- c. për sa është e mundur, identitetin dhe kombësinë e personit në çështje dhe
- d. në qofte se është e mundur emrin dhe adresën e marrësit (destinatorit).

2. Letër porositi e parashikuara në nenet 3,4 dhe 5 do të përmendin gjithashtu, përveç akuzës edhe një paraqitje të përmbledhur të fakteve.

- a. Një udhëheqës skuadre do të jetë një përfaqësues i organit kompetent që merr pjesë në investigimet penale nga Pala në të cilën skuadra vepron. Kryetari i grupit do të veprojë brenda kufijve të kompetencës së tij ose të saj, sipas legjislationit të vendit;
  - b. Grupi duhet të ushtrojë veprimet e tij në përputhje me ligjin e Palës në të cilën vepron. Anëtarët dhe anëtarët e bashkëngjitur të grupit do të kryejnë detyrat e tyre nën udhëheqjen e personit që i referohet nënparagrafi a, duke marrë në konsideratë kushtet e vendosura nga autoritetet e tyre në marrëveshjen e krijimit të grupit;
  - c. Pala në të cilën grupi vepron do të bëjë përgatitjet e duhura organizuese për të vepruar kështu.
4. Në këtë nen, pjesëtarët e grupit të përbashkët hetues nga Pala në të cilën grupi vepron janë referuar si “anëtarë”, ndërkohë që anëtarët nga Palët ndryshe nga Pala në të cilën grupi vepron janë të referuara si “Palë të bashkëngjitura”.
5. Palët e bashkëngjitura të grupit të përbashkët hetues do të kenë të drejtën të jenë të pranishme kur të ndërmerren masa hetimore në Palën në të cilën veprohet. Megjithatë, kryetari i grupit, për raste të veçanta, në përputhje me ligjin e Palës ku grupi vepron, mund të vendosë ndryshe.
6. Anëtarëve të bashkëngjitur të grupit të përbashkët hetimor mund, në përputhje me ligjin e Palës ku grupi vepron, t’u besohet nga kryetari i grupit me detyrën e ndërmarrjes të masave të veçanta hetimore kur kjo është aprovuar nga autoritetet kompetente të Palës ku kryhen veprimet dhe të Palës së bashkëngjitur.
7. Kur grupi i përbashkët hetimor ka të domosdoshme të ndërmerren masa hetimore në një nga Palët që ka krijuar grupin, anëtarët e bashkëngjitur të grupit nga kjo Palë mund të kërkojnë që të jenë autoritetet e veta kompetente të ndërmarrin këto masa. Këto masa do të konsiderohen në atë Palë, sipas kushteve në të cilat mund të aplikohet nëse do të kërkoheshin në një hetim kombëtar.
8. Kur grupi i përbashkët hetimor ka të domosdoshme ndihmën nga një Palë ndryshe nga Palët të cilat kanë krijuar grupin ose nga një Shtet i tretë, kërkesa për ndihmë mund të bëhet nga autoritetet kompetente të shtetit ku veprohet për autoritetet kompetente të Shtetit tjetër të interesuar në përputhje me instrumentet ose përgatitjet përkatëse.
9. Një anëtar i bashkëngjitur i grupit të përbashkët hetimor mund, në përputhje me ligjin e saj ose të tij kombëtar dhe brenda kufijve të kompetencës së saj ose të tij, t’i sigurojë grupit informacion që gjendet në Palën që i bashkëngjitet atij ose, asaj me qëllim kryerjen e hetimeve kriminale nga grupi.

10. Informacioni i siguruar në rrugë ligjore nga një anëtar ose një anëtar i bashkëngjitur ndërkohë që një pjesë e grupit të përbashkët hetimor, i cili nuk është ndryshe (në të kundërt) i gatshëm për autoritetin kompetent të Palëve të interesuara mund të shfrytëzohet për qëllimet e mëposhtme:

- a) për qëllimet për të cilat grupi është krijuar;
- b) në lidhje me pëlqimin e dhënë më parë nga Pala e cila dha informacionin për kapjen, hetimin dhe ndjekjen e veprave të tjera penale; ky pëlqim mund të jepet vetëm në rastet ku përdorimi i tillë do të rriste rrezikun për hetime kriminale nga Pala e interesuar apo që lidhet me të, atëherë Pala do të refuzojë ndihmën reciproke.
- c) për të parandaluar një kërcënim të menjëhershëm dhe serioz ndaj sigurisë publike dhe pa paragjykim në paragrafin b, nëse hapet përsëri një hetim penal;
- d) për qëllime të tjera, në lidhje me atë që është rënë dakord mes Palëve, do të ngrihet një grup.

11. Ky nen do të jetë pa paragjykim për çdo dispozitë apo rregullim të ngritjes ose të veprimit të grupeve të përbashkëta të hetimeve.

12. Në lidhje me atë që shprehen ligjet e Palëve ose me dispozitat e çdo instrumenti të zbatueshëm ligjor që i lejon ata, mund të bihet dakord për rregullime për personat e ndryshëm nga ata përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve të përcaktuara në grupet e përbashkëta të hetimeve për të marrë pjesë në aktivitetet e këtij grupi. Të drejtat që gëzojnë anëtarët apo zëvendësuesit e anëtarëve të grupit, siç parashikohet në këtë, nuk do të gëzohen nga këta persona për sa kohë nuk është rënë dakord dhe deklarohet e tillë.

### **Neni 21- Përgjegjësia penale e zyrtarëve**

Gjatë veprimeve të referuara në nenet 17, 18, 19 ose 20, përveç rasteve kur vetë Palët kanë rënë dakord ndryshe, zyrtarët e Palës, të ndryshme nga Pala e veprimit, konsiderohen si zyrtarë të Palës së veprimit, në lidhje me krimet e kryera kundër tyre ose nga vetë ata.

### **Neni 22- Përgjegjësia civile e zyrtarëve**

1. Në zbatim të neneve 17, 18, 19 ose 20, kur zyrtarët e një Pale veprojnë pranë Palës tjetër, Pala e parë është përgjegjëse për çdo dëm që mund të shkaktohet gjatë veprimeve, në përputhje me ligjin e Palës, në territorin e së cilës veprojnë.

2. Pala, në territorin e së cilës shkaktohet dëmi i referuar në paragrafin 1, zbaton ndaj tij të njëjtat dispozita të zbatueshme për dëmin e shkaktuar nga zyrtarët e tij.
3. Pala, zyrtarët e së cilës kanë shkaktuar dëm ndaj personit në territorin e Palës tjetër, rimbursojnë çdo shumë që është paguar për viktimat ose personat që kanë vepruar në emër të tyre.
4. Pa paragjykim në ushtrimin e të drejtave të tyre ndaj Palëve të treta dhe me përjashtim të paragrafit 3, secila Palë, në rastin e parashikuar në paragrafin 1, heq dorë nga kërkimi i rimbursimit të dëmit të pretenduar nga Pala tjetër.
5. Dispozitat e këtij neni janë subjekt i stimulimeve nëse Palët nuk bien dakord ndryshe.

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi	Hyrja në fuqi
Shqipëria	13/11/2001	20/6/2002	1/2/2004
Bosnjë-Hercegovina	17/5/2006	7/11/2007	1/3/2008
Kroacia	9/6/2004	28/3/2007	1/7/2007
Mali i Zi	7/4/2005	20/10/2008	1/2/2009
Serbia	7/4/2005	26/4/2007	1/8/2007
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	8/11/2001	16/12/2008	1/4/2009

<http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=182&CM=7&DF=&CL=-ENG>

## KONVENTA E BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EUROPËN JUGLINDORE

### Neni 27

#### Ekipet e Përbashkëta Hetimore

(1) Me anë të marrëveshjes bilaterale, autoritetet e zbatimit të ligjit të dy ose më shumë Palëve Kontraktuese mund të ngrënë një skuadër të përbashkët të hetimit për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë kohe të caktuar, që mund të zgjatet nëpërmjet miratimit të të dyja palëve, për të zhvilluar hetime në territorin e një ose më shumë Palëve Kontraktuese ku është ngritur skuadra. Përbërja e skuadrës duhet të përcaktohet në marrëveshjen për ngritjen e skuadrës.

(2) Një investigim i përbashkët mund të ngrihet, veçanërisht, kur:

- a) veprimet hetimore që kanë filluar nga një Palë Kontraktuese për vepra penale kërkojnë zhvillimin e hetimeve të vështira dhe komplekse që kanë lidhje me Palë të tjera Kontraktuese
  - b) një numër Palësh Kontraktuese po zhvillojnë hetime për vepra penale në të cilat rrethanat e çështjes kërkojnë veprime të koordinuara dhe të bashkërenduara nga Palët Kontraktuese që janë përfshirë
- (3) Një kërkesë për ngritjen e një skuadre të përbashkët të hetimit mund të drejtohet nga secila Palë Kontraktuese e interesuar. Ekipi krijohet në një nga vendet ku pritjet që të kryhet hetimi.
- (4) Kërkesat për ngritjen e një skuadre të përbashkët të hetimit duhet të përfshijnë autoritetin që drejton kërkesën, qëllimin e skuadrës së përbashkët të hetimit, Palët Kontraktuese në territorin e të cilave skuadra e përbashkët e hetimit do të operojë dhe propozimet për përbërjen e skuadrës së përbashkët të hetimit
- (5) Një skuadër e përbashkët e hetimit do të operojë në territorin e Palëve Kontraktuese që kanë ngritur skuadrën sipas kushteve të përgjithshme të mëposhtme:
- a) drejtuesi i skuadrës që merr pjesë në hetimet penale duhet të jetë një përfaqësues i autoriteteve të zbatimit të ligjit nga Pala Kontraktuese në territorin e së cilës operon skuadra. Drejtuesi i skuadrës duhet të veprojë brenda kufijve të kompetencave të tij/të saj në përputhje me ligjin kombëtar;
  - b) skuadra duhet t'i kryejë operacionet në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ajo operon. Pjesëtarët e skuadrës duhet t'i kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin e personit të referuar në nënparagrafin (a) duke marrë parasysh kushtet e përcaktuara nga autoritetet e tyre në marrëveshjen për ngritjen e skuadrës
- (6) Në këtë nen, anëtarë të skuadrës së përbashkët të hetimit nga Palët Kontraktuese të ndryshme nga Pala Kontraktuese në territorin e së cilës operon skuadra, referohen si “të komanduar” në skuadër.
- (7) Anëtarët e komanduar të skuadrës së përbashkët të hetimit duhet të jenë autorizuar që të jenë të pranishëm kur merren masat hetimore në territorin e Palës Kontraktuese ku zhvillohet operacioni. Sidoqoftë, drejtuesi i skuadrës, për arsye të veçanta, në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese ku operon skuadra, mund të vendosë për të kundërtën.
- (8) Në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese ku operon skuadra, anëtarët e komanduar të skuadrës së përbashkët të hetimit mund të ngarkohen nga drejtuesi i skuadrës me detyra për të ndërmarrë masa të caktuara hetimore në ato raste kur këto masa janë aprovuar nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Palës Kontraktuese

ku zhvillohet operacioni dhe të Palës Kontraktuese që ka dërguar punonjësit e policisë të komanduar.

(9) Në ato raste kur skuadra e përbashkët e hetimit ka nevojë për marrjen e masave hetimore nga ana e njëres prej Palëve Kontraktuese që ka ngritur skuadrën, anëtarët e komanduar të skuadrës nga ajo Palë Kontraktuese mund t'i kërkojnë autoriteteve të tyre të zbatimit të ligjit që të marrin këto masa. Këto masa duhet të konsiderohen nga Pala Kontraktuese si të ngjashme me masat që merren gjatë një hetimi të zakonshëm që kryhet brenda territorit të saj.

(10) Në ato raste kur skuadra e përbashkët e hetimit ka nevojë për asistencë nga një Palë Kontraktuese e ndryshme nga ato që kanë ngritur skuadrën, ose nga një shtet i tretë, kërkesa për asistencë mund të drejtohet nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Palës Kontraktuese ku zhvillohet operacioni për autoritetet e zbatimit të ligjit të Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me instrumentet ose marrëveshjet përkatëse.

(11) Një anëtar i skuadrës së përbashkët të hetimit, në përputhje me ligjin e tij/të saj kombëtar dhe brenda kufijve të kompetencave të tij/të saj, mund t'i japë skuadrës informacion që disponohet nga Pala Kontraktuese që e ka komanduar atë me qëllim që të ndihmojë hetimet penale që zhvillohen nga skuadra.

(12) Informacioni i siguruar në mënyrë të ligjshme nga një anëtar ose anëtar i komanduar ndërkohë që është pjesë e një skuadre të përbashkët të hetimit, që nuk disponohet në kushte të tjera nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese të interesuara, mund të përdoret për qëllimet e mëposhtme:

- a) për qëllimet për të cilat është ngritur skuadra;
- b) për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të tjera penale në varësi të miratimit paraprak nga ana e Palës Kontraktuese ku është siguruar informacioni. Një miratim i tillë mund të refuzohet vetëm në rastet kur një përdorim i tillë mund të rrezikonte hetimet penale të Palës Kontraktuese të interesuar ose kur ajo Palë Kontraktuese mund të refuzonte asistencën bilaterale në lidhje me të;
- c) për të parandaluar një kërcënim serioz dhe imediat për sigurinë publike dhe pa paragjykim për nënparagrafin (b) nëse si rrjedhim i informacionit ka filluar një hetim penal;
- d) për qëllime të tjera deri në atë shkallë që bihet dakord ndërmjet Palëve Kontraktuese që kanë ngritur skuadrën.



(13) Ky nen duhet të konsiderohet pa paragjykime për çdo dispozitë ose marrëveshje tjetër ekzistuese mbi ngritjen ose funksionimin e skuadrave të përbashkëta të hetimit.

(14) Deri në atë shkallë që lejohet nga ligjet e Palëve Kontraktuese të interesuara ose dispozitat e çdo instrumenti ligjor të aplikueshëm ndërmjet tyre, mund të arrihen marrëveshje për persona të tjerë të ndryshëm nga përfaqësuesit e autoriteteve të zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese që kanë ngritur skuadrën e përbashkët të hetimit, për të marrë pjesë në aktivitetet e skuadrës. Persona të tillë mund të përfshijnë për shembull, zyrtarë nga organizatat ndërkombëtare të njohura nga Palët Kontraktuese. Të drejtat që kanë anëtarët ose anëtarët e komanduar të skuadrës në bazë të këtij neni nuk duhet t'i gëzojnë këta persona, në qoftë se në marrëveshje është deklaruar në mënyrë specifike për të kundërtën.

Shteti	Data e ratifikimit	Data e depozitimit të ratifikimit (e pritshme)	Hyrja në fuqi e Konventës (e pritshme)
Shqipëria	11/9/2006	31/5/2007	10/10/2007
Bosnjë-Hercegovina	11/4/2007	17/7/2007	15/10/2007
Mali i Zi	26/12/2007	28/1/2008	1/5/2008
Serbia	23/7/2007	10/9/2007	11/12/2007
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	1/6/2007	12/7/2007	10/10/2007

<http://www.pccseesecretariat.si/index.php?page=documentspcc&item=35>

**Baza ligjore ndërkombëtare shtesë që mund të përdoret gjithashtu me një interpretim më të gjerë juridik (ndihmë e ndërsjellë në masën më të madhe të mundshme):**

**KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR**

**Neni 19 Hetimet e përbashkëta**

Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë nënshkrimin e marrëveshjeve, dypalëshe ose shumëpalëshe,

lidhur me çështjet që përbëjnë subjekt hetimesh, ndjekjesh penale ose procedurash gjyqësore në një ose më shumë shtete, sipas të cilave autoritetet përkatëse të interesuara mund të krijojnë organe hetimore të përbashkëta. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla, mund të ndërmerren hetime të përbashkëta

me marrëveshje, rast pas rasti. Shtetet Palë të interesuara duhet të sigurojnë respektimin e sovranitetit të Shtetit Palë, në territorin e të cilit do të zhvillohet një hetim i tillë.

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikim, Pranim (A), Miratim (AA), Aderim (a), Trashëgim (d)
Shqipëria	12/12/2000	21/8/2002
Bosnjë-Hercegovina	12/12/2000	24/4/2002
Kroacia	12/12/2000	24/1/2003
Mali i Zi		23/10/2006 d
Serbia	12/12/2000	6/9/2001
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	12/12/2000	12/1/2005

[http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg\\_no=XVIII-12&chapter=18&lang=en](http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12&chapter=18&lang=en)

Konventa zbatohet për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e:

- pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal
- pastrimit të produkteve të krimit,
- korrupsionit,
- pengimit të drejtësisë,
- krimit të rëndë - që do të thotë një vepër penale e dënueshme me të paktën katër muaj heqje të lirisë ose një masë ndëshkimore më të rëndë

kur vepra penale ka natyrë ndërkombëtare dhe përfshin një grup të organizuar kriminal.

## **KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KORRUPSIONIT**

### **Neni 49 Hetimet e përbashkëta**

Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë nënshkrimin e marrëveshjeve, dypalëshe ose shumëpalëshe,

lidhur me çështjet që përbejnë subjekt hetimesh, ndjekjesh penale ose procedurash gjyqësore në një ose me shumë shtete, sipas të cilave autoritetet përkatëse të interesuara mund të krijojnë organe hetimore të përbashkëta. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla ose rregullimeve, investigime të përbashkëta mund të ndërmerren me anë të marrëveshjeve në bazë çështje të veçantë. Shtetet palë të përfshira do të sigurojnë që sovraniteti i shtetit palë në territorin e të cilit një investigim i tillë të ndodhë është i respektuar plotësisht.

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi, Pranimi (A), Miratimi (AA), Aderim (a), Trashëgim (d)
Shqipëria	18/12/2003	25/5/2006
Bosnjë-Hercegovina	16/9/2005	26/10/2006
Kroacia	10/12/ 2003	24/4/2005
Mali i Zi		23/10/2006 d
Serbia	11/12/2003	201/2/2005
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	18/8/2005	13/4/2007

<http://www.unodc.org/unodc/en/treaties/CAC/signatories.html>

## **KONVENTA PËR PASTRIMIN, KËRKIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT**

### **Seksioni 2- Asistenca në hetim**

#### **Neni 16- Detyrimi për të asistuar**

Sipas kërkesës, Palët do t'i japin njëra-tjetrës në shkallën më të lartë të mundshme, asistencë për identifikimin dhe ndjekjen e mjeteve, produkteve dhe pasurive të tjera që i nënshtrohen konfiskimit. Kjo asistencë do të përfshijë çdo masë që jep dhe garanton prova në lidhje me ekzistencën, vendndodhjen ose lëvizjen, natyrën, statusin ligjor apo vlerën e pasurisë së sipërpërmendur.

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi	Hyrja në fuqi
Shqipëria	22/12/2005	6/2/2007	1/5/2008
Bosnjë-Hercegovina	19/1/2006	11/1/2008	1/5/2005
Kroacia	29/4/2008	10/10/2008	1/2/2009
Mali i Zi	16/5/2005	20/10/2008	1/2/2009
Serbia	16/5/2005	14/4/2009	1/8/2009
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	17/11/2005	27/5/2009	1/9/2009

<http://conventions.coe.int/treaty/Commun/QueVoulezVous.asp?NT=198&CM=0&CL=ENG>

## KONVENTA PËR KRIMIN KIBERNETIK

### Titulli 3- PARIME TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME NDIHMËN E NDËRSJELLË

#### Neni 25- Parime të përgjithshme në lidhje me ndihmën e ndërsjellë

1. Palët i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë deri në masën më të gjerë të mundur për qëllimet e hetimeve ose gjykimeve të veprave penale që kanë të bëjnë me sistemet dhe të dhënat kompjuterike ose për mbledhjen e provave në formë elektronike për një vepër penale.
2. Secila Palë merr masa legislative ose të tjera të tilla, që mund të jenë të nevojshme, për të përmbushur detyrimet e parashikuara në nenet 27-35.
3. Secila Palë, në kushte urgjente, mund të bëjë kërkesë për ndihmë të ndërsjellë ose korrespondencën e duhur për këtë, duke përdorur mjetet e shpejta të komunikimit, duke përfshirë faksin ose e-mailin, deri në atë masë që këto mjete të ofrojnë nivelet e duhura të sigurisë dhe autenticitetit (duke përfshirë përdorimin e kodimit, kur është e nevojshme), me një konfirmim pasues kur kërkohet nga Pala pritëse. Pala pritëse pranon dhe i përgjigjet kërkesës me njërën nga këto mjete të shpejta të komunikimit.
4. Përveç kur është parashikuar shprehimisht në nenet e këtij kapitulli, ndihma e ndërsjellë u nënshtrohet kushteve të parashikuara nga ligji i Palës pritëse ose nga marrëveshjet e zbatueshme për ndihmën e ndërsjellë, duke përfshirë edhe arsyet për të cilat Pala mund të refuzojë bashkëpunimin. Pala pritëse nuk e ushtron të drejtën për të refuzuar ndihmën e ndërsjellë në lidhje me veprat penale të përmendura në nenet 2 deri në 11, kryesisht për arsyen se kërkesa ka të bëjë me një vepër të cilën ai e konsideron si vepër penale fiskale.

5. Në përputhje me dispozitat e këtij kapitulli, kur Palës pritëse i lejohet ta kushtëzojë dhënien e ndihmës së ndërsjellë me ekzistencën e kriminalitetit të dyfishtë, ky kusht konsiderohet si i përmbushur nëse sjellja që është në themel të veprës penale për të cilën kërkohet edhe ndihma e ndërsjellë është një vepër penale për të cilën kërkohet edhe ndihma e ndërsjellë është një vepër penale sipas ligjeve të kësaj Pale, pavarësisht nëse ligjet e saj e fusin veprën penale në të njëjtën kategori të veprave penale ose e emërtojnë këtë vepër penale me të njëjtën terminologji si edhe Pala kërkuese.

Shtetet	Nënshkrimi	Ratifikimi	Hyrja në fuqi
Shqipëria	23/11/2001	20/6/2002	1/7/2004
Bosnjë-Hercegovina	9/2/2005	19/5/2006	1/9/2006
Kroacia	23/11/2001	17/10/2002	1/7/2004
Mali i Zi	7/4/2005	3/3/2010	1/7/2010
Serbia	7/4/2005	14/4/2009	1/8/2009
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	23/11/2001	15/9/2004	1/1/2005

<http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=185&CM=&DF=&CL=&ENG>

## SHTOJCA 3

### HYRJE

Në lidhje me problemet dhe ankthin e mundshëm që mund të krijohet gjatë përballjes me faktin që një marrëveshje ndërkombëtare formale do të duhet të përgatitet, të miratohet dhe të nënshkruhet, për qëllim të këtij Manuali, është dhënë mbështetje praktike në dy nivele.

Niveli i parë synon të jetë sa më shumë praktik dhe konkret, në përpjeke për të dhënë një pamje të qartë me një shembull të sajuar të një marrëveshjeje për krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor i cili është përgatitur për të paraqitur një situatë reale me një qasje minimaliste për krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor në hetimin penal ndërkufitar.

Niveli i dytë trajton marrëveshjen formale nga një këndvështrim teorik, pa të dhëna për rastin. Marrëveshja tip për krijimin e një Ekipi të Përbashkët Hetimor është një propozim për mënyrën se si duhet të jetë një marrëveshje dhe për cilat raste kërkohet që palët të bien dakord. Meqë i takon palëve kontraktuese të vendosin se çfarë do të përmbajë marrëveshja, modeli duhet të përdoret si bazë për diskutim dhe negociata ose si një kujtesë për atë që mund të përfshihet në marrëveshje. Marrëveshja tip gjithashtu përmban disa mundësi dhe sugjerime që mund të jenë në marrëveshje, sipas diskrecionit të palëve kontraktuese.

Marrëveshja për EPH duhet të përgatitet gjithmonë në lidhje me shpjegimet e dhëna në pjesën thelbësore të këtij Manuali.

## **SHEMBULLI I NJË MARRËVESHJEJE PËR KRIJIMIN E NJË EKIPI TË PËRBASHKËT HETIMOR**

### **Në përputhje me:**

Nenin 20 të Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës Europiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështje Penale, nenin 27 të Konventës së Bashkëpunimit Policor në Europën Juglindore (KBP EJL) dhe nenin 19 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar,

dhe

për Bosnjë Hercegovinën, në përputhje me nenin 24 të Ligjit për Ndhimën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale të Bosnjë Hercegovinës,

për Malin e Zi, në përputhje me nenin 42 të Ligjit për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështje penale të Republikës së Malit të Zi dhe

për Serbinë, në përputhje me nenin 96 në lidhje me nenin 83 të Ligjit për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështje Penale të Republikës së Serbisë.

### **1. Palët në Marrëveshje:**

Palët e mëposhtme kanë lidhur marrëveshje për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor, (tani e më tutje të njohur si EPH):

1) Tužilaštvo Bosne i Hercegovine (Prokuroria e BH), Kraljice Jelene 88, Sarajevë, Bosnjë Hercegovina,

dhe

2) Vrhovno Državno Tužilaštvo Crne Gore (Prokuroria e Malit të Zi), Ul.Slobode br.20, Podgorica, Mal i Zi

dhe

3) Okružno javno tužilaštvo Beograd (Prokuroria e Rrethit e Beogradit), Savska 17/A, Beograd Serbi

Palët në këtë marrëveshje mund të vendosin me marrëveshje të përbashkët që të ftojnë vende të tjera, agjenci dhe administrata që të bëhen palë të kësaj marrëveshjeje.

## 2. Qëllimi, fusha e veprimit dhe misionet e Ekipit të Përbashkët Hetimor:

Marrëveshja trajton krijimin e një EPH për qëllimet e mëposhtme:

Për hetimin e veprimtarisë penale ndërkufitare të një grupi kriminal të drejtuar nga A.B., një shtetas serb, që së bashku me C.D. dhe E.F., shtetas të Malit të Zi dhe G.H., I.J., K.L., O.P. dhe R.S., shtetas të Bosnjë-Hercegovinës,

Veprat penale filluan në maj 2013 dhe janë akoma në proces.

Grupi kriminal ka një hierarki të qartë ku A.B. merr të gjitha vendimet kyçe dhe drejton gjithë operacionin nga Beogradi (Serbia), G.H. dhe I.J. janë përgjegjës për prodhimin e lëndëve narkotike afër Sarajevës (Bosnjë Hercegovina), K.L., M.N., O.P., dhe R.S janë përgjegjës për transportimin e lëndëve narkotike nga Bosnjë Hercegovina në Serbi dhe Mal të Zi, C.D. dhe E.F., janë përgjegjës për shpërndarjen e lëndëve narkotike nga Podgorica (Mali i Zi) dhe për transportimin e lëndëve narkotike me anije për në vendet e Bashkimit Europian.

Ka akoma një numër të madh anëtarësh të grupit kriminal dhe bashkëpunëtorët e tyre që nuk njihen në moment, por luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike.

Veprimtaria kriminale e përshkruar është një vepër penale e rëndë në të gjitha vendet pjesëmarrëse. Masa ndëshkimore e parashikuar në të gjitha shtetet pjesëmarrëse është më shumë sesa pesë vjet burg.

Ekipi i përbashkët hetimor do të hetojë bashkërisht veprat penale të grupit kriminal ku:

Në Serbi, Prokuroria e Rrethit të Beogradit, Prokuroria për Krimin e Organizuar, drejton hetimin sipas nr.123/2013. Deri tani autoritetet serbe kanë mundur të identifikojnë drejtuesin e grupit kriminal, vendndodhjen e tij dhe numrin e telefonit që përdor ai. Anëtarët serb të EPH:

- mbledhin informacion të mëtejshëm për veprimtarinë kriminale të drejtuesit të grupit kriminal,
- sigurojnë një urdhër gjykate për përgjimin e drejtuesit të grupit kriminal,
- ndajnë informacionin e siguar në kohë reale me anëtarët e tjerë të EPH,
- kryejnë hetim të mëtejshëm të personave të panjohur nga Serbia, të cilët marrin pjesë ose mbështesin grupin kriminal,
- sekuestrojnë lëndët narkotike të paligjshme dhe konfiskojnë pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, dhe
- marrin të gjitha masat e nevojshme hetimore të pranuar në EPH.



Në Bosnjë Hercegovinë, prokuroria e BH drejton hetimin sipas nr. K-557/2013. Deri tani autoritetet e BE kanë mundur që të identifikojnë disa nga anëtarët e grupit kriminal (G.H dhe I.J.) përgjegjës për prodhimin e lëndëve narkotike dhe tre vendndodhje të mundshme ku prodhohen lëndët narkotike. Informacioni për vendndodhjen nuk është konfirmuar akoma. Autoritetet e BH:

- mbledhin informacion për veprimtarinë kriminale të anëtarëve të grupit kriminal nga vendi i tyre,
- mbledhin informacion për vendndodhjen e prodhimit të lëndëve narkotike,
- sigurojnë një urdhër gjykate për kontroll banese dhe të ambienteve ku prodhohet lënda narkotike,
- identifikojnë rrugët e transportimit të lëndëve narkotike të paligjshme,
- ndajnë informacionin e siguruar në kohë reale me anëtarët e tjerë të EPH,
- kryejnë hetim të mëtejshëm të personave të panjohur nga BH, të cilët marrin pjesë ose mbështesin grupin kriminal,
- sekuestrojnë lëndët narkotike të paligjshme dhe konfiskojnë pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, dhe
- marrin të gjitha masat e nevojshme hetimore të pranuar në EPH.

Në Malin e Zi, Prokuroria e Malit të Zi, Posebni odjel za organizirani kriminal, drejton hetimin sipas nr. Kt-63/2013. Deri tani autoritetet malazeze kanë zbuluar disa ngarkesa me heroinë nga kantieri detar në Bar, Mal i Zi. Informacioni i mbledhur ka treguar që lëndët e paligjshme narkotike janë ruajtur afër Podgoricës dhe kanë ardhur nga Bosnja-Hercegovina. Autoritetet malazeze identifikuan C.D. dhe E.F. si personat përgjegjës për të transportuar lëndët e paligjshme narkotike me anije për në Bashkimin Europian. Autoritetet gjithashtu identifikuan K.L., M.N., O.P. dhe R.S. si persona përgjegjës për transportin e lëndëve narkotike të paligjshme për të Podgoricë. Deri tani hetimet tregojnë që të paktën dhjetë anëtarë të tjerë janë të përfshirë në grupin kriminal.

Autoritetet e Malit të Zi:

- mbledhin informacion për veprimtarinë kriminale të anëtarëve të grupit kriminal nga vendi i tyre,
- konfirmojnë informacion për vendndodhjen e ruajtjes së lëndëve narkotike,
- sigurojnë një urdhër gjykate për kontroll banese dhe të ambienteve ku lënda narkotike ruhet për transport,
- ndajnë informacionin e siguruar në kohë reale me anëtarët e tjerë të EPH,
- kryejnë hetim të mëtejshëm të personave të panjohur nga Mali i Zi, të cilët marrin pjesë ose mbështesin grupin kriminal,

- sekuestrojnë lëndët narkotike të paligjshme dhe konfiskojnë pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, dhe
- marrin të gjitha masat e nevojshme hetimore të rëna dakord në EPH.

Shkëmbimi i gjetjeve në kuadër të hetimit dhe rregullimi i masave shtrënguese të mësipërme ndodh brenda EPH pa paraqitjen e një kërkesë formale për ndihmën e ndërsjellë juridike.

Të gjitha dokumentet shkëmbehen direkt ndërmjet anëtarëve të EPH dhe mund të merret ndihmë nga oficerët ndërlidhës të policisë vendore përgjegjëse për zonën e përfshirë.

Nëse është e nevojshme, palët ripërcaktojnë qëllimin, fushën e veprimit dhe misionin e EPH me marrëveshje të përbashkët unanime në formën e një marrëveshjeje shtesë ndërmjet palëve në EPH të cilat përfaqësohen nga drejtuesit e tyre përkatës.

### **3. Periudha që mbulon marrëveshja**

Në lidhje me këtë marrëveshje, ky EPH mund të veprojë për një periudhë 12 muajore nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, pra nga 2 dhjetori 2013 deri në 2 dhjetor 2014.

Periudha e veprimtarisë së EPH mund të shtyhet deri në një afat të caktuar, ndërsa shtyrja dhe përfundimi i kohëzgjatjes së periudhës duhet të pranohet unanimit. Në këtë rast, duhet të hartohet marrëveshje shtesë.

EPH mund të shpërbëhet përpara mbarimit të afatit, unanimit ose më shumicë të thjeshtë. Nëse EPH shpërbëhet unanimit, partnerët e EPH do të duhet të lidhin marrëveshje më përpara në lidhje me datën kur do të bëhet dorëzimi i provave të siguruara. Në rast të përfundimit përpara kohe të EPH, nuk do të merren masa të reja hetimore në bazë të EPH.

### **4. Vendi ose vendet ku do të veprojë EPH**

EPH do të veprojë në Bosnjë Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi.

Ekipi i Përbashkët Hetimor kryen operacionet e tij në përputhje me legjislacionin e vendit ku vepron në çdo kohë të veçantë. Nëse EPH e zhvendos bazën operacionale në një vend tjetër, zbatohet legjislacioni i këtij vendi. Nëse hetimet në një vend të tretë bëhen të nevojshme, vendet pjesëmarrëse kërkojnë marrëveshje për procedurën.

### **5. Vendet ku bazohet EPH:**

EPH bazohet në qytetet e mëposhtme:

- Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë
- Podgoricë, Mali i Zi
- Beograd, Serbi

## 6. Gjuha e Kontratës dhe Gjuha e Punës:

Vendet pjesëmarrëse vendosin që gjuha e kontratës (ndryshime dhe shtesa të kësaj kontrate dhe negociatat për të) të jetë anglisht.

Gjuha e punës e përcaktuar për koordinimin dhe zbatimin e masave të përbashkëta hetimore (veprimtari operacionale) është gjuha boshnjake, serbe, malazeze dhe angleze.

Dokumentet do të shkëmbehen ndërmjet palëve në gjuhën origjinale.

## 7. Drejtuesi ose drejtuesit e EPH

Palët kanë caktuar personin e mëposhtëm si përfaqësues i autoriteteve kompetente në vendin ose vendet ku vepron ekipi si drejtues i EPH dhe nën drejtimin e të cilit anëtarët e EPH duhet të kryejnë detyrat e tyre në vendin përkatës:

Vendi	Deleguar nga (emri i organit)	Emri	Grada dhe përkatësia (gjqësor, policor ose autoritet tjetër kompetent)
Bosnjë Hercegovina	Prokuroria e BH	X.X.	Prokuror
Mali i Zi	Prokuroria e Malit të Zi	Y.Y.	Prokuror i Lartë
Serbia	Prokuroria e Rrethit e Beogradit	Z.Z.	Prokuroria e Rrethit

Nëse një nga personat e mësipërm pengohet në kryerjen e detyrave, zëvendësimi bëhet pa vonesë me pëlqimin reciprok të palëve në një shtojcë të marrëveshjes. Në raste urgjente, do të mjaftojë që palët në EPH të njoftojnë me anë të një shkresë në lidhje me zëvendësimin. Ky njoftim më pas konfirmohet në një shtojcë të marrëveshjes.

## 8. Anëtarët e EPH

Përveç personave të përmendur në nenin për Drejtuesin/Drejtesit e EPH, personat e mëposhtëm janë anëtarë të EPH:

Vendi	Deleguar nga (emri i organit)	Emri ose numri i identifikimit	Grada dhe përkatësia (gjqësor, policor ose autoritet tjetër kompetent)	Roli
Bosnjë Hercegovina	Prokuroria e BH	A.X.	Prokuror	Anëtar i EPH
Bosnjë Hercegovina	Polic	B.X.	Inspektor Policie	Anëtar i EPH
Bosnjë Hercegovina	Polic	C.X.	Polic	Anëtar i EPH
Mali i Zi	Prokuroria e Malit të Zi	A.Y.	Prokuror	Anëtar i EPH
Mali i Zi	Polic	B.Y.	Polic	Anëtar i EPH
Serbia	Polic	A.Z.	Inspektor policie	Anëtar i EPH
Serbia	Polic	B.Z.	Oficer i lartë	Anëtar i EPH
Serbia	Polic	C.Z.	Polic	Anëtar i EPH

Nëse një nga personat e mësipërm pengohet në kryerjen e detyrave, zëvendësimi bëhet pa vonesë me anë të një shtojce të marrëveshjes ose me njoftim me shkrim që i dërgohet drejtuesit kompetent të EPH.

Palët sigurojnë që një numër i caktuar anëtarësh në vendin e tyre të flasë gjuhën angleze me qëllim që të mundësohet komunikimi ndërmjet anëtarëve.

Anëtarët e EPH janë penalisht dhe civilisht përgjegjës për veprimet e tyre në përputhje me ligjin e vendit në territorin e të cilit veprojnë.

## 9. Kushtet e veçanta të marrëveshjes

Anëtarët e EPH bashkëpunojnë dhe koordinojnë hetimet e tyre në lidhje me veprat penale të kryera nga grupi kriminal ndërkombëtar. Anëtarët e EPH ndajnë informacionin e mbledhur dhe provat, në kohë reale dhe pa vonesë. Komunikimi ndërmjet anëtarëve të EPH është i drejtpërdrejtë dhe pa formalitete të panevojshme.

Anëtarët e EPH vendosin për kohëzgjatjen e masave hetimore dhe respektimin e afateve.

Vendet pjesëmarrëse respektojnë hetimet në vendet e tjera pjesëmarrëse në EPH dhe planifikojnë hetimin e tyre dhe ekzekutimin e masave hetimore me vende të tjera pjesëmarrëse në EPH nëpërmjet anëtarëve të EPH.

Vendet pjesëmarrëse në EPH do të zgjidhin vështirësitë e paparashikuara në lidhje me punën e ekipit të përbashkët hetimor ose hetimin e veprave penale që janë në fushën e veprimtarisë së EPH nëpërmjet dialogut me vendet e tjera pjesëmarrëse në EPH. Vendet pjesëmarrëse së pari do të përpiqen të zgjidhin problemet me komunikim ndërmjet drejtuesve të EPH. Në rast se komunikimi nuk ofron zgjidhje, vendet pjesëmarrëse në EPH do të organizojnë menjëherë një takim ndërmjet autoriteteve kompetente të vendeve pjesëmarrëse në EPH dhe do të gjejnë një zgjidhje në formën e një ndryshimi të kësaj marrëveshjeje.

## **10. Kushtet e Veçanta të Marrëveshjes**

Autoritetet gjyqësore, si palë në marrëveshje, drejtuesit dhe anëtarët e EPH kanë akses në të gjithë informacionin dhe provat e mbledhura gjatë hetimeve të EPH dhe të siguruar në hetimet e kryera deri në atë moment nga autoritetet e vendeve pjesëmarrëse në EPH.

Një anëtar i deleguar në kuadër të EPH, nën drejtimin dhe praninë e nëpunësit kompetent të autorizuar për të marrë masa hetimore në vendin pritës, mund të lejohet që të marrë pjesë në masat hetimore në kuadër të ligjit të zbatueshëm në vendin pritës, me kusht që kjo të jetë miratuar nga vendi delegues. Prandaj, nëpunësit e huaj nuk kanë kompetencë për të dhënë udhëzime dhe duhet të sigurohet që një nëpunës kompetent i vendit pritës të jetë në gjendje të marrë veprime për masa individuale në çdo kohë.

I gjithë informacioni dhe provat e siguruar nga dhe për EPH bëhen pjesë e dosjes së çështjes, në masën që e kërkon legjislacioni kombëtar, dhe nëse kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm në vendin e përfshirë, nuk është klasifikuar konfidenciale dhe nuk trajtohet nga një deklaratë tjetër që ta pengojë. Vetëm informacioni që nuk është i klasifikuar dhe provat e tilla i paraqiten partnerëve të EPH.

Nëse rezulton e nevojshme që një nga palët e marrëveshjes të dërgojë një kërkesë për ndihmë juridike në një vend të tretë, kjo palë i kërkon vendit të tretë leje për të ndarë të gjitha gjetjet dhe provat e siguruar në përgjigje të kërkesës me palën tjetër të marrëveshjes.

Anëtarët e EPH mund të kërkohet që të japin dëshmi të cilat përdoren në sistemet juridike të shteteve palë. Kuptohet që anëtarët e EPH mund të thirren që të japin prova në juridiksionin e vendit tjetër. Legjislacionet kombëtare që rregullojnë sekretin profesional të nëpunësve publikë mbeten të zbatueshme.

## 11. Masat organizative

Palët në këtë marrëveshje marrin masat e nevojshme organizative për të mundësuar që EPH të kryejë punën e tij. Kostoja e shpenzuar për masat hetimore paguhet nga autoritetet në vendin ku është marrë masa hetimore. Kostoja për përkthyesit paguhet nga vendi që kërkon përkthyes, pavarësisht vendit se ku e realizon përkthyesi punën e tij. Kostoja për udhëtimin dhe akomodimin e nëpunësve pjesëmarrës në EPH paguhet nga vendi që i delegon ata. Nuk ka shpërblim të veçantë.

Nëpunësit e një vendi pjesëmarrës në EPH nuk lejohen që të mbajnë armë shërbi mi në territorin e shtetit tjetër pjesëmarrës në EPH.

Nuk lejohen njoftime për shtyp përpara se të gjitha vendet në EPH të kenë përfunduar hetimin dhe të jetë realizuar qëllimi i EPH.

## 12. Përdorimi i informacionit dhe provave të marra në bazë të EPH:

Informacioni dhe provat e siguruar në mënyrë të ligjshme brenda fushës së veprimit të EPH mund të përdoren për qëllimet e mëposhtme:

- për qëllimet për të cilat është krijuar ekipi;
- për të zbuluar, hetuar dhe ndjekur krime të tjera, me marrjen e miratimit paraprak nga vendi pjesëmarrës ku është siguruar informacioni. Ky miratim mund të refuzohet vetëm në çështje ku përdorimi i këtij informacioni do të ndikonte negativisht në hetimin penal në vendin pjesëmarrës ose në çështje ku ky vend do të refuzonte ofrimin e ndihmës.
- për të shmangur rrezikun e afërt dhe serioz ndaj sigurisë publike dhe pavarësisht pikës së parë, nëse më pas do të fillojë një hetim penal;
- për qëllime të tjera, nëse kjo është rënë dakord nga vendet që kanë krijuar EPH;
- kjo marrëveshje nuk shmang detyrimet ekzistuese në legjislacionin kombëtar për palët që të marrin masa (sekuestrim, dorëzim i kontrolluar), pas informacionit të detajuar të marrë nga një palë në lidhje me vendndodhjen e substancave të paligjshme.

Palët ngarkojnë drejtuesin ose anëtarin e EPH me dhënien e këshillave për sigurimin e provave. Roli i tij ose i saj përfshin dhënien e udhëzimeve për anëtarët e EPH për aspekte dhe procedura që mund të merren parasysh në marrjen e provave. Personi/personat që kryejnë këtë funksion duhet që të përcaktohen. Palët mund të informojnë njëra-tjetrën për dhënien e dëshmimeve nga anëtarët e EPH.

### **13. Ndryshime të marrëveshjes**

Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje nënshkruhen nga palët dhe i bashkëngjiten variantit fillestar të kësaj marrëveshjeje.

### **14. Vlerësim i brendshëm**

Të paktën çdo tre muaj, drejtuesit e EPH vlerësojnë progresin e arritur në lidhje me qëllimin e përgjithshëm të EPH, ndërsa përcaktojnë dhe trajtojnë problemet e identifikuar.

Pas përfundimit të veprimtarisë së EPH, palët, sipas rastit, mund të organizojnë një takim për të vlerësuar performancën e EPH.

EPH mund të hartojë një raport për veprimtarinë, i cili mund të tregojë se si u zbatua Plani i Veprimit Operacional dhe cilat ishin rezultatet e arritura.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në 6 kopje.

**Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë, 2 dhjetor 2013**

(Nënshkrimi i të gjitha palëve)

## MARRËVESHJE TIP PËR KRIJIMIN E NJË EKIPI TË PËRBASHKËT HETIMOR<sup>35</sup>

**Në përputhje me:**

(tregoni bazën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare)

### 1. Palët e Marrëveshjes

Palët e mëposhtme janë lidhur marrëveshje për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor, (tani e më tutje të njohur si EPH):

a) (emri i agjencisë/administratës së parë kompetente të shtetit si një palë e marrëveshjes)

dhe

b) (emri i agjencisë/administratës së dytë kompetente të shtetit si një palë e marrëveshjes)

dhe

c) (emri i agjencisë/administratës së fundit kompetente të shtetit si një palë e marrëveshjes)

Palët në këtë marrëveshje mund të vendosin me marrëveshje të përbashkët që të ftojnë vende të tjera, agjenci dhe administrata që të bëhen palë të kësaj marrëveshjeje.

### 2. Qëllimi, fusha e veprimit dhe misionet e Ekipit të Përbashkët Hetimor:

Marrëveshja mbulon krijimin e një EPH për qëllimet e mëposhtme:

a) Dispozita të përgjithshme

(Përshkrimi i qëllimit specifik të EPH. Këtu duhet të përfshihen rrethanat e krimit që hetohet (data, vendi dhe natyra))

<sup>35</sup> I përgatitur në kuadër të një marrëveshjeje ekzistuese mbi EPH nga ish – Republika Jugosllave e Maqedonisë me shtetet e tjera, duke marrë parasysh rregulloret e EUROJUST-it mbi marrëveshjet e EPH-ve.



“SUGJERIME:”

“Shkëmbimi i gjetjeve në kuadër të hetimit dhe rregullimi i masave shtrënguese të mësipërme ndodh brenda EPH pa paraqitjen e një kërkesë formale për ndihmën e ndërsjellë juridike.”

“Të gjitha dokumentet shkëmbehen direkt ndërmjet anëtarëve të EPH dhe mund të merret ndihmë nga oficerët ndërlidhës të policisë vendore përgjegjëse për zonën e përfshirë.

Nëse është e nevojshme, palët ripërcaktojnë qëllimin, fushën e veprimit dhe misionin e EPH me marrëveshje të përbashkët unanime në formën e një marrëveshjeje shtesë ndërmjet palëve në EPH të cilat përfaqësohen nga drejtuesit e tyre përkatës.

b) Dispozita specifike:

(Përshkrimi i çështjes në të gjitha vendet anëtare të EPH dhe specifikat e hetimit në një vend të caktuar)

(1) Hetimet në Shtetin A

(cili autoritet po heton çështjen, numri i çështjes, cilat autoritete po bashkëpunojnë dhe cilat do të marrin pjesë në EPH, informacioni që është mbledhur deri në këtë moment për çështjen në lidhje me vendin specifik (vendet, fusha e veprimit, etj), qëllimi dhe fusha e veprimit e hetimit në një vend të caktuar, ....)

(2) Hetimet në Shtetin B

(3) Hetimet në Shtetin C

### **3. Periudha që mbulon marrëveshja**

Në lidhje me këtë marrëveshje, ky EPH mund të veprojë gjatë periudhës së mëposhtme:

nga

[shëno datën]

deri në

[shëno datën]

Periudha e veprimtarisë së EPH mund të shtyhet deri në një afat të caktuar, ndërsa shtyrja dhe përfundimi i kohëzgjatjes së periudhës duhet të pranohet unanimisht. Në këtë rast, duhet të hartohet marrëveshje shtesë.

EPH mund të shpërbëhet përpara mbarimit të afatit, unanimisht ose më shumicë të thjeshtë. Nëse EPH shpërbëhet unanimisht, partnerët e EPH do të duhet të lidhin marrëveshje më përpara në lidhje me datën kur do të bëhet dorëzimi i provave të siguruara. Në rast të përfundimit përpara kohe të EPH, nuk do të merren masa të reja hetimore në bazë të EPH.

#### **4. Vendi ose vendet ku do të veprojë EPH**

EPH do të veprojë në vendin ose vendet e përcaktuara si më poshtë:

[përcaktoni vendin ose vendet ku do të veprojë EPH]

Ekipi i Përbashkët Hetimor kryen operacionet e tij në përputhje me legjislacionin e vendit ku vepron në çdo kohë. Nëse EPH e zhvendos bazën operationale në një vend tjetër, zbatohet legjislacioni i këtij vendi. Nëse hetimet në një vend të tretë bëhen të nevojshme, vendet pjesëmarrëse kërkojnë marrëveshje për procedurën.

#### **5. Vendet ku bazohet EPH:**

EPH bazohet në qytetet e mëposhtme:

- “emri i qytetit”, “shteti”

- “emri i qytetit”, “shteti”

- “emri i qytetit”, “shteti”

#### **6. Gjuha e Kontratës dhe Gjuha e Punës:**

Vendet pjesëmarrëse vendosin që gjuha e kontratës (ndryshime dhe shtesa të kësaj kontrate dhe negociatat për të) të jetë \_\_\_\_\_.

Gjuha e punës e përcaktuar për koordinimin dhe zbatimin e masave të hetimit të përbashkët (veprimtari operationale) është \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

Përkthyesit do të përdoren në zyrat përkatëse të EPH në \_\_\_\_\_, autoritetet gjyqësore do të kenë gjithashtu mundësinë që të përdorin përkthyes nga autoritetet policore.

Dokumentet do të shkëmbehen ndërmjet palëve në gjuhën origjinale.

## 7. Drejtuesi ose drejtuesit e EPH

Palët kanë caktuar personin e mëposhtëm si përfaqësues i autoriteteve kompetente në vendin ose vendet ku vepron ekipi si drejtues i EPH dhe nën drejtimin e të cilit anëtarët e EPH duhet të kryejnë detyrat e tyre në vendin përkatës:

Vendi	Deleguar nga (emri i organit)	Emri	Grada dhe përkatësia (gjyqësor, policor ose autoritet tjetër kompetent)

Nëse një nga personat e mësipërm pengohet në kryerjen e detyrave, zëvendësimi bëhet pa vonesë me pëlqimin reciprok të palëve në një shtojcë të marrëveshjes. Në raste urgjente, do të mjaftojë që palët në EPH të njoftojnë me anë të një shkrese në lidhje me zëvendësimin. Ky njoftim më pas konfirmohet në një shtojcë të marrëveshjes.

## 8. Anëtarët e EPH

Përveç personave të përmendur në nenin për Drejtuesin/Drejtesit e EPH, personat e mëposhtëm janë anëtarë të EPH:

Vendi	Deleguar nga (emri i organit)	Emri ose numri i identifikimit	Grada dhe përkatësia (gjyqësor, policor ose autoritet tjetër kompetent)	Roli

Nëse një nga personat e mësipërm pengohet në kryerjen e detyrave, zëvendësimi bëhet pa vonesë me në një shtojcë të marrëveshjes ose me njoftim me shkrim që i dërgohet drejtuesit kompetent të EPH.

“MUNDËSIA:”

Partneri i EPH do të njoftohet me shkrim për çdo ndryshim të anëtarëve të EPH. Çdo njoftim i tillë do të konsiderohet dhe miratohet në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk ka kundërshtime nga partnerët e tjerë të EPH.

Palët sigurojnë që një numër i caktuar anëtarësh në vendin e tyre të flasë gjuhën \_\_\_\_\_ me qëllim që të mundësohet komunikimi ndërmjet anëtarëve.

“MUNDËSIA:”

“Anëtarët e EPH janë penalisht dhe civilisht përgjegjës për veprimet e tyre në përputhje me ligjin e vendit në territorin e të cilit veprojnë.”

## **9. Kushtet e përgjithshme të marrëveshjes**

(Dispozitat për elementët kryesore të Ekipit të Përbashkët Hetimor dhe kushtet në të cilat vepron EPH)

## **10. Kushtet e veçanta të marrëveshjes**

(Dispozitat për elementet specifike të Ekipit të Përbashkët Hetimor dhe kushtet ndërmjet dy vendeve specifike ose të gjitha vendeve pjesëmarrëse në EPH- ashtu si dispozitat për ekzekutimin e masave hetimore të veçanta dhe shkëmbimin dhe trajtimin në këtë mënyrë të informacionit të mbledhur, aksesit në informacion, trajtimin e informacionit të klasifikuar, dispozitat për bashkëpunimin me vendet e treta,....)

“MUNDËSIA:”

“Autoritetet gjyqësore, si palë në marrëveshje, drejtuesit dhe anëtarët e EPH kanë akses në të gjithë informacionin dhe provat e mbledhura gjatë hetimeve të EPH dhe të siguruar në hetimet e kryera deri në atë moment nga autoritetet e vendeve pjesëmarrëse në EPH”.

“Një anëtar i deleguar në kuadër të EPH, nën drejtimin dhe praninë e nëpunësit kompetent të autorizuar për të marrë masa hetimore në vendin pritës, mund të lejohet që të marrë pjesë në masat hetimore në kuadër të ligjit të zbatueshëm në vendin pritës, me kusht që kjo të jetë miratuar nga vendi delegues. Prandaj, nëpunësit e huaj nuk kanë kompetencë për të dhënë udhëzime dhe duhet të sigurohet që një nëpunës kompetent i vendit pritës të jetë në gjendje të marrë veprime për masa individuale në çdo kohë.”

“I gjithë informacioni dhe provat e siguruar nga dhe për EPH bëhen pjesë e dosjes së çështjes, në masën që e kërkon legjislacioni kombëtar, dhe nëse kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm në vendin e përfshirë, nuk është klasifikuar konfidenciale dhe nuk trajtohet nga një deklaratë tjetër që ta pengojë. Vetëm informacioni që nuk është i klasifikuar dhe provat e tilla i paraqiten partnerëve të EPH.”

“Nëse rezulton e nevojshme që një nga palët e marrëveshjes të dërgojë një kërkesë për ndihmë juridike në një vend të tretë, kjo palë i kërkon vendit të tretë leje për të ndarë të gjitha gjetjet dhe provat e siguruar në përgjigje të kërkesës me palën tjetër të marrëveshjes.”

“Anëtarët e EPH mund të kërkohej që të japin dëshmi të cilat përdoren në sistemet juridike të shteteve palë. Kuptohet që anëtarët e EPH mund të thirren që të japin prova në juridiksionin e vendit tjetër. Legjislacionet kombëtare që rregullojnë sekretin profesional të nëpunësve publikë mbeten të zbatueshme.”

“SUGJERIME:”

(Për të shmangur marrëveshje tepër të paqarta disa ose të gjitha pikat e mëposhtme mund të përcaktohen në Plan Veprimin Operacional).

Rregullimet e veçanta të mëposhtme mund të zbatohen për këtë marrëveshje:

(Për t’u përfshirë, nëse është e zbatueshme. Nënkapitujt e mëposhtëm theksojnë fushat e mundshme që duhet të përshkruhen në mënyrë specifike).

10.1. Kushte sipas të cilave anëtarët e deleguar të EPH mund të përjashtohen kur merren masa hetimore.

10.2. Kushte specifike sipas të cilave një anëtar i deleguar i një EPH mund t’i kërkojë autoriteteve të tij kombëtare marrjen e masave që kërkohej nga ekipi pa paraqitur letër kërkesë.

10.3. Kushte sipas të cilave anëtarët e deleguar mund të ndajnë informacionin që vjen nga autoritetet deleguese.

10.4. Dispozita në lidhje me konfidencialitetin e kësaj marrëveshjeje.

10.5. Kushte sipas të cilave mund të jepet ndihma e kërkuar sipas Konventës dhe rregullimeve të tjera.

## **11. Masat organizative**

11.1. Shpenzime të kryera nga EPH

“SUGJERIME:”

Palët në këtë marrëveshje marrin masat e nevojshme organizative për të mundësuar që EPH të kryejë punën e tij. Kostoja e shpenzuar për masat hetimore paguhet nga autoritetet në vendin ku është marrë masa hetimore. Kostoja për përkthyesit paguhet nga vendi që kërkon përkthyes, pavarësisht vendit se ku e realizon përkthyesi punën e tij. Kostoja për udhëtimin dhe akomodimin e nëpunësve pjesëmarrës në EPH paguhet nga vendi që i delegon ata. Nuk ka shpërblim të veçantë.

“MUNDËSIA:”

- Dispozita për sigurimin e anëtarëve të deleguar të EPH
- Dispozita për përkthimin, për shembull, e dokumenteve të siguruara në gjuhën e anëtarëve të tjerë të EPH si edhe në gjuhën zyrtare të komunikimit (nëse është e ndryshme), sepse kjo mund të implikojë shpenzime të konsiderueshme (të panevojshme)
- Dispozita në lidhje me shpenzime ose të ardhura nga pasuritë e sekuestruara

11.2. Zyra (nëse do të përdoren zyra të përbashkëta)

11.3. Automjete (nëse do të përdoren automjete të përbashkëta)

11.4. Armë shërbimi

“SUGJERIME:”

“Nëpunësit e një vendi pjesëmarrës në EPH nuk lejohen që të mbajnë armë shërbimi në territorin e shtetit tjetër pjesëmarrës në EPH.

11.5. Shtypi (dispozita në lidhje me median, sidomos nevojën për konsultime përpara prezantimit të njoftimeve për shtyp dhe informacioneve zyrtare)

11.6. Rregulla specifike për mbrojtjen e të dhënave

## **12. Pjesëmarrësit në EPH**

Dispozitat për pjesëmarrësit në EPH trajtohen në shtojcën përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.

Pjesëmarrja e organizatave si EUROJUST, EUROPOL, EULEX etj)

## **13. Përdorimi i informacionit dhe provave të marra në bazë të EPH:**

Informacioni dhe provat e siguruar në mënyrë të ligjshme brenda fushës së veprimit të EPH mund të përdoren për qëllimet e mëposhtme:

(lista e procedimeve dhe qëllimet për të cilat mund të përdoret informacioni i siguruar nëpërmjet EPH).

“SUGJERIME:”

- për qëllimet për të cilat është krijuar EPH;
- për të zbuluar, hetuar dhe ndjekur krime të tjera, me marrjen e miratimit paraprak nga vendi pjesëmarrës ku është siguruar informacioni. Ky miratim mund të refuzohet vetëm në çështje ku përdorimi i këtij informacioni do të ndikonte negativisht në hetimin penal në vendin pjesëmarrës ose në çështje ku ky vend do të refuzonte ofrimin e ndihmës.
- për të shmangur rrezikun e afërt dhe serioz ndaj sigurisë publike dhe pavarësisht pikës së parë, nëse më pas do të fillojë një hetim penal;
- për qëllime të tjera, nëse kjo është rënë dakord nga vendet që kanë krijuar EPH;
- kjo marrëveshje nuk shmang detyrimet ekzistuese në legjislacionin kombëtar për palët që të marrin masa (sekuestrim, dorëzim i kontrolluar), pas informacionit të detajuar të marrë nga një palë në lidhje me vendndodhjen e substancave të paligjshme.

“MUNDËSIA:”

(Palët ngarkojnë drejtuesin ose anëtarin e EPH me dhënien e këshillave për sigurimin e provave. Roli i tij ose i saj përfshin dhënien e udhëzimeve për anëtarët e EPH për aspekte dhe procedura që mund të merren parasysh në marrjen e provave. Personi/personat që kryejnë këtë funksion duhet që të përcaktohen. Palët mund të informojnë njëra-tjetrën për dhënien e dëshmimeve nga anëtarët e EPH. )

#### **14. Ndryshime të marrëveshjes**

Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje, që përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me:

- (a) përfshirjen e anëtarëve të rinj në EPH;
- (b) ndryshimet në qëllimin e parashikuar në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje;
- (c) shtesa ose ndryshime të neneve ekzistuese;

bëhen siç parashikohet në këtë marrëveshje tip, nënshkruhen nga palët dhe i bashkëngjiten variantit origjinal.

#### **15. Vlerësim i brendshëm**

Të paktën çdo gjashtë muaj, drejtuesit e EPH vlerësojnë progresin e arritur në lidhje me qëllimin e përgjithshëm të EPH, ndërsa përcaktojnë dhe trajtojnë problemet e identifikuara.

Pas përfundimit të veprimtarisë së EPH, palët, sipas rastit, mund të organizojnë një takim për të vlerësuar performancën e EPH.

EPH mund të hartojë një raport për veprimtarinë, i cili mund të tregojë se si u zbatua Plan Veprimi Operacional dhe cilat ishin rezultatet e arritura.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në \_\_\_\_\_ kopje.

Vendi i nënshkrimit, data

Nënshkrimi i të gjitha palëve



